PROSPEKT

EMETUES: NOA SH.A.

Shoqëri aksionare e organizuar dhe që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me seli në Rr. "Tish Daia", Komuna e Parisit, Kompleksi Haxhiu (Kika 2), P. 2, K. 1, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrit Tregtar në përputhje me vendimin Nr. 25341, datë 2 Mars 2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT K11604002V, e që vepron si Institucion Financiar Jo-Bankë, në përputhje me Licencën e Aktivitetit nr. 09, datë 06.06.2007 (nr. 09/1, datë 1.3.2022) lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Website: www.noafin.al
Nr. telefoni: 00355- (0) - 4-4511011
E-mail: info@noafin.al

AUTORITETI:

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është person juridik, publik, me qendër në Tiranë. Autoriteti është i pavarur në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara në Ligjin Nr.7592, datë 03.07.2006 " Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" ose në legjislacionin në fuqi dhe nuk lejohet ndërhyrja në veprimtarinë e tij, e cila mund të cenojë pavarësinë e Autoritetit. Autoriteti ka të drejtë të nxjerrë akte, që janë rregulloret, rregullat, udhëzimet, manualet apo metodologjitë e miratuara nga Bordi i Autoritetit, në zbatim të kompetencave të parashikuara në Ligjin Nr.7592, datë 03.07.2006 " Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" apo në legjislacionin përkatës në fuqi, për përmbushjen e funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit. Autoriteti e ka selinë në Rr. "Dora D'istria", Nr.10, P.O. Box 8363, Tiranë, Shqipëri.

Website: www.amf.gov.al
Nr. telefoni: 00355- (0) - 4-2257560
E-mail: amf@amf.gov.al

LLOJI I TITULLIT:

OBLIGACION I NËNRENDITUR, ME AFAT 5 –VJEÇAR, INTERES FIKS (KUPON) 8% p.a, I DENOMINUAR NË MONEDHËN LEKË, I PA-GARANTUAR

[AL0022100146]

Data e Ofertës: 24 Maj2023

Data e miratimit* të Prospektit: 28.04.2023
(*sipas Vendimit të Bordit të AMF nr 72, datë 28/04/2023)

E RËNDËSISHME:
INVESTIMI NË KËTË TITULL SHOQËROHET ME RREZIQE!
FAKTORËT E RREZIKUT TË EMETUESIT DHE TË TITULLIT PËRSHKRUHEN NË KËTË PROSPEKT DHE DUHEN LEXUAR ME KUJDES!

TABELA E PËRMBAJTJES:

KREU I – PËRMBLEDHJA 3

RUBRIKA 1 – HYRJE DHE PARALAJMËRIME 3

RUBRIKA 2 – INFORMACIONE KRYESORE RRETH EMETUESIT 4

RUBRIKA 3 - TIPARET KRYESORE TË TITUJVE 12

RUBRIKA 4 – INFORMACIONE KRYESORE RRETH TITUJVE 19

KREU II – INFORMACION RRETH EMETUESIT 25

RUBRIKA 1 – PERSONAT PËRGJEGJËS, INFORMACIONI NGA PALËT E TRETA, RAPORTET E EKSPERTËVE DHE MIRATIMI NGA AUTORITETI KOMPETENT 25

RUBRIKA 3 - FAKTORËT E RREZIKUT 29

RUBRIKA 4 --INFORMACION RRETH EMETUESIT 37

RUBRIKA 5 -- PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I AKTIVITETIT 41

RUBRIKA 6 --STRUKTURA ORGANIZATIVE 63

RUBRIKA 7 --VLERËSIMI OPERATIV DHE FINANCIAR 65

RUBRIKA 8 - BURIMET E FINANCIMIT 71

RUBRIKA 9 - MJEDISI RREGULLATOR 77

RUBRIKA 10 - INFORMACION PËR PRIRJET 78

RUBRIKA 11 -PARASHIKIMET OSE VLERËSIMET E FITIMEVE 80

RUBRIKA 12 - ORGANET ADMINISTRATIVE, DREJTUESE DHE MBIKËQYRËSE DHE DREJTUESIT E LARTË 82

RUBRIKA 13 -SHPËRBLIMI DHE PËRFITIMET 87

RUBRIKA 14 -PRAKTIKAT E KËSHILLAVE 87

RUBRIKA 15 –PUNËMARRËSIT 89

RUBRIKA 16 -AKSIONARËT ME PJESËMARRJE TË LARTË 90

RUBRIKA 17 TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA 91

RUBRIKA 18- TË DHËNAT FINANCIARE MBI AKTIVET, PASIVET, GJENDJEN FINANCIARE DHE

RUBRIKA 19- INFORMACION SHTESË 95

RUBRIKA 20- KONTRATAT THEMELORE 97

RUBRIKA 21 -DOKUMENTET NË DISPOZICION 97

KREU III – SHËNIMI MBI TITULLIN 98

RUBRIKA 1 – PERSONAT PËRGJEGJËS, INFORMACIONI NGA PALËT E TRETA, RAPORTET E EKSPERTËVE DHE MIRATIMI NGA AUTORITETI KOMPETENT 98

RUBRIKA 2 - FAKTORËT E RREZIKUT 102

RUBRIKA 3 --INFORMACION THEMELOR 105

RUBRIKA 4 -- INFORMACION RRETH TITUJVE QË OFROHEN/PRANOHEN PËR TREGTIM 108

RUBRIKA 5 -- KUSHTET DHE KRITERET PËR OFRIMIN E TITUJVE PUBLIKUT 112

RUBRIKA 6 -- PRANIMI PËR TREGTIM DHE RREGULLAT E TREGTIMIT 117

RUBRIKA 8 -- SHPENZIMET E EMETIMIT/OFERTËS 118

RUBRIKA 9 -- INFORMACION SHTESE 119

KREU I – PËRMBLEDHJA

RUBRIKA 1 – Hyrje dhe paralajmërime

DEKLARATA E EMETUESIT

Me besim të plotë dhe bazuar në gjithë informacionin dhe të dhënat e paraqitura në prospekt, deklarojmë se i gjithë informacioni dhe të dhënat që gjenden në këtë prospekt përbëjnë paraqitjen e plotë të aktiveve dhe pasiveve, fitimeve dhe humbjeve, situatës financiare dhe veprimtarive reale të emetuesit (”NOA”), të të drejtave që lidhen me titullin që do t’i ofrohet publikut dhe do të pranohet për t’u tregtuar në një treg të rregulluar dhe se i gjithë informacioni dhe data e paraqitur këtu janë të sakta e korrekte dhe se nuk është hequr asnjë informacion apo të dhëna që ndikojnë në saktësinë dhe tërësinë e informacionit.

Znj. Herjola Spahiu

Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv i NOA sh.a.

NJOFTIME TË RËNDËSISHME PËR INVESTITORIN

Ky prospekt përmban informacione të rëndësishme mbi emetuesin dhe titullin. Prospekti përshkruan, gjithashtu, rreziqet që shoqërojnë emetuesin dhe rreziqet shoqëruese të investimit në tituj. Rekomandohet të lexoni dhe të kuptoni plotësisht përmbajtjen e të gjithë prospektit, përpara se të merrni një vendim për të investuar në tituj. Për rrjedhojë, kjo përmbledhje duhet lexuar vetëm si hyrje.

PËRGJEGJËSIA PËR INFORMACIONIN QË PËRMBAN PROSPEKTI

Institucioni Financiar NOA Sh.a pranon te gjithe përgjegjësinë për informacionin dhe të dhënat që përmban ky prospekt. Informacionet janë në përputhje me faktet dhe nuk lënë jashtë asnjë informacion që do të cenonte vlerën e tij. Kur përdoren informacione nga burimet e palëve të treta, këto informacione riprodhohen në mënyrë të saktë dhe emetuesi është në gjendje të shpjegojë qartësisht informacionin e publikuar nga kjo palë e tretë, dhe nuk lihet jashtë asnjë fakt që do ta bënte informacionin e riprodhuar të pasaktë apo çorientues.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare verifikon vetëm nëse prospekti përmban të gjithë informacionin e përcaktuar në ligjin Nr. 62/2020, ‘Për tregjet e kapitalit’ dhe kërkesat rregullatore sa i përket plotësisë, njëtrajtshmërisë dhe kuptueshmërisë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk verifikon nëse informacioni që përmban ky prospekt është i saktë dhe korrekt.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk jep rekomandime për askënd në lidhje me përshtatshmërinë e investimit në tituj.

Çdo investitor është përgjegjës për vendimin e tij bazuar në informacionet që përmban ky prospekt dhe, nëse është i pasigurt për ndonjë investim, duhet të këshillohet me një profesionist.

RUBRIKA 2 – Informacione Kryesore rreth Emetuesit

▪ Emetuesi i Titujve	NOA sh.a. Emri tregtar i emetuesit përkon me emrin juridik të tij: "NOA"
Pika 1.1	**Pika 1.1 Selia qendrore dhe personaliteti juridik i emetuesit, NIPT-i, ligji në bazë të të cilit ushtron veprimtarinë dhe vendi i themelimit** NOA është një shoqëri aksionare e organizuar dhe që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me seli qëndrore në Rr. "Tish Daia", Komuna e Parisit, Kompleksi Haxhiu (Kika 2), P. 2, K. 1, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrit Tregtar në përputhje me vendimin Nr. 25341, datë 2 Mars 2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT K11604002V, e që vepron si Institucion Financiar Jo-Bankë, në përputhje me Licencën e Aktivitetit nr. 09, datë 06.06.2007 (nr. 09/1, datë 1.3.2022) lëshuar nga Banka e Shqipërisë si dhe Licencën nr.701, datë 27.06.2016, për veprimtarinë e Agjentit në sigurime lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Akti nënligjor që rregullon në mënyrë të posacme licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve financiare jo-banka është Rregullorja e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me Vendim Nr. 01, datë 17.01.2013, "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", e ndryshuar . NOA ushtron veprimtarinë e saj në përputhje te plotë me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
Pika 1.2	**Pika 1.2 Veprimtaritë kryesore të emetuesit** Në përputhje me licencën Nr. 09, datë 06.06.2007, NOA mund të ushtrojë këto veprimtari financiare: • Të gjitha format e kredidhënies, • Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave, • Ofrimi i garancive, • Këmbim valutor, • Agjent në sigurime (në përputhje edhe me licencën Nr.701, datë 27.06.2016 lëshuar nga AMF), Ndër veprimtaritë e lejueshme të listuara më sipër, **veprimtaria kryesore e NOA është kredidhënia**. Target grupi kryesor i klientelës së NOA janë bizneset e vogla e të mesme, agrobizneset e fermerët si dhe individët e punësuar e të vetëpunësuar. Përgjatë 24 viteve të aktivitetit të saj, NOA ka krijuar një portofol kredie me madhësi të konsiderueshme, të mirëdiversifikuar sipas sektorëve kyç të ekonomisë dhe në saj të shfrytëzimit të oportuniteteve dhe menaxhimit të kujdesshëm risqeve ka siguruar njëkohësiht rritjen e vazhdueshme të portofolit si dhe ruajtjen e cilësisë së tij. Me kalimin e viteve, konsolidimin gjithnjë e më të mirë të aktivitetit primar të NOA-s, kredidhënies, shoqëria zgjeroi gamën e shërbimeve plotësuese të aktivitetit bazë në mënyrë që të shërbejë sa më mirë klientët e saj (shërbime këshilluese, ndërmjetësim në sigurime dhe ato të pagesave).
Pika 1.3	**Pika 1.3 Aksionarët me pjesëmarrje të lartë, duke specifikuar nëse janë nën pronësi ose kontroll të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë dhe nga kush.** Struktura e pronësisë së NOA sh.a, si më datën e publikimit të këtij Prospekti është si më poshtë:

Aksionarët e NOA sh.a	Përqindja e Aksioneve
NOA Holdings N.V.	99.9986%

NOA Coöperatief U.A.	0.0014%

Aksionarët e drejtëpërdrejtë:

NOA Holdings N.V., e cila zotëron 99.9986% të vlerës totale të aksioneve, shoqëri aksionere e rregulluar nga ligjet Hollandeze, me numër regjistrimi 33268765, dhe seli në Amsterdam, Hollandë, me adresë "Herengracht 500, 1017 CB Amsterdam, Hollandë". Shoqeria aksionare NOA Holdings N.V zotërohet 100% nga aksioneri NOA Coöperatief U.A

NOA Coöperatief U.A., e cila zotëron 0.0014% të aksioneve ose 1 aksion, një shoqëri ko-operative me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të shtetit Hollandez me numër regjistrimi Nr. 34379979 dhe seli në "Herengracht 500, 1017 CB Amsterdam, Hollandë".
Shoqeria kooperative me pergjegjesi te kufizuar, NOA Coöperatief U.A zotërohet 51.67% nga shoqëria BFSE Holding B.V & 48.33% nga shoqëria Creation Investments.

Aksionarët e tërthortë:

BFSE Holding B.V është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuara e regjistruar në Hollandë e cila drejtohet së bashku nga Z. Clive Moody dhe Z. Remko Van Roekel. BFSE Holding B.V zotërohet nga 4 aksionerë të cilët nuk zotërojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthortë më shumë se 25% të aksioneve të shoqërisë NOA sha.
BFSE HOLDING BV zotërohet nga:

- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **"ALAR CONSULTING" shpk**, me NIPT L71312045T dhe seli qëndrore në Rrugën "Donika Kastrioti", Pallati nr. 8, Kati 3, Apartamenti nr. 2/3, Tiranë, dhe e cila zotëron **41%** të aksioneve të BFSE Holding BV. ALAR Consulting shpk zotërohet në masën 100% nga Z.Astrit Hana.
- **Z. Dritan Pashako**, i cili zotëron **25 %** të aksioneve të shoqërisë BFSE Holding BV.
- Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **"SHAGA" shpk**, mr NIPT J96822229J dhe seli qëndrore në adresën Rruga Hamdi Pepa, ish Parku i Industrisë, Tiranë dhe e cila zotëron **21.50 %** të shoqërisë BFSE Holding BV. Ortakët e vetëm të SHAGA shpk janë Z.Shemsi Zemani i cili zotëron 80% të kapitalit dhe Z.Artan Zemani i cili zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë.
- **Z. Edmond Jaupi**, i cili zotëron **12.50 %** të aksioneve të shoqërisë BFSE Holding BV.

Creation Investment Social Ventures Fund I është shoqëri Trust-i, i themeluar dhe me seli në Dellaëare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që përbëhet nga 75 investitorë të cilët sipas deklarimit të të Mirëbesuarit (Trustee)/Presidentit të shoqërisë, z. Patrick Fisher nuk gëzojnë më shumë se 25% të kuotave/aksioneve/të drejtave në shoqëri. Duke qene se asnje nga te investitoret nuk zoteron me shume se 25% te kuotave, rezulton si pronar perfitues sipas parashikimeve ligjore per Trustin z. Patrick Fisher.



Pika 1.4

Pika 1.4 Identiteti i drejtorëve kryesorë administrativë

NOA ka një strukturë qeverisëse me një nivel drejtimi.
Këshilli i Administrimit, i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, është organi që realisht drejton veprimtarinë e shoqërisë dhe ka përbërjen si më poshtë:
Përbërja e Këshillit të Administrimit:

1. Andrew J. Walsh-Kryetar i Këshillit të Administrimit, Jo-Administrator.
   Z. Walsh është shtetas anglez, lindur në Bebington, Britani e Madhe më 11 Maj 1962 dhe është mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr 548458303.
2. Tomas Hlavac- Anëtar i Këshillit të Administrimit, Jo-Administrator.
   Z. Hlavac është shtetas çek, lindur në Pragë, Çeki më 26 Shkurt 1955 dhe është mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr. 42361332 .
3. Petr Sastinsky- Anëtar i Këshillit të Administrimit, Jo-Administrator.
   Z. Sastinsky është shtetas çek, lindur në Hradec, Kralove, Çeki më 17 Maj 1967, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr 46290833.
4. Elona Gjika- Anëtar i Këshillit të Administrimit, Jo-Administrator.
   Zj. Gjika është shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë më 28 Korrik 1970 dhe është mbajtëse e Letër Njoftimit me Nr.Personal H05728058B.
5. Herjola Spahiu- Nën-Kryetar i Këshillit të Administrimit, Administrator.
   Zj. Spahiu është shtetase Shqiptare, lindur më 27 Korrik 1978 në Elbasan dhe është mbajtëse e Letër Njoftimit me Nr.Personal H85727135S.

Administratorët e NOA sh.a, të cilët kane kompetenca administrimi dhe përfaqësimi të shoqërisë, janë:

1. Zj.Herjola Spahiu-Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
   Zj. Spahiu është shtetase Shqiptare, mbajtëse e Letër Njoftimit me Nr.Personal H85727135S, e lindur më 27 Korrik 1978 në Elbasan.
   Zj.Spahiu ushtron funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv në mënyrë të pavarur nga Administratori tjetër i shoqërisë NOA duke gëzuar dhe ushtruar pa kufizim të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i njeh legjislacioni në fuqi dhe statuti i shoqërisë.

2. Zj.Ariola Çela- Drejtor i Departamentit të Financës

Znj. Cela është shtetase Shqiptare, mbajtëse e Letër Njoftimit me Nr.Personal I35605134I e cila do te kryeje funksionin e Administratorit vetëm në rastet kur:

- Zëvendëson Drejtorin e Përgjithshëm të Shoqërisë NOA sh.a sipas një delegimi me shkrim nga ana e tij;
- Ka një vendim të Këshillit të Administrimit për kryerjen e funskionit të Administratorit nga ana e saj.

Pika 1.5

Pika 1.5 Identiteti i Audituesve Ligjorë

Auditues i jashtëm i NOA sh.a. për vitet financiare 2022, 2021 dhe 2020 është shoqëria:

Grant Thornton SH.P.K., me NIPT K91923007M, me adresë në rrugën "Sami Frasheri", Kompleksi T.I.D, Hyrja B. Kati I, Tiranë, Shqipëri.

Auditues i jashtem i emetuesit për vitin financiar 2019 ka qënë shoqëria:

Ernst & Young -Eksperte Kontabel te Autorizuar SH.P.K., me NIPT K61911012I, me adresë rruga "Ibrahim Rugova", Sky Tower, Kati I 6-te, Tiranë, Shqipëri.

Pika 2

Pika 2. Informacion kryesor financiar për tri vitet e shkuara

Më poshtë paraqiten zërat më të rëndësishëm financiarë për shoqërinë, shkëputur nga Pasqyrat Financiare të audituara për tri vitet e fundit. Pasqyrat Financiare Individuale të Audituara për vitet 2022,2021 dhe 2020, së bashku me opinionet përkatëse të Auditorëve të jashtëm gjenden bashkëlidhur këtij Prospekti.

BILANCI [1] *(shifrat në "mijë Lekë")*	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
AKTIVET			
Mjete monetare	608,744	451,896	354,295
Kredi për institucionet financiare	105,563	167,175	338,167
Kredi dhe paradhënie për klientët	6,913,435	5,751,651	5,082,474
Inventar dhe asete te tjera	90,488	66,530	46,887
Aktive afatgjata materiale	184,017	191,426	182,873
Aktive afatgjata jomateriale	18,329	26,140	23,973
Investime në Filial	35,031		
Aktive tatimore të shtyra	24,644	20,705	23,003
Totali i Aktiveve	**7,980,252**	**6,675,523**	**6,051,672**
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrimet			
Detyrime tatimore	16,915	6,571	7,521
Detyrime të tjera	239,009	231,837	238,192
Huamarrje	5,605,951	4,561,472	4,252,620
Totali i Detyrimeve	**5,861,875**	**4,799,880**	**4,498,333**
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	731,838	731,838	731,838
Rezerva ligjore	73,184	64,027	50,067
Fitimi i pashpërndarë	1,313,355	1,079,778	771,434
Totali i Kapitalit	**2,118,377**	**1,875,643**	**1,553,339**
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit	**7,980,252**	**6,675,523**	**6,051,672**

Në linjë me sa deklaruar mbi aktivitetin primar të NOA sh.a., aseti më i rëndësishëm i shoqërisë është **portofoli i kredive të klientëvë të saj, i cili ze një peshë prej rreth 87% të totalit të aseteve** dhe ka një vlerë neto rreth 6,9 miliardë Lekësh si më 31 Dhjetor 2022 .

[1] Pasqyrë Individuale e Pozicionit Financiar

Dinamikat e portofolit të kredisë përgjatë viteve kanë qënë pozitive jo vetëm në drejtim të aspektit sasior (madhësisë së tij) por edhe në drejtim të ruajtjes së treguesve cilësore në nivele të pëlqyeshme.

Rritja e portofolit të kredisë dhe mbajtja e një niveli minimal vonesash është arritur në saj të një menaxhimi shumë të kujdesshëm të aktivitetit, mbështetur nga këto shtylla kryesore: profesionalizmi i lartë i stafit të shitjes dhe analizës financiare, modeli efektiv i vendimarrjes për kreditim dhe sistemi i fortë i kontrollit. Strategjia e afatmesme e biznesit, e implementuar nga Drejtimi i shoqërisë për garantimin e rritjes cilësore të aktivitetit edhe në të ardhmen ka në fokus zgjerimin e "target" grupeve të klientelës, diversifikimin e kanaleve të shitjes e dizenjimin e produkteve të reja si dhe zgjerimin e shërbimeve financiare të ofruara klientelës në bazë të veprimtarive të lejuara të Institucionit.

Aktiviteti i NOA sha financohet kryesisht nëpërmjet fondeve të marra hua nga institucione të huaja dhe më pak banka lokale. 70% e burimeve të financimit të NOAs e zenë pikërishtë huatë nga palët e treta dhe rreth 30% zërat e kapitalit.

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET[2] *(në mijë Lekë)*	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Të ardhura nga interesi	1,479,629	1,278,642	1,176,234
Shpenzime interesi	-336,396	-297,333	-286,430
Të ardhura neto nga interesi	**1,143,233**	**981,309**	**889,804**
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	103,047	92,247	70,811
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet	-2,276	-2,141	-2,044
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	**100,770**	**90,106**	**68,767**
Rikuperimet nga kreditë e fshira	94,185	127,839	97,003
Të ardhura të tjera	13,288	9,746	62,072
Te ardhura operacionale neto	**1,351,477**	**1,209,000**	**1,117,646**
Shpenzime personeli	-423,588	-375,668	-346,893
Shpenzime të tjera	-187,652	-187,545	-166,350
Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhëniet për klientët	-196,047	-188,615	-209,321
Amortizimi i pajisjeve	-70,910	-62,902	-59,296
Zhvlerësimi i aktiveve jomateriale	-9,348	-8,253	-2,987
Fitim/ (humbje) nga kursi i këmbimit	8,160	2,075	-1,980
Totali i shpenzimeve	**-879,384**	**-820,908**	**-786,827**
Fitimi para tatimit	**472,092**	**388,092**	**330,819**
Tatimi mbi fitimin	-72,821	-65,788	-51,620
Fitimi i Vitit	**399,271**	**322,304**	**279,199**

Zëri më i rëndësishëm i të ardhurave të shoqërisë natyrisht është ai i të ardhurave nga interesi i portofolit të kredive. Në linjë me ecurinë pozitive, në rritje, të madhësisë së portofolit të kredive,

[2] Pasqyrë Individuale e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

	të ardhurat nga interesi kanë njohur një rritje të vazhdueshme përgjatë viteve duke shënuar vlerën më të lartë historike prej rreth 1,48 miliardë Lekë në fund të vitit 2022. Përveç, të ardhurave nga interesi, burimi tjetër i rëndësishëm i të ardhurave të shoqërisë janë "komisionet dhe tarifat" të cilat ndjekin trajektoren e aktivitetit të kredidhënies pasi lidhen në mënyrë direkte më vlerat e kredive të dibursuara. Përsa i përket shpenzimeve të shoqërisë, shpenzimet për personelin si dhe shpenzimet për interesat e financimit të shoqërisë nga palët e treta përbëjnë zërat me peshën më të madhe në rradhën e shpenzimeve të shoqërisë. Duke përmbledhur, performanca financiare e NOA sha ka njohur rritje të vazhdueshme përgjatë viteve. Struktura e aktiveve dhe pasiveve nuk kanë shënuar ndryshime të rëndësishme përgjatë viteve. Një analizë e shpejtë horizontale e treguesve më domethënës për Institucionin paraqitet nëpërmjet tabelës së mëposhtme.

Treguesit Kryesorë të Performancës Financiare	2022	2021	2020
% e Rritjes së Aseteve	20%	10%	4%
% e Rritjes së Detyrimeve	22%	7%	-1%
% e Rritjes së Total Kapitalit	13%	21%	22%
% e Rritjes së Portofolit Neto	20%	13%	8%
% e Rritjes së Portofolit Bruto	20%	14%	6%
Portofol Kredie Neto /Asete	87%	86%	84%
PAR +90 (portofoli me vonesa mbi 90 dite)	2.0%	2.2%	2.4%
Raporti i Kapitalizimit (Kapitali/Gjendje portofoli)	31%	33%	31%
Kthimi nga Aktivet (ROA)	5%	5%	5%
Kthimi nga Kapitali (ROE)	20%	19%	20%
Raporti Aktive / Kapital	3.8	3.6	3.9
Raporti i Levës Financiare	2.8	2.6	2.9
Kapitali / Aksion (mijë Lekë)	28.95	25.6	21.2
Fitimi për Aksion (mijë Lekë)	5.5	4.4	3.8
Numri i Aksioneve	73,183	73,183	73,183
Vlera e dividentit të pagauar (mijë Lekë)	156,538	-	-

Pika 3

Pika 3. Rreziqet kryesore për Emetuesin

Emetuesi, institucioni financiar jo-bankë NOA sh.a., përballet me një sërë rreziqesh gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij; rreziqe që lidhen dhe/ose derivojnë nga ambjenti i jashtëm ekonomik ashtu edhe rreziqe të tjera që lidhen me faktorë të brendshëm të shoqerisë. Më poshtë, listohen dhe trajtohen në formë të përmbledhur rreziqet kryesore për emetuesin të cilat mund të ndikojnë në aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet ndaj obligacionmbajtësve. Emetuesi deklaron se lista e mëposhtme e rreziqeve nuk është shteruese dhe se aftësia e tij për të përmbushur detyrimet që burojnë nga obligacioni mund të ndikohet edhe nga faktorë të tjerë të pa-identifikuar në datën e këtij Prospekti .

Këto rreziqe trajtohen më gjerë në Kreun II të këtij Prospekti.

1. **Rreziku i kredisë (rreziku i aktivitetit të kredidhënies)**

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare nëse një klient apo pala tjetër e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, i cila rrjedh kryesisht nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve, nga fondet pranë institucioneve të tjera financiare si dhe zërat e tjerë të paregjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar. Për qëllime të administrimit të rrezikut, NOA mbledh dhe vlerëson të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si p.sh rreziku i

	dështimit të një huamarrësi të veçantë dhe rreziku i sektorit), duke përfshirë pozicionin financiar të debitorit dhe aftësinë e tij paguese. Administrimi i rrezikut të kredisë kryhet në mënyrë të vazhdueshme: o duke monitoruar limitet e ndryshme te vendosura persa i përket shumës maksimale të kredisë, portofolit të kredisë dhe përqëndrimin e ekspozimit. o formuluar politika dhe procedura të kredisë, të cilat përcaktojnë kërkesat për garancitë, klasifikimin dhe raportimin e rrezikut, procedurat dokumentuese dhe ligjore, dhe pajtueshmërinë me kërkesat statutore. o monitorimin e cilesise se vendimarrjes nga strukturat e ndryshme autorizuese te kredive (komitetet e kredive ne nivele te ndryshme), monitorimin e kategorive të rrezikut, duke i kategorizuar ekspozimet në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare dhe rreziqet e pritshme. o rishikimin dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë ndaj klientëve nga Departamenti i Rrezikut të Kredisë, në mënyrë të pavarur. o trajnimin, këshillimin dhe dhënien e udhëzimeve të ndryshme ndaj njësive të biznesit për të zhvilluar praktikat më të mira të administrimit të rrezikut të kredisë ne te gjithe Institucionin Çdo njësi biznesi zbaton politikat dhe procedurat e kredisë në përputhje me autoritetet aprovuese të deleguara. Përqëndrimi i rrezikut të kredisë i cili vjen nga instrumentet financiare ekziston për palët e tjera kur ato kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që do të bënin që aftësia e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të ndikohet në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në kushtet ekonomike ose kushte të tjera. Shumica e përqëndrimit të rrezikut të kredisë vjen nga lloji i klientit në lidhje me huatë dhënë klientëve nga Shoqëria. Niveli i rrezikut : I Mesëm 2. Rreziku i ndikimit të forcave madhore (si pandemia Covid-19), është mundësia e ndikimit në biznesin dhe/ose gjendjen financiare të emetuesit te një ngjarje natyrore ose shoqërore, si tërmet, ciklon, përmbytje, shpërthim vullkanik, zjarr, luftë, konflikt i armatosur, akt terrorist, epidemi, pandemi, e cila do të pengonte emetuesin të realizonte objektivat e biznesit apo edhe të përmbushte detyrimet e tij. Ngjarjet e konsideruara si forca madhore ndodhin në mënyrë të rastësishme, të paparashikuar e nuk mund të shmangen nga emetuesi pavarësisht përpjekjeve apo kujdesit të tij. Niveli i rrezikut : I Mesëm 3. Rreziku i varësisë nga financuesit e huaj. NOA e ka mbështetur financimin e biznesit të saj në një masë të madhe me huatë e marra nga institucionet financiare ndërkombëtare. Shumë prej institucioneve mikrofinanciare në Shqipëri kanë të njëjtin model të financimit të biznesit të tyre kryesisht nga partnerë të huaj. Nga totali i huave gjendje më 31 Dhjetor 2022, 81% e tyre janë hua nga financuesit e huaj dhe vetëm 19% janë financime nga bankat lokale (kryesisht financime kundrejt kolateralit "portofol kredie të NOA-s"). Rreziku i varësisë nga financuesit e huaj lidhet me impaktin negativ të ndonjë krize financiare globale në aftësinë e këtyre institucioneve të huaja për të: - levruar fondet e mbetura të financimeve të nënshkruara më herët; - për të lidhur marrëveshje të reja financimi apo rinovuar marrëveshjet me maturim të afërt. Niveli i rrezikut : I Mesëm 4. Rreziku i likuiditetit

Ky është rreziku i mungesës së fondeve të nevojshme për shlyerje në afat të detyrimeve që emetuesi ka kundrejt te tretëve, përfshirë obligacionmbajtësit. Mungesë likuiditeti do të konsiderohet çdo situatë në të cilën emetuesi:

- nuk disponon aktive likuide të mjaftueshme ose ka vështirësi për t'i realizuar ato në treg, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kur ato maturohen dhe kërkohen nga kreditorët, ose
- nuk ka mundësi të financojë rritjen e aktiveve të veta (pra nuk ka mundësi të rrisë portofolin e kredive).

Niveli i rrezikut : I Mesëm

5. Grupi i Rreziqeve të Tregut

5.1. Rreziku i ndryshimit të normave të interesit

Ndryshimi i normave të interesit në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në koston e financimit të biznesit. Kështu, një rritje e normave të interesit në treg mund të shkaktojë rritje të kostos së financimit të aktivitetit dhe si pasojë mund të ulë përfitueshmërinë financiare te Institucionit (ul marzhin e fitimit nga huadhënia) dhe/ose të ushtrojë presion në drejtim të rritjes së normave të interesit të kredive për klientët duke rrezikuar interesin dhe konkurrueshmërinë e produkteve të NOA-s.

Niveli i rrezikut : I Mesëm

5.2. Rreziku i luhatjes së padëshirueshme të kursit të këmbimit

Ndërkohë që shumica e marrëveshjeve të financimit të NOA-s nga palë të treta janë në monedhën Euro (75% per vitin 2022), të ardhurat e saj nga aktiviteti (interesat nga portofoli i kredisë) janë kryesisht në monedhën Lekë pasi portofoli i kredisë së NOA-s është në masën 86% i denominuar në monedhën vendase si më 31 Dhjetor 2022.

Mospërputhja e valutës së detyrimeve të NOA-s (Euro) me valutën e të ardhurave të saj, e ekspozon institucionin ndaj rrezikut të zhvlerësimit të monedhës Lekë (monedhës së të ardhurave). Në rast zhvlerësimi të Lekut ose humbje të fuqisë blerëse të tij, do të nevojiteshin më shumë "Lekë" për shlyerjen e detyrimeve kontraktuale në Euro të Institucionit.

Niveli i rrezikut : I Ulët

6. Rreziku Operacional

Rreziku operacional konsiderohet mundësia e humbjes që vjen si pasojë e dështimit apo e papërshtatshmërisë së proceseve të brendshme, njerëzve dhe sistemeve apo si pasojë e ngjarjeve të jashtme.

Sistemet teknologjike të informacionit mund të shkaktojnë dëme si pasojë e proçeseve të pamjaftueshme ose të dështuara të kontrollit dhe mbrojtjes; gabimeve njerëzore; mashtrimit; apo ngjarje të jashtme që shkaktojnë ndërprerjen e biznesit. Këto raste përveç humbjes së të dhënave, rezultojnë në rënien e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve.

Niveli i rrezikut : I Mesëm

7. Rreziku i incidenteve kibernetike

Rreziku i incidenteve kibernetike përfaqëson humbjen e mundshme të natyrës financiare, ndërprerje biznesi apo dëmtim/shkatërrim të reputacionit të shoqërisë si pasojë e sigurisë së ulët të sistemeve të teknologjisë së informacionit në përdorim nga emetuesi duke lejuar/mos penguar rrjedhjen e të dhënave kritike, ndërprerjen e aksesesit në informacion dhe si rrjedhojë shërbimin normal të klienteles, etj.

Niveli i rrezikut : I Mesëm

	8. Ngjarje kritike të natyrës politike/gjeopolitike si dhe recensioni i ekonomisë në përgjithësi Ngjarje/situata të tilla mund të ndikojnë në uljen e kërkesës për kredi dhe/ose në përkeqësimin e cilësisë së portofolit të kredisë së NOA, dhe si pasojë në performancën financiare të shoqërisë. Situata aktuale makroekonomike, me një normë inflacioni përtej objektivit të Bankës së Shqipërisë dhe masat e marra për frenim duke rritur normën bazë të interesit, kanë shtuar pasiguritë e operatorëve ekonomikë në vend. Niveli i rrezikut : I Mesëm 9. Rreziku Ligjor dhe Rregullator Rreziku ligjor përfaqëson mundësinë që emetuesi të pësojë humbje financiare si rezultat i moszbatimit/zbatimit në mënyrën jo të duhur të detyrimeve ligjore dhe/ose kontraktuale, duke përfshirë dhe procedura të tjera ligjore të cilat mund të ndikojnë negativisht në rezultatin financiar. Cdo ndryshim ligjor apo rregullator, i cili kufizon apo ndikon mënyrën se si zhvillohet aktiviteti i kredidhënies, (qoftë përmes ndryshimit të trajtimit fiskal të aktivitetit, vendosjes së tavaneve të cmimeve apo kërkesa të shtuara), ose menyren e mbledhjes së detyrimeve të klientëve të saj në vonesë, do të kishte ndikim negativ në ecurinë e biznesit, situatën financiare dhe rezultatet e operacioneve të saj. Niveli i rrezikut : I Ulët 10. Rreziku reputacional Rreziku reputacional eshte rreziku aktual ose i ardhshem, i cili shkakton humbje per shkak te perceptimit te pafavorshëm të imazhit të një nstitucioni financiar nga konsumatorët, bashkëpunëtorët, aksioneret, investitorët dhe autoritetet mbikqyrëse. Rreziku reputacional, si një nga rreziqet që mund të dëmtojë institucionet financiare në mënyrë të menjëhershme dhe te drejtperdrejte, ka si element kryesor vlerësimin e dyshimeve te mundshme për përfshirje apo përdorim të institucioneve financiare për qëllime të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit; mungesën e transparencës në marrëdhëniet me klientët; mosrespektimin e kushteve të punës; mosrespektimin e termave të kontratave, praktikave jo të mira të mbrojtjes së konsumatorit, etj. Niveli i rrezikut : I Ulët

RUBRIKA 3 - Tiparet Kryesore të Titujve

Pika 1.	Pika 1. Tiparet kryesore të titujve Obligacionet e NOA sh.a. janë instrumente borxhi lirisht të transferueshme dhe emetohen nga emetuesi në formë të dematerializuar përmes një oferte publike. Obligacionet e NOA sh.a janë obligacione të nënrenditura, afatgjata, të pa-garantuara, me normë fikse interesi prej 8,00% dhe afat 5 (pesë) vjeçar. Shlyerja e obligacionit do të realizohet nëpërmjet një pagese të vetme në datën e maturimit ndërsa interesi (kuponi) është i pagueshëm çdo gjashtë muaj sipas kalendarit të paraqitur më poshtë.

Pika 1.1	**Pika 1.1 Lloji, klasa dhe numri ndërkombëtar ose kombëtar i identifikimit i emetuesit** Në përputhje me llojet e obligacioneve të njohura në literaturë, obligacionet e NOA sha janë: o pa garanci, o me kupon/interes të pagueshëm cdo 6 (gjashtë) muaj; o me normë interesi fikse përgjatë gjithë jetëgjatësisë (8,00% p.a); o me shlyerje nëpërmjet një pagese të vetme në datën e maturimit; o afatgjatë (maturitet 5 vjecar/60 mujor); o pa të drejta të vecanta pra nuk janë obligacione të konvertueshme në aksione, nuk janë obligacione me pjesëmarrje, nuk janë obligacione të këmbyeshme; o me rradhë shlyerje pas të gjitha detyrimeve të tjera të garantuara e të pagarantuara të NOA-s; o pa kufizime për kalimin e pronësisë; Numri i Identifikimit të Emetuesit: K11604002V Numri i Identifikimit të Titullit (ISIN) : AL0022100146 Numri Nderkombëtar i Identifikimit të Titujve / Numri Shqiptar i Identifikimi të Titujve për obligacionet përcaktohet ditën e regjistrimit të tyre pranë Regjistrarit Shqiptar të Titujve (ALREG Sh.a.).
Pika 1.2	**Pika 1.2 Monedha, prerja, vlera nominale, numri i titujve dhe afati i maurimit i titujve.** o Obligacionet janë të denominuara në monedhën Lekë (ALL). o Obligacionet do të emetohen me 100% të vlerës nominale të tyre. o Vlera nominale e çdo obligacioni është 500.000,00 (Pesëqind mijë) Lekë. o Shuma minimale e nënshkrimit /kërkesës për blerje obligacionesh për çdo investitor është 500.000,00 (Pesëqind mijë) Lekë. o Shuma nominale maksimale e obligacioneve që pritet të emetohen është 500.000.000,00 (Pesëqind milionë) Lekë dhe në numër janë 1,000 obligacione. o Afati: 5 vjecar/60 mujor.
Pika 1.3	**Pika 1.3 Të drejtat që lidhen me titullin e emetuesit** ➢ **Të drejta themelore të mbajtësve të obligacioneve** Mbajtësit e obligacioneve gëzojnë: o të drejtën e arkëtimit të 100% të vlerës nominale të obligacioneve të zotëruara prej tyre në datën e maturimit të tyre; o të drejtën e arkëtimit të interesit kupon cdo gjashtë muaj deri në fund të jetëgjatësisë së obligacioneve;

	o të drejtën e organizimit në grup së bashku me të gjithë zotëruesit e tjerë të këtyre obligacioneve dhe të drejtën e caktimit të një përfaqësuesi, i cili është përgjegjës për përfaqësimin e interesave të tyre përkundrejt Emetuesit dhe palëve të treta. Në rast se nuk është e mundur që obligacionmbajtësit të zgjedhin përfaqësues, ky përfaqësues zgjidhet nga Emetuesi. Përfaqësues të obligacionmbajtësit mund të jenë shoqëritë komisionere dhe shoqëri të tjera të caktuara nga obligacionmbajtësit. Nuk mund të zgjidhen si përfaqësues të obligacionmbajtësve administratorët apo personat që kanë lidhje të ngushta apo konflikt interesi me emetuesin. Pagesa e përfaqësuesit të obligacionmbajtësve paguhet nga emetuesi; o të drejtën e informimit të menjëhershëm nga Kujdestari në rast se Emetuesi nuk përmbush detyrimet kundrejt obligacionmbajtësve dhe kujdestarit, në mënyrën dhe kohën e duhur, sipas parashikimeve të këtij Prospekti. o të drejtën të ngrejnë pretendime ndaj Emetuesit në rast se ky i fundit dështon në përmbushjen e detyrimeve ndaj obligacionmbajtësve. Në raste të tilla të mospërmbushjes së detyrimeve nga Emetuesi, Përfaqësuesi i zotëruesve të obligacioneve (pas autorizimit nga obligacionmbajtësit) ka fuqinë për të paraqitur në gjykatë kërkesë për fillim procedure penale apo procedure ekzekutimi. o të drejtën të ngrejnë pretendime ndaj Kujdestarit dhe/ose Agjentit Pagues (shlyerës) në rast se ky/këta të fundit dështon/jnë në përmbushjen e detyrimeve ndaj obligacionmbajtësve pasi është verifikuar që mos përmbushja e detyrimeve të tyre nuk ka ardhur si pasojë e dështimit të pagesave nga Emetuesi. Në rast se arsyeja e mospërmbushjes së detyrimeve të Kujdestarit/Agjentit Pagues është dështimi i shlyerjes së detyrimeve nga ana e Emetuesit përkundrejt obligacionmbajtësve dhe kujdestarit, atëhere përgjegjës i vetëm ligjor për mospërmbushje e detyrimeve do të jetë Emetuesi. ➢ Garancia dhe Rradha e Shlyerjes së Borxhit Obligacionet përbëjnë detyrime pa garanci të Emetuesit, pra shlyerja e vlerës nominale të obligacionit në maturim ashtu edhe shlyerja periodike e detyrimeve të emetuesit për kuponat gjashtëmujorë, nuk garantohet me ndonjë aset apo me mjetet e ndonjë personi/subjekti tjetër që mund të luante rolin e garantit. Shlyerja e detyrimeve ndaj obligacionmbajtësit mbështetet vetëm në mjetet e Emetuesit, disponueshmëria e të cilave varet në mënyre direkte nga performanca e biznesit të Emetuesit. Në rradhën e shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë, këto obligacione renditen pas të gjitha detyrimeve të tjera të garantuara e të pagantuara që shoqëria ka/mund të ketë në të ardhmen. Pra, në çdo rast, pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë kanë përparësi shlyerje më të lartë krahasuar me pretendimin mbi kontratën e obligacionit. Këto obligacionet renditen pari passu (pra, në mënyrë të barabartë) dhe pa përparësi mes tyre. ➢ Të drejta të tjera Obligacionet nuk mbartin të drejta të vecanta; - ato nuk janë obligacione të konvertueshme në aksione; - nuk janë obligacione me pjesemarrje në fitimin e shoqërisë emetuese; - nuk janë obligacione të këmbyeshme.
Pika 1.4	Pika 1.4 Përparësia relative e titujve në strukturën e kapitalit të emetuesit në rast falimentimi, përfshi, kur është nevoja, informacione për shkallën e nënrenditjes së titujve të emetuesit

	Në rast të zbatimit të procedurës të falimentimit të parashikuar në Ligjin nr. 110/2016 "Për falimentimin", obligacionmbajtësit do të konsiderohen si "kreditorë të pasiguruar" dhe do të shlyhen dhe renditen pas një sërë kategorive të kreditorëve të tjerë të shoqërisë, por përpara kreditorëve fundorë (si p.sh.: palët e lidhura apo kreditorë për pretendime të lidhura me sanksione/gjoba) dhe aksionarëve të shoqërisë. Pra, obligacionmbajtësit do të shlyhen vetëm pasi të jenë shlyer të gjithë kreditorët e kategorive pararendëse por përpara shlyerjes së aksionarëve të shoqërisë.
Pika 1.5	Pika 1.5 Kufizimet për transferimin lirisht të titujve të emetuesit Nuk ka asnjë kufizim për transferimin lirisht të obligacioneve të NOA-s.
Pika 1.6	Pika 1.6 Sipas rastit, politikën e dividendit dhe pagesave të emetuesit E pa-aplikueshme.
Pika 2	Pika 2 Tregtimi i titujve (Përcaktimi i tregut të rregulluar ku tregtohen titujt) NOA sh.a. angazhohet të listojë obligacionet në segmentin "Tregu Zyrtar Standard" i Bursa Shqiptare e Titujve ALSE menjëherë pas plotësimit të kushtit të vendosur nga Emetuesi mbi % minimale të nënshkrimit të obligacioneve për ta konsideruar ofertën e suksesshme,prej të paktën 10% të ofertës. Këto obligacione do të mund të tregtohen normalisht në Bursë nga zotëruesit e tyre dhe blerësit e tjerë potencialë, pa asnjë kufizim në transferueshmërinë e pronësisë, duke instruktuar Anëtarët (Brokerat) e Bursës Shqiptare të Titujve për blerje apo shitje të titujve. Si më datën e publikimit të këtij Prospekti, Anëtarët e Bursës Shqiptare të Titujve, pranë të cilëve mbajtësit e obligacioneve dhe investitorët potencialë mund të drejtohen për të vendosur urdhëra shitje dhe blerje, janë: 1. Banka Credins sh.a., mbajtëse e Licencës Nr.07, datë 28.02.2022, "Për ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj"lëshuar nga AMF, me të dhëna kontakti si më poshtë: Tel: +355 45353000 e-mail: info@bankacredins.com 2. Banka Amerikane e Investimeve sh.a. mbajtëse e Licencës Nr.06, datë 28.02.2022, "Për ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj" lëshuar nga AMF, me të dhëna kontakti si më poshtë: Tel: +355 42 258 755 e-mail: info@abi.al Anëtarët në Bursë mund të shtohen apo ndryshojnë ndaj obligacionmbajtësit mund të kontrollojnë kurdoherë listën e përditësuar të anëtarëve në website të Bursës Shqiptare të Titujve ALSE sha (https://alse.al/kreu/sherbimet/anetaresimi/lista-e-anetareve-te-alse/).
Pika 3	Pika 3 Garancitë që lidhen me titujt (nëse ka) Këto obligacione janë tituj të PA-garantuar të Emetuesit. (Pikat 3.1 deri 3.4 të formatit standard të Prospketit nuk janë paraqitur, duke qënë se përmbajtja e tyre i referohet informacionit mbi garancinë/garantin.)

Pika 4	Pika 4 Rreziqet kryesore që janë specifike për titujt 1. Rreziku i kredisë (kundërpartisë)/mosshlyerjes Investitorët, nëpërmjet blerjes së obligacioneve të emetuara nga NOA bëhen financues /kreditorë të këtij subjekti, duke u ekspozuar ndaj rrezikut të mos kthimit të financimit të tyre nga emetuesi. Pa-aftësia paguese dhe/ose falimenti i emetuesit janë risqe që shoqërojnë cdo lloj investimi në tituj borxhi apo edhe kapitali. NOA përmes të gjitha vendimmarrjeve të saj synon vetëm rritjen e qëndrueshme dhe fuqizimin e mëtejshëm të institucionit ndaj paratë që do të mblidhen nga oferta e obligacioneve do të përdoren me qëllim rritjen e volumit të kreditimit të klientëve të saj. Injektimi i "parasë së re" në aktivitetin kredidhënës të NOA-s, do të rrisë asetin më të rëndësishëm të shoqërisë (pasi është ai që gjeneron të ardhurat), portofolin e kredisë. Ekipi menaxherial i NOA ka drejtuar dhe do të vazhdojë të drejtojë shoqërinë duke zbatuar parimet më të mira të qeverisjes dhe duke ndjekur kurdoherë strategjinë e rritjes së kujdesshme dhe të mirë-studiuar, për të zvogëluar në maksimum gjasat e problemeve financiare që mund të conin në ngjarje falimenti apo pa-aftësie paguese. Sikurse vërtetohet nga të dhënat financiare të paraqitura në këtë Prospekt si dhe Pasqyrat Financiare të audituara (bashkëlidhur Prospektit) , NOA ka një biznes të konsoliduar dhe gëzon një nivel të lartë shëndeti financiar. Informacioni i mëposhtëm përshkruan në mënyrë domethënëse situatën financiare të shoqërisë: - NOA ka rezultuar me fitim, cdo vit financiar përgjatë gjithë 11 viteve të fundit; - Fitimi i NOAs ka ardhur në rritje të vazhdueshme e të ndjeshme prej vitit 2014 e në vijim; - Fitimi mesatar i 10 viteve të fundit rezulton rreth 200 milionë Lekë (ose rreth 1,7 milionë Euro), fitimi mesatar i 5 viteve të fundit rezulton rreth 290 milionë Lekë (ose rreth 2,5 milionë Euro) dhe ai mesatar i 3 viteve të fundit është rreth 336 milionë Lekë (ose rreth 2,9 milionë Euro). Përmirësimi i vazhdueshëm i përformancës financiare të institucionit, edhe në kushtet e konkurrencës së fortë mes institucioneve kredidhënëse Jo-Banka, dëshmon menaxhimin e suksesshëm të aktivitetit nga ekipi drejtues profesionist dhe vizionar i NOA-s. *1.1 Risku i mungesës së garancisë* Duke qene se obligacionet e emetuara nga NOA janë të pagarantuara, investitori përballet me një rrezik më të lartë të humbjes së pjesshme ose të plotë të vlerës së investuar prej tij në Obligacionet e NOA-s. Nëse obligacionet do të ishin të garantuara, investitorët do të mund të përfitonin vlerën monetare nga ekzekutimi i garancisë se obligacioneve në rast dështimi pagese nga emetuesi, por këto obligacione që NOA emeton sipas këtij Prospekti janë të pagarantuara ndaj nëse emetuesi nuk do të mund të paguajë kuponët dhe /ose principalin, pra dështon në pagesa, atëhere investitori do të përballet me një rrezik më të lartë të humbjes së investimit të tij. *1.2 Risku i statusit të obligacionit si " i nënrenditur"*

	Në rastin e shpalljes së paaftesisë paguese nga NOA, obligacionmbajtësit renditen pas gjithë detyrimeve te tjera, të tashme e të ardhme, te garantuara dhe të pagarantuara të Emetuesit. Obligacionmbajtësit duhet të tregohen vigjilentë ndaj treguesve të borxhit të shoqërisë NOA sh.a. në mënyrë që të vlerësojnë sic duhet dhe në mënyrë të vazhdueshmë këtë rrezik përgjatë gjithë jetëgjatësisë së obligacionit. Kështu, rritja e shpejtë dhe e konsiderueshme e detyrimeve (të reja) të Emetuesit në të ardhmen do të rriste riskun e këtij titulli pasi do të përkeqësohej rradha e shlyerjes së obligacionmbajtësve. E kundërta do të ndodhë në rast se Emetuesi ul balancat e detyrimeve ndaj të tretëve; në këtë rast do të ulej risku që shoqëron investimin në këtë titull pasi do të përmirësohej rradha e shlyerjes së obligacionmbajtësve. Statusi i obligacionit si i " nënrenditur" rrit riksun e shlyerjes së pjeshme ose moshlyerjes së shumës së investuar ne rast pa-aftësie paguese të Emetuesit, pasi prioritet në shlyerje do të kenë të gjithë "financuesit" e tjerë të NOAs. Niveli i rrezikut: I Mesëm 2. Rreziku i mungesës së tregut/ likuiditetit Është risku që përfaqëson vështirësinë ose në raste të caktuara edhe pamundësinë nga ana e investitorit që ti shesë obligacionet përpara skadencës së tyre kontraktuale. Tregu jo-aktiv i letrave me vlerë korporative si pasojë e një kërkesë – oferte minimale për to, dëshmuar nga numri shumë i ulët i transaksioneve në treg sekondar me titujt privatë, evidenton vështirësinë e kthimit në likuiditete të titujve të tillë. Theksuar sa më sipër, investitori duhet ta ketë të qartë se periudha kohore e investimit në obligacione, duhet të jetë në një linjë me nevojat e tij për likuiditete në të ardhmen. Ky rrezik zbutet nga fakti që obligacioni i NOA-s është i listuar në Bursë dhe cdo investitor i interesuar për të shitur këtë titull i drejtohet tregut të rregulluar nëpërmjet anëtarëve / brokerave të Bursës. Mundësia që Bursa si një vend i qendërzuar i tregtimit të titujve krijon për ballafaqimin e kërkesës dhe ofertës, për shpërndarjen e të gjithë informacionit të nevojshmëm mbi Emetuesit e titujve të listuar, si dhe për reflektimin e cmimeve të drejta të titujve (çmimet e ekzekutimit të transaksioneve-informacion publik i ofruar nga Bursa), rrit mundësitë e kthimit të sukseshëm në likuiditet të titujve. Shtimi i numrit të korporatave që vendosin të emetojnë obligacione korporative përgjatë dy viteve të fundit, përfaqëson një premisë pozitive për zhvillimin e këtij tregu në përgjithësi, rritjen e interesit të investitorëve për të investuar në tituj korporativë (pasi të kenë "testuar" këto lloj investimesh), rritjen e numrit të transaksioneve me këto tituj e si pasojë edhe rritjen e shkallës së likuiditetit të tyre. Pavarësisht këtij interpretimi dhe pritshmërive tona, risku i mungesës së tregut mbetet ndër risqet kryesore të investimit në obligacione në Shqiperi. Niveli i rrezikut: I Mesëm 3. Rreziku i normës së interesit Investimi në obligacionet e NOA shoqërohet nga risku i normës së interesit. Kështu, në rast se normat e interesit në treg rriten, vlera e tregut (çmimi) të obligacioneve të NOA-s do të bjerë pasi do të ulet atraktiviteti i tyre për investitorët (pasi këta të fundit do të jenë të interesuar të blejnë tituj të tjerë me norma më të larta interesi). Ky është një risk që bëhet prezent në rastin kur investitorët dëshirojnë të shesin obligacionet para maturitetit të tyre dhe nga shitja e tyre rrezikojnë të marrin një cmim edhe më të ulët nga cmimi i blerjes (në rast të zhvlerësimit shumë të madhe të titullit si pasojë e një rritje shumë të ndjeshmë të normave të interesit).

Investitori që vendos të mbajë në portofolin e tij titullin e zhvlerësuar (si pasojë e rritjes së interesave të tregut) përshkak të pamundësisë për ta shitur me çmim të pranueshëm sipas vlerësimit të tij, duhet të vlerësojë me kujdes të ardhurat që do të realizonte nëse do të investonte vlerën eventuale të shitjes së obligacionit të zhvlerësuar në një titull tjetër me normë interesi që reflekton nivelin e rinj të interesave të tregut.

Referuar situatës makroekonomike, Banka e Shqipërisë mund të vijojë drejt normalizimit të qëndrimit të politikës monetare edhe gjatë vitit 2023, duke rritur më tej normën e interesit bazë me qëllim frenimin e rritjes së mëtejshme të inflacionit.

Niveli i rrezikut: I Mesëm

4. Rreziku i kursit të këmbimit

Zhvlerësimi i monedhës në të cilën denominohet obligacioni do të thotë zhvlerësim i vlerës së obligacionit kundrejt monedhave të tjera. Zhvlerësimi i monedhës së obligacionit do të thotë gjithashtu që interesi i arkëtuar në formën e kuponeve gjashtëmujore do të ketë një vlerë me ulët në raport me monedhat e tjera, ndaj investitorët duhet të tregohen të kujdesshëm në zgjedhjen e investimit dhe mundësisht të sigurojnë një harmonizim mes monedhës në të cilën përfitojnë të ardhurat dhe monedhës në të cilën realizojnë shpenzimet.

Në rast se monedha "Lekë" në të cilën denominohet obligacioni zhvlerësohet kundrejt monedhës në të cilën investimi mbahet në kontabilitet (për investitorët subjekte), vlera e investimit konvertuar në monedhën e raportimit do të bjerë dhe interesi i arkëtuar në monedhën e obligacionit do të ketë një vlerë më të vogël konvertuar në valutën e aktivitetit/raportimit të librave kontabël. Për këtë arsye është e rëndësishme që investitori të mbajë kurdoherë në konsideratë monedhën e investimit dhe risqet e lidhura me luhatshmërinë e saj.

Niveli i rrezikut: Në varësi të strukturës së të ardhurave dhe ekspozimit ndaj valutave të secilit investitor. Rreziku i luhatjeve të kursit të këmbimit do të jetë i ulët për investitorët që i kanë të ardhurat në monedhën e obligacionit (Lekë) dhe mund të jetë i "mesëm" në "i lartë" për investitorët që i kanë të ardhurat pjesërisht ose plotësisht në monedhë të ndryshme nga Leku (monedha e obligacionit).

5. Rreziku reputacional

Reputacioni i shoqërisë, ecuria e aktivitetit të saj, lajmet dhe informacionet e shpërndara në media për aktivitetin e emetuesit etj, janë që të gjithë faktorë që luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësinë apo vështirësinë e shitjes së instrumentit në tregun sekondar dhe si pasojë edhe në përcaktimin e cmimit korrent të titullit.

Niveli i rrezikut: I Ulët

6. Rreziku i luhatjes së normës së inflacionit

Inflacioni e ul vlerën reale të obligacioneve me kalimin e kohës, çka mund të prekë atë që mund të blini me investimin tuaj në të ardhmen dhe mund ta bëjë normën fikse të pagueshme mbi obligacionet relativisht më pak tërheqëse në të ardhmen, çka cenon çmimin që mund të arrinit nga shitja e obligacioneve.

Niveli i rrezikut: I Mesëm

7. Rreziku që lidhet me ndryshimin e kuadrit fiskal

	Të ardhurat neto nga investimi në obligacion do të varen nga regjimi tatimor në fuqi. Emetuesi nuk është në gjendje të parashikojë nëse në të ardhmen do të ketë apo jo ndryshime në trajtimin fiskal të investimit/të të ardhurave nga investimi. Në këtë mënyrë, vlera neto e obligacionit mund të jetë subjekt ndryshimi në të ardhmen në rast se Qeveria merr vendime për të ndryshuar trajtimin fiskal të këtyre lloj investimeve (të ardhurave të derivuara prej tyre). Niveli i rrezikut: I Ulët

RUBRIKA 4 – Informacione Kryesore rreth Titujve

Pika 4.1	Pika 4.1 Kushtet dhe kalendari i ofertës së titujve Kriteret e përgjithshme - Obligacionet e NOA sh.a. janë instrumente borxhi lirisht të transferueshme dhe emetohen nga emetuesi në formë të dematerializuar përmes një oferte publike. - Obligacionet e NOA sh.a janë obligacione afatgjata, të pa-garantuara, me normë fikse interesi prej 8% , afat 5 (pesë) vjeçar dhe të denominuara në monedhën Lekë. Shlyerja e obligacionit do të realizohet nëpërmjet një pagese të vetme në datën e maturimit ndërsa interesi (kuponi) është i pagueshëm çdo gjashtë muaj sipas kalendarit të paraqitur më poshtë. - Obligacionet do të emetohen me 100% të vlerës nominale të tyre. - Vlera nominale e çdo obligacioni është 500.000,00 (Pesëqind mijë) Lekë. - Shuma minimale e nënshkrimit /kërkesës për blerje obligacionesh për çdo investitor është 500.000,00 (Pesëqind mijë) Lekë. - Shuma nominale maksimale e obligacioneve që pritet të emetohen është 500.000.000,00 (Pesëqind milionë) Lekë dhe në numër janë 1.000 obligacione. - Emetuesi ka zgjedhur dhe autorizuar Bankën Credins sh.a. si ndërmjetës financiar për shërbimin e hedhjes në treg të këtyre titujve sipas kushteve dhe parashikimeve të kontratës së lidhur mes palëve. Informacion mbi Nënshkruesin: Banka Credins sh.a. është licencuar me vendimin Nr.33, datë 28.02.2022 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ofrimin e shërbimeve të investimit të listuara më poshtë dhe shërbimeve ndihmëse që lidhen me to: ✓ Nënshkrimi i instrumenteve financiare dhe/ose hedhja në treg e instrumenteve financiare në bazë të angazhimit në transaksion; ✓ Hedhja në treg e instrumenteve financiare pa angazhim shitjeje. NOA sh.a dhe Banka Credins sh.a kanë lidhur marrëveshjen mr Nr.10157 Prot (Banka Credins) dhe Nr.46917 Prot (NOA), datë 24.04.2023 për nënshkrimin e Obligacionit të nënrenditur, me afat 5-vjecar, interes fiks 8% , denominuar në Lekë dhe i pa-garantuar. Marrëveshja e nënshkrimit ka objekt hedhjen në treg të ketij obligacioni me angazhim maksimal në transaksion deri në një limit

të përcaktuar mes palëve dhe hedhjen e tij në treg pa angazhim në transaksion për shumën deri në 400 milionë Lekë.

Kushtet dhe Kalendari i Pritshëm i Ofertës

Oferta pritet të hapet në datën 24 Maj 2023 dhe të mbyllet në orën 14.00 më 21 Qershor 2023 ose në një orë dhe datë të mëparshme që do të shpallet në vijim nga emetuesi.

Datat kryesore të lidhura me emetimin si dhe pagesën e kuponëve paraqiten si më poshtë:

Fillimi i periudhës së ofertës	*24 Maj 2023*
Fundi i periudhës së ofertës	*21 Qershor 2023*
Shpallja	*21 Qershor 2023*
(konfirmimi i shumës nominale gjithsej të obligacioneve që do të emetohen)	
Data e emetimit	*23 Qershor 2023*
Data e parë e pagimit të interesit	*23 Dhjetor 2023*
Data e maturimit	*23 Qershor 2028*

Interesi (kupon) planifikohet të paguhet më 23 Qershor dhe 23 Dhjetor; deri më datën e maturimit. Pagesa e pare e interesit do të bëhet më 23 Dhjetor 2023;. Nëse ndonjë prej këtyre datave nuk është ditë pune, atëherë pagesa e interesit do të bëhet ditën e parë të ardhshme të punës pa akumuluar interes shtesë.

Detaje të pranimit për t'u tregtuar në një treg të rregulluar

NOA sh.a. angazhohet të listojë obligacionet në segmentin "Tregu Zyrtar Standard" i Bursa Shqiptare e Titujve ALSE menjëherë pas plotësimit të kushtit të vendosur prej Emetuesit mbi perqindjen minimale të nënshkrimit të obligacioneve prej të paktën 10% të ofertës.

Plani i shpërndarjes

Kërkesat për blerje obligacioni gjatë periudhës së ofertës mund të bëhen vetëm përmes formularit të kërkesës që gjendet bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij Prospekti. Kërkesat e bëra në mënyra të tjera nuk do të pranohen.

Kërkesat për të blerë obligacione mund t'i paraqiten:

- drejtëpërdrejt shoqërisë emetuese NOA sh.a. pranë degës qendrore me adresë Rr. "Tish Daia", Komuna e Parisit, Kompleksi Haxhiu (Kika 2), Shkalla 11, Zyra nr. 1, Tiranë, Shqipëri si dhe pranë cdo filiali/dege të NOA sh.a në Republikën e Shqipërisë;

- Bankës Credins sh.a si ndërmjetës financiar i autorizuar nga emetuesi NOA sh.a për shitjen /shpërndarjen e obligacionit. Të dhënat e kontaktit dhe adresat e ndërmjetësit Banka Credins sh.a. janë si më poshtë:

    - Dega Qendër Banka Credins, me adresë "Rruga Vaso Pasha, Nr.8, Tiranë";

- Dega Tirana 1 Banka Credins, me adresë “Rruga Ismail Qemali, Nr.4, Tiranë”;
- Dega Tirana 3 “Rruga Muhamet Gjollesha” Njesia Administrative nr 7, Kodi Postar 1023,nr ndertese 98
- Dega Shkoder, “Rruga Sheshi Demokracia” nr 21,Brenda territorit te njesise administrative nr 1, ne ZK me nr 8591 dhe nr pasurie 2/1132
- Dega Vlora 1 Lagjia Pavaresia, Zona kadastrale 8602, nr pasurie 27/6 – N.1, vol 33 , faqe 119 dhe zona kadastrale 8602, nr pasurie 27/6-N32, Vol 33, faqe 150 Vlore.
- Dega Triana 2 Bulevardi Zogu i Pare Njesia administrative nr 9 kodi postar 1016, nr ndertese 2.
- Dega Fier 1 , Rruga "Sheshi Nene Tereza " Ndertesa 3 Hyrja 1, ZK 8533 dhe nr pasurie5/188-N2 dhe 5/188-N3
- Dega Tirana 11 Zona A-4, Njësia 5/10, ne Rrugen “Emin Duraku” dhe “Komuna e Parisit”
- Dega Tirana 5, Blv " Zhan D'ark" Njesia Administrative Nr 2,Kodi postar 1017, Nr Ndertese 55
- Dega Korce, Bulevardi "Republika",Lagja 12, P 11 H11 ,Kodi Postar 7001, ZK8561nr pasurie 2/392-N4

Përqindja e rezultatit të menjëhershëm të ofertës (sipas rastit).
Emetuesi NOA sh.a. , pas përfundimit të periudhës së ofertës do të realizojë shpalljen e emetimit duke komunikuar për publikun sasinë e obligacioneve të nënshkruara, pra perqindjen e realizimit të ofertës.

Vlerësimin e shpenzimeve të përgjithshme të emetimit, përfshi vlerësimin e përafërt të shpenzimeve që i ngarkohen investorit.
Emetuesi nuk do t’i ngarkojë investitorëve asnjë shpenzim apo tarife lidhur me emetimin e obligacioneve.
Obligacionet do të emetohen me çmimin e emetimit (100% të vlerës nominale) dhe shuma nominale agregate e obligacioneve që do të emetohen do të specifikohet në fund të periudhës së ofertës.

Vëmendje:

- ✓ Obligacionmbajtësi do t’i paguajë Kujdestarit tarifën e kujdestarisë të titujve sipas marreveshjes së nënshkruar me Kujdestarin Banka Credins sh.a., prej **0.20% të shumës së investimit.** Tarifa e kujdestarisë paguhet në favor të Kujdestarit cdo gjashtë muaj, në datat e kalimit të kuponëve.
  Në rast se investitori/obligacionmbajtësi dëshiron të zgjedhë një Kujdestar tjetër, të ndryshëm nga Kujdestari Banka Credins sh.a. i cili ka lidhur marrëveshjen me Emetuesin NOA sh.a. për ofrimin e këtij shërbimi investitorëve që kanë investuar/blerë këtë obligacion të emetuar nga NOA sh.a. kundrejt tarifës së negociuar prej 0,20% të shumës së investimit, atëhere tarifa e kujdestarisë që obligacionmbajtësi do t’i paguajë Kujdestarit

	tjetër do të jetë sipas kushteve dhe tarifave të dakordësuara mes obligacionmbajtësit dhe Kujdestarit tjetër. ✓ Interesi i perfituar nga investimi në këto obligacione i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat në përputhje me parashikimet e legjislacionit tatimor të Republikës së Shqipërisë. Taksat dhe tarifat që mund të ndryshojnë në të ardhmen do t'i ngarkohen mbajtësit të titullit dhe pasardhësve të tjerë të mbajtësve të tij. Në momentin e publikimit për herë të parë të këtij Prospekti taksa mbi të ardhurat nga interesi i fituar është **15%.** ✓ Obligacionmbajtësi duhet të mbajë kurdoherë në vëmendje kostot e tjera që lidhen me realizimin e transaksioneve me këto Tituj. Bankat dhe shoqërite komisionere ofrojnë shërbimet e tyre të tregtimit të titujve kundrejt tarifave të përcaktuara në kushtet e tyre të punës ose sic mund të dakordësohen mes tyre dhe klientëve. Duke qënë se ky obligacion pritet të listohet në Tregun Zyrtar Standard të Bursës Shqiptare të Titujve ALSE sh.a., cdo transaksion me këtë Obligacion, pas listimit të tij në Bursë, do të realizohet vetëm në këtë treg të rregulluar, ndaj angazhimi[3] i bankave dhe shoqërive komisionere anëtare ënë Bursë do të jetë domosdoshmëri për realizimin e transaksioneve në Bursë. Për cdo transaksion të realizuar në tregun e rregulluar ku obligacionet do të jenë të listuara, bankat/shoqëritë komisionere anëtare në bursë që realizojnë transaksionin ngarkohen me komisionet e transaksioneve në Bursë sipas tarifave në fuqi të Bursa Shqiptare e Titujve ALSE sh.a. të publikuara në faqen zyrtare të saj (https://alse.al/kreu/sherbimet/investitoret/komisionet-e-tregtimit/).
Pika 4.2	Pika 4.2 Arsyeja e hartimit të prospektit ✓ Shuma e grumbulluar nga emetimi i këtyre obligacioneve do të injektohet në masën 100% në aktivitetin primar të institucionit, pra në kredidhënie. Pavarësisht kushteve makroekonomike në momentin e publikimit të këtij Prospekti (normë inflacioni mbi vlerën e targetuar nga Banka e Shqipërisë), NOA ka konstatuar një rritje të kërkesës për produktet e financimit që ajo ofron. Kështu, vetëm gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, portofoli i kredisë u rrit me 11.24 % (ose me rreth 681 milionë Lekë) duke arritur pothuajse plotësisht objektivin e institucionit për rritjen vjetore të portofolit neto të kredisë, prej 12%. Portofoli neto dhe bruto i kredisë u rritën me 20% gjatë vitit 2022 dhe vlera totale e disbursimeve përgjatë vitit 2022 arriti rekordin prej rreth 5.5 miliardë Lekë. Drejtimi i shoqërisë, mbështetur në sinjalet pozitive të ardhura nga tregu, parashikon se ecuria e kredidhënies gjatë vitit 2023, do të jetë po aq pozitive sa përgjatë vitit të mbyllur 2022. Më poshtë, paraqesim parashikimin për zërat më të rëndësishëm të flukseve hyrëse e dalëse të parave që lidhen më aktivitetin operacional dhe atë financues, përgjatë periudhës Qershor-Gusht 2023, gjatë së cilës drejtimi i shoqërisë parashikon të angazhojë në aktivitet fondet e grumbulluara nga emetimi i këtij obligacioni.

[3] Marrja e shërbimit të brokerimit prej tyre.

Disa nga zërat e flukseve të parasë gjatë Qershor-Gusht 2023 në milionë Lekë

Disbursime të pritshme gjatë periudhës Qershor-Gusht 2023	**(1,467) milionë Lekë**
Flukse hyrëse të pritshme nga shlyerja e kredive gjatë periudhës Qershor-Gusht 2023	**1,340 milionë Lekë**
Flukse hyrëse nga financime të reja (ose disbursime të transheve të mbetura nga marreveshje ekzistuese financimi) gjatë periudhës Qershor-Gusht 2023	**316 milionë Lekë**
Fukse hyrëse nga emetimi i këtij Obligacioni	**500 milionë Lekë**
Flukse dalëse për shlyerje të kësteve të huave/financimeve të NOA gjatë periudhës Qershor-Gusht 2023	**(710) milionë Lekë**
Flukse dalëse per shpenzime operacionale gjatë periudhës	**(195) milionë Lekë**
Interes i arkëtueshëm gjatë periudhës nga portofoli i kredive	**406 milionë Lekë**
Interes i pagueshëm gjatë periudhës për huatë e NOAs	**(101) milionë Lekë**

Rritja e parashikuar e portofolit do të financohet në pjesën më të madhe prej flukseve monetare nga shlyerjet e kredive nga klientët dhe pjesërisht prej fondeve të grumbulluara nga emetimi i obligacioneve.

Disbursimet në 3 mujorin Qershor-Gusht 2023, pritet të alokohen në rradhën e segmenteve të klientelës në të njëtën mënyrë dhe duke ndjekur të njëjtin trend të shënuar gjatë vitit 2022. Kështu, segmenti "Biznese të vogla e të mesme"pritet të përthithë pjesën më të madhe të financimeve të reja në vlerën e pritshme prej rreth 874 milionë Lekë ose rreth 60% të disbursimeve të reja të periudhës. Segmentet "Agrobiznes" dhe "Individë" pritet të tërheqin respektivisht rreth 16% dhe 24% të disbursimeve të reja të periudhës në fjalë.

Shpërndarja e Disbursimeve përgjatë Qershor-Gusht 2023 sipas Segmenteve



Në bazë të parashikimeve të drejtimit, fondet pritet të alokohen në rradhën e klientëve , sipas projeksioneve të mëposhtme:

	Total për Qershor-Gusht 2023	Prej të cilave financuar nga fondet e grumbulluara nga obligacionmbajtësit
Kredi në numër për "Biznese të vogla e të mesme"	1,057	432
Kredi në numër për "Agrobiznese"	605	187
Kredi në numër për "Individë"	1,922	511
TOTAL	**3,584**	**1,130**

	(në milionë LEKË)	(në milionë LEKË)
Kredi (disbursime) në vlerë për "Biznese të vogla e të mesme"	874	315
Kredi (disbursime) në vlerë për "Agrobiznese"	231	107
Kredi (disbursime) në vlerë për "Individë"	362	78
TOTAL	**1,467**	**500**

	(në milionë LEKË)	(në milionë LEKË)
Portofol neto në vlerë për "Biznese të vogla e të mesme"	5,031	315
Portofol neto në vlerë për "Agrobiznese"	1,634	107
Portofol neto në vlerë për "Individë"	1,159	78
TOTAL	**7,824**	**500**

Nga pikëpamja financiare, financimi i aktivitetit të NOAs nëpërmjet obligacioneve pritet të ketë ndikim pozitiv në:

- rritjen e afatit mesatar të borxhit duke e shtrirë në kohë;
- nëpermjet rritjes së peshës së borxhit me interes fiks ul rrezikun e humbjeve të ardhshme si pasojë e ndonjë rritje të mundshme të interesave të tregut;

do t'i krijojë institucionit hapësirën për shfrytëzimin maksimal të fondeve/likuiditeteve të saj pasi shlyerja e këtij borxhi do të realizohet me një pagesë të vetme në datën e tij të maturimit. Duke patur parasysh maturitetin mesatar relativisht te shkurtër (rreth 24-26 muaj) të kredive të NOA-s (kredi për klientët), fondet e huazuara nga obligacionmbajtësit do të mund të "hidhen" disa herë në biznes e të "shfrytëzohen maksimalisht"me qëllim përfitimin financiar të institucionit. Me një normë mesatare interesi financimi të klientëve prej 19.43% në vit dhe normë mesatare efektive interesi prej 23.75 % në vit, operacioni i financimit të aktivitetit përmes emetimit të obligacioneve me kosto fikse prej 8.0% në vit do të jetë me përfitim për institucionin.

✓ Oferta e obligacioneve të NOA sh.a. është objekt i marrëveshjes së nënshkrimit nga Banka Credins sh.a. Nr.10157 Prot (Banka Credins) dhe Nr.46917 Prot (NOA), datë 24.04.2023. Objekti i marrëveshjes mikse të nënshkrimit të lidhur mes NOA sh.a dhe Banka Credins është:

- hedhja në treg e këtyre titujve me një angazhim maksimal në transaksion deri në një nivel të dakordësuar mes palëve ("Firm commitment underwriting"deri në limitin e përcaktuar në marrëveshje). Shuma e dakordësuar përfaqëson vlerën që Banka Credins angazhohet të blejë në portofolin e saj;

  dhe

	▪ hedhja në treg e këtyre titujve pa angazhim në transaksion ("best efforts underwriting") për një vlerë deri në 400.000.000,00 Lekë të ofertës (shuma për të cilën Banka Credins do të veprojë si "agjent prezantues dhe shitës"). Në këtë cilësi (atë të agjentit shitës) Banka Credins sh.a bën përpjekje për gjetjen e investitorëve për blerjen e titujve në emetim por nuk merr përgjegjësi për blerjen e titujve të pa-shitur, pra Credins nuk krijon portofol titujsh të nënshkruar. ✓ Duke qënë se ky obligacion i emetuar nga NOA sha ka statusin " i nënrenditur", NOA do të realizojë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së investitorit potencial me këtë instrument financiar nëpërmjet testit të përshtatshmërisë. Vlerësimi do të kryhet për të gjithë investitorët potencialë të cilëve NOA u prezanton Prospektin dhe cdo informacion tjetër të domosdoshëm për marrjen e vendimit për investim. Vlerësimi i përshtatshmërisë së investitorëve potencialë të cilët do të shërbehen nga ndërmjetësi financiar do të realizohet pikërisht nga ndërmjetësi Banka Credins sipas detyrimeve të tij ligjore dhe kontraktuale. ✓ Emetuesi, në dijeninë e tij më të mirë dhe nën përgjegjësinë e tij të plotë, deklaron se nuk ka konflikte interesi që lidhen më ofertën, nënshkrimin e saj apo pranimin për t'u tregtuar në një treg të rregulluar.

KREU II – INFORMACION RRETH EMETUESIT

RUBRIKA 1 – PERSONAT PËRGJEGJËS, INFORMACIONI NGA PALËT E TRETA, RAPORTET E EKSPERTËVE DHE MIRATIMI NGA AUTORITETI KOMPETENT

Pika 1.1	Pika 1.1 Personat përgjegjës për informacionin ose pjesë të tij, që paraqitet në këtë Prospekt. Personat përgjegjës për informacionin e paraqitur në këtë Prospekt listohen si më poshtë: - Zj.Herjola Spahiu –Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Nën Kryetar i Këshillit të Administrimit pranë NOA sh.a.. Zj.Spahiu është përgjegjëse për informacionin mbi emetuesin, përshkrimin e shoqërisë dhe aktivitetit që ajo ushtron, si dhe prirjet dhe strategjitë e institucionit. Zj.Spahiu është gjithashtu përgjegjëse për rishikimin e të gjithë informacionit të paraqitur në këtë Prospekt nga personat e tjerë të punësuar pranë NOA, të përmendur më poshte. - Zj.Ariola Çela- Drejtor i Departamentit të Financës pranë NOA sh.a.. Zj.Çela është personi përgjegjës për informacionin financiar mbi institucionin NOA duke përfshirë përshkrimin dhe analizën e situatës financiarë aktuale të institucionit, projeksionet financiare të së ardhmes etj si dhe për përshkrimin e tipareve të titujve. Pjesë të Prospektit të paraqitur nga Zj.Çela : KREI I- Rubrika 2, pika 2, Rubrika 3, Rubrika 4; Kreu II-Rubrika 7, Rubrika 11, Rubrika 13 dhe Rubrika 18. - Zj.Albana Pelinku- Drejtor i Departamentit të Riskut dhe Përputhshmërisë pranë NOA sh.a. Zj.Pelinku është përgjegjëse për informacionin mbi rreziqet e emetuesit dhe informacionin mbi cilësinë e portofolit të kredisë së NOA-s. Pjesë të Prospektit të paraqitura nga Zj.Pelinku janë: KREU I, Rubrika 2, pika 2 (informacioni mbi cilësinë e portofolit) dhe pika 3; Kreu II, Rubrika 3, Rubrika 9 dhe Rubrika 17. - Grant Thornton SH.P.K., me NIPT K91923007M, dhe adresë në rrugën "Sami Frasheri", Kompleksi T.I.D, Hyrja B. Kati I, Tiranë, Shqipëri, në cilësinë e audituesit të pavarur të Pasqyrave Financiare të viteve 2022, 2021 dhe 2020, është përgjegjës për Opinionin e dhënë mbi Pasqyrat Financiare të audituara prej tij, bashkëlidhur këtij Prospketi .

Pika 1.2

Pika 1.2 Një deklaratë nga personat përgjegjës për prospektin që, në dijeninë e tyre, informacioni që përfshihet në prospekt është në përputhje me faktet.

1. Deklarata e Zj.Herjola Spahiu - Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv i NOA sh.a.

DEKLARATË

Unë e nënshkruara, Herjola Spahiu, e bija e Veliut, lindur më 27.07.1978, identifikuar me dokumentin Letërnjoftim me Nr. 033989848 dhe Nr. Personal H85727135S, deklaroj me përgjegjësinë time të plotë se, në dijeninë time më të mirë, i gjithë informacioni dhe të dhënat që gjenden në këtë prospekt përbëjnë paraqitjen e plotë të aktiveve dhe pasiveve, fitimeve dhe humbjeve, situatës financiare dhe veprimtarive reale të emetuesit (”NOA”), të të drejtave që lidhen me titullin që do t’i ofrohet publikut dhe do të pranohet për t’u tregtuar në një treg të rregulluar dhe se i gjithë informacioni dhe data e paraqitur këtu janë të sakta e korrekte dhe se nuk është hequr asnjë informacion apo të dhëna që ndikojnë në saktësinë dhe tërësinë e informacionit.

Znj. Herjola Spahiu

Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv i NOA sh.a.

2. Deklarata e Zj.Ariola Çela- Drejtor i Departamentit të Financës, NOA sh.a.

DEKLARATË

Unë e nënshkruara, Ariola Çela, e bija e Astrit Çela, lindur më 05.06.1983, identifikuar me dokumentin Letërnjoftim me Nr. 035022406 dhe Nr. Personal I35605134I, deklaroj me përgjegjësinë time të plotë se, në dijeninë time më të mirë, informacioni që përfshihet në pjesët e Prospektit për të cilat unë jam përgjëgjëse, është i saktë, i plotë dhe në përputhje me faktet. Deklaroj gjithashtu se nuk është lënë pa përfshirë asnjë informacion, fakt apo e dhënë që do të cënonte plotësinë dhe vërtetësinë e këtij Prospekti.

Zj. Ariola Çela

Drejtor i Departamentit të Financës pranë NOA sh.a.

3. Deklarata e Zj.Albana Pelinku- Drejtor i Departamentit të Riskut dhe Përputhshmërisë, NOA sh.a

DEKLARATË

Unë e nënshkruara, Albana Pelinku, e bija e Gezim Pelinku, lindur më 30.12.1980, identifikuar me dokumentin Letërnjoftim me Nr.034882410dhe Nr. Personal I06230077F deklaroj me përgjegjësinë time të plotë se, se në dijeninë time më të mirë, informacioni që përfshihet në pjesët e Prospektit për të cilat unë jam përgjëgjëse, është i saktë, i plotë dhe në përputhje me faktet. Deklaroj gjithashtu se nuk është lënë pa përfshirë asnjë informacion, fakt apo e dhënë që do të cënonte plotësinë dhe vërtetësinë e këtij Prospekti.

Zj. Albana Pelinku

Drejtor i Departamentit të Riskut dhe Përputhshmërisë pranë NOA sh.a

Pika 1.3

Pika 1.3 Deklarata nga ekspertë të jashtëm

Deloitte Legal, pjesë e Deloitte Albania sh.p.k. është përfshirë si ekspert i jashtëm për rishikimin e përmbajtjes së prospektit në përputhje me legjislacionin ne fuqi.

Deloitte Albania shpk, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi te subjektit (NUIS) J62329003N, me seli në adresën "Rruga e Kavajës", Ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3, Tiranë, Shqipëri.

Deloitte Legal shpk, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi te subjektit (NUIS) L71723007F, me seli në adresën "Rruga e Kavajës", Ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3, Tiranë, Shqipëri.
Deloitte Albania dhe Deloitte Legal kane eksperiencë të konsiderueshme në këshillim ligjor dhe financiar e cila daton prej vitit 1996. Nëpërmjet inputit rishikues të tyre pritet të reflektohet një qasje bazuar në praktika të ngjashme evropiane.

Angazhimi i Deloitte Legal dhe Deloitte Albania është bërë me kërkesë të NOA-s për rishikimn e permbajtjes së Prospektit sipas legjislacionit në fuqi.

DEKLARATË

Unë e nënshkruara, Sabina Lalaj, identifikuar me dokumentin e identifikimit me nr. personal H85605095K, në cilësinë e administratorit deklaroj se Deloitte Legal është angazhuar si ekspert i jashtëm për rishikimin e përmbajtjes së prospektit në përputhje me legjislacionin ne fuqi. Angazhimi i Deloitte Legal është bëre me kërkesë të NOA. Në çdo rast, përgjegjësia për përmbajtjen dhe formën e këtij prospekti, mbetet e NOA.

Zj. Sabina Lalaj

_____

Administrator i Deloitte Legal

1. Deklarata nga Zj.Sabina Lalaj-Administrator i Deloitte Legal

2. Deklarata nga Zj.Albana Shahu-Administrator i Deloitte Albania

DEKLARATË

Unë e nënshkruara, Albana Shahu, identifikuar me dokumentin e identifikimit me nr. personal I36022089P, në cilësinë e administratorit deklaroj se Deloitte Albania është angazhuar si ekspert i jashtëm për rishikimin e përmbajtjes së prospektit në përputhje me legjislacionin ne fuqi. Angazhimi i Deloitte Albania është bëre me kërkesë të NOA. Në çdo rast, përgjegjësia për përmbajtjen dhe formën e këtij prospekti, mbetet e NOA.

Albana Shahu

_____

Administrator i Deloitte Albania

Pika 1.4	Pika 1.4 Informacioni i marrë nga palë të treta. Informacioni mbi tregun/sektorin bankar e financiar është marrë nga faqet zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë. Kështu, të dhënat mbi NPL ("non performing loans"- kredi me probleme +90 ditë), Portofol Kredie, Asete, Kthimit nga Asetet (ROA), Kthimi nga Kapitali (ROE) të tregut të institucioneve financiare Jo-Banka janë riprodhuar saktësisht sipas përmbajtjes së tij në brendësi të Raporteve Vjetore të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë. (https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Raportet_Vjetore_te_Mbikeqyrjes_Bankare/) Të dhënat mbi peshën realtive të NOA ndaj tregut dhe renditja e saj në këtë treg janë kalkuluar duke u mbështetur në të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë në Raportin Vjetor të Mbikëqyrjes 2021 si dhe informacionin mbi Portofolin e Kredisë së Institucioneve Financiare Jo-Banka sic paraqitur në Pasqyrat e tyre Financiare të audituara për vitin 2021 dhe të publikuara në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

RUBRIKA 2 - AUDITUESIT LIGJORË

Pika 2.1	Pika 2.1 Emrat dhe adresat e audituesve të Emetuesit për 3 vitet e fundit . Auditues i jashtem i emetuesit për vitin financiar 2019 ka qënë shoqëria: Ernst & Young -Ekspertë Kontabël të Autorizuar SH.P.K., me NIPT K61911012I, me adresë rruga "Ibrahim Rugova", Sky Tower, Kati I 6-te, Tiranë, Shqipëri. Regjistrimi i parë pranë Institutit të Eksperteve Kontabël të Autorizuar është realizuar më 20.12.2006, me numër 112. Auditues i jashtem i NOA sh.a. për vitet financiare 2022, 2021 dhe 2020 është shoqëria: Grant Thornton SH.P.K., me NIPT K91923007M, me adresë në rrugën "Sami Frasheri", Kompleksi T.I.D, Hyrja B. Kati I, Tiranë, Shqipëri. Regjistrimi i parë pranë Institutit të Eksperteve Kontabël të Autorizuar është realizuar më 30.07.2009, me numër 165.
Pika 2.2	2.2 Jepni hollësi, nëse janë të rëndësishme, nëse audituesit kanë dhënë dorëheqjen, janë shkarkuar ose nuk janë riemëruar gjatë periudhës që mbulon informacioni historik financiar. Audituesi Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar SH.P.K., është ndryshuar në vitin 2020, në pëfundim të kontratës 2 vjecare të auditimit (2018-2019). Ndryshimi i audituesit nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë dorëheqjeje apo shkarkimi të tij, por ka rrjedhur natyrshëm si pasojë e skadencës së kontratës së shërbimit të auditimit dhe në vijim vendimmarrjes së NOA-s për të pranuar ofertën më preferenciale të shërbimit të një shoqërie tjetër të rëndësishme auditimi.

RUBRIKA 3 - FAKTORËT E RREZIKUT

Pika 3.1	**Pika 3.1** Rreziqet specifike për emetuesin Emetuesi, institucioni financiar jo-bankë NOA sh.a., përballet me një sërë rreziqesh gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij; rreziqe që lidhen dhe/ose derivojnë nga ambjenti i jashtëm ekonomik ashtu edhe rreziqe të tjera që lidhen me faktorë të brendshëm të organizatës. Më poshtë listohen rreziqet kryesore për emetuesin:

1. Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare nëse një klient apo pala tjetër e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, i cila rrjedh kryesisht nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve, nga fondet pranë institucioneve të tjera financiare si dhe zërat e tjerë të paregjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar. Për qëllime të raportimit të administrimit të rrezikut, NOA mbledh dhe vlerëson të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si p.sh rreziku i dështimit të një huamarrësi të veçantë, dhe rreziku i sektorit), duke përfshirë pozicionin financiar të debitorit dhe aftësinë e tij paguese.

Administrimi i rrezikut të kredisë kryhet në mënyrë të vazhdueshme:

- duke monitoruar limitet e ndryshme te vendosura persa i përket shumës maksimale të kredisë, portofolit të kredisë dhe përqëndrimin e ekspozimit.
- formuluar politika dhe procedura të kredisë, të cilat përcaktojnë kërkesat për garancitë, klasifikimin dhe raportimin e rrezikut, procedurat dokumentuese dhe ligjore, dhe pajtueshmërinë me kërkesat statutore.
- monitorimin e cilesise se vendimarrjes nga strukturat e ndryshme autorizuese te kredive (komitetet e kredive ne nivele te ndryshme), monitorimin e kategorive të rrezikut, duke i kategorizuar ekspozimet në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare dhe rreziqet e pritshme.
- rishikimin dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë ndaj klientëve nga Departamenti i Rrezikut të Kredisë, në mënyrë të pavarur.
- trajnimin, këshillimin dhe dhënien e udhëzimeve të ndryshme ndaj njësive të biznesit për të zhvilluar praktikat më të mira të administrimit të rrezikut të kredisë ne te gjithe Institucionin

Çdo njësi biznesi zbaton politikat dhe procedurat e kredisë në përputhje me autoritetet aprovuese të deleguara. Përqëndrimi i rrezikut të kredisë i cili vjen nga instrumentet financiare ekziston për palët e tjera kur ato kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që do të bënin që aftësia e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të ndikohet në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në kushtet ekonomike ose kushte të tjera. Shumica e përqëndrimit të rrezikut të kredisë vjen nga lloji i klientit në lidhje me huatë dhënë klientëve nga Shoqëria.

Niveli i rrezikut : I Mesëm

2. Rreziku i ndikimit të forcave madhore (si pandemia Covid-19),

Eshtë mundësia e ndikimit në biznesin dhe/ose gjendjen financiare të emetuesit te një ngjarje natyrore ose shoqërore, si tërmet, ciklon, përmbytje, shpërthim vullkanik, zjarr, luftë, konflikt i armatosur, akt terrorist, epidemi, pandemi, e cila do të pengonte emetuesin të realizonte objektivat e biznesit apo edhe të përmbushte detyrimet e tij. Ngjarjet e konsideruara si forca madhore ndodhin në mënyrë të rastësishme, të paparashikuar e nuk mund të shmangen nga emetuesi pavarësisht përpjekjeve apo kujdesit të tij, duke qënë se ndikojnë në të gjithë ekonominë e vendit dhe prekin masivisht klientët dhe aftësine tyre paguese, gjë e cila do të shkaktonte ulje ë arkëtimeve të realizuara dhe ndryshim të fluksit hyrës të parasë. Në këtë mënyrë, aktiviteti i Institucionit mund të preket në aspektet e mëposhtme por pa kufizim

- mund të rrezikohet rritja e aktivitetit kredidhënës pasi më pak fonde do të jenë disponibël për kreditim. Pasiguria që shoqëron situatat e krijuara nga forcat madhore, nga ana tjetër, do të shtrëngonte edhe politikat krediduese të shoqërisë me pasoja të mundshme ndaljen e rritjes deri në tkurrjen e biznesit;
- mund të rrezikohet pagesa e detyrimeve ndaj të tretëve: mbajtësve të obligacioneve të emetuara, institucioneve ndërkombëtare dhe bankave lokale pranë të cilëve Institucioni është financuar me hua dhe ovërdrafte;

- mund të rrezikohet përmbushja e kushteve të caktuara nga financuesit e NOA-s, të cilat lidhen me realizimin e indikatorëve të caktuar të biznesit si cilësia e portofolit, numër i kredive të dhëna, etj) duke vënë në vështirësi mbarëvajtjen e marrëveshjeve të financimit. Mospërmbushja e kushteve të marrëveshjeve të financimit mund të sjella pasoja penalizuese për NOA-n, duke filluar nga refuzimi i financuesve për disbursimin e transheve të mbetura të linjave të huave deri tek detyrimi i NOA-s për shlyerjen e menjëhershme të financimit.

- Masat e NOA për mitigimin e këtij lloj rreziku (shembull: pandemia Covid-19).

Situata e pandemisë COVID-19 dha impakt negativ në ekonominë boterorë në përgjithësi dhe në ekonomitë e vendeve të varfra e atyre në zhvillim në mënyrë të vecantë. Masat e marra nga qeveria Shqiptare përgjatë vitit 2020, të tilla si kufizimi i orareve të qarkullimit e mbyllja e njësive të biznesit ndikoi në mënyrë drastike në të ardhurat e bizneseve dhe familjeve Shqiptare, për muaj me rradhë. NOA, u përshtat me kushtet e reja, duke i dhënë përparësi mbrojtjes së shëndetit të punonjësve të saj, duke kombinuarpunën në distancë dhe atë në zyrë dhe duke përqëndruar përpjekjet e ekipit të saj në këshillimin dhe mbështetjen e atyre klientëve që u prekën më së shumti nga kufizmet e periudhës.

- Si u menaxhua situata covid-19 gjatë 2020?

SI U MENAXHUA SITUATA COVID-19 GJATË 2020?

Në vijim të moratoriumit të Bankës së Shqipërisë për shtyrjen e kësteve të kredive, NOA miratoi, përgjatë muajve Mars-Shtator 2020, ristrukturimin e 38% kredive të individëve apo bizneseve të prekur më tepër nga situata e krijuar nga virusi si dhe masat e marra nga Qeveria për mbylljen e aktiviteteve tregtare.

Pavarësisht pasigurive, NOA nuk pushoi së ushtruari veprimtarinë e saj duke mbështetur me financime klientët e saj besnikë. Ndonëse, më pak flukse hyrëse parash si pasojë e shtyrjes së afatit të pagesave të kësteve të kredive, gjendja e likuditeteve të lira të NOA-s garantoi një aktivitet normal dhe asnjë pengesë/vonesë për disbursimet e kredive të reja.

Gjatë vitit 2020 :

- *u disbursuan 11 350 kredi,*
- *portofoli neto i kredive u rrit me 8% ,*
- *totali i aseteve u rrit me 4,3%*
- *fitimi i shoqërisë arriti vlerën prej rreth 278 milionë Lekë (1,8% mi lartë se ai vitit 2019).*

Ndonëse, NOA e menaxhoi shumë mirë veprimtarinë e saj në kushtet ekstreme që krijoi pandemia dhe viti 2020 u mbyll me rezultate shumë të mira për institucionin (fitimi neto i vitit ishte më i lartë s ai i vitit të mëparshëm 2019) , duhet të nënvizojmë se situata të tilla të papritura e që sjellin një nivel të lartë pasigurie financiare për popullsinë, mbartin një rrezik të madh për ecurinë e aktivitetit të kreditimit në tërësi.

Niveli i rrezikut: I Mesëm

3. Rreziku i varësisë nga financuesit e huaj.

NOA e ka mbështetur financimin e biznesit të saj në një masë të madhe me huatë e marra nga institucionet financiare ndërkombëtare. Shumë prej institucioneve mikrofinanciare në Shqipëri kanë të njëjtin model të financimit të biznesit të tyre kryesisht nga partnerë të huaj.
Nga totali i gjendjes se borxhit sikurse më 31 Dhjetor 2022, 81% e tyre janë kundrejt financuesve të huaj (financime te pagarantuara) dhe vetëm 19% janë financime nga bankat lokale.

Rreziku i varësisë nga financuesit e huaj lidhet me impaktin negativ të ndonjë krize financiare globale në aftësinë e këtyre institucioneve të huaja për të:

- lëvruar transhet e mbetura të financimeve të nënshkruara më herët;
- për të lidhur marrëveshje të reja financimi apo rinovuar marrëveshjet me skandencë të afërt.

Ekipi drejtues i NOA-s ka marrë masat e mëposhtme për menaxhimin, në drejtimin të minimizimit, të këtij rreziku:

- diversifikimi i bashkëpunëtorëve/partnerëve të huaj financues për të evituar përqëndrimin e marrëdhënieve të financimit me një ose dy financues të huaj. Si më 31 Dhjetor 2022, NOA ka 49 kontrata huaje me 9 financues të ndryshëm të huaj;
- ka aplikuar kredimarrjen nga bankat lokale me kolateral portofolin e kredisë.
- mban një nivel të kënaqshëm aktivesh likuide (cash e depozita afatshkurtra) për të garantuar aktivitetin normal në rast eventual problematikash me financuesit e huaj;
- planifikon të emetojë ne mënyre te vazhdueshme obligacione afatgjata në monedhën Lekë me qëllim diversifikimin e burimeve të saj të financimit, uljen e varësisë nga financuesit e huaj, rritijen e afatit mesatar të financimit dhe uljen e rrezikut të kursit të këmbimit.

Duhet theksuar gjithashtu se nga pikëpamja e menaxhimit financiar të Institucionit, NOA ka shfrytëzuar një nivel relativisht të kënaqshëm të levës financiare i cili përfaqësohet nga një raport Detyrime ndaj Kapitalit prej 2.8 herë (që do të thotë detyrimet janë 2.8 herë më të mëdha se kapitali i shoqërisë, si më 31 Dhjetor 2022). Mesatarja e raportit Detyrime-Kapital për Institucionet Mikrofinanciare në Evropë është 4,2% (2019). NOA, ka ende kapacitet të rrisë në të ardhmen këtë raport , pra të shtojë detyrimet në formën e huamarrjeve afatgjata në raport me kapitalin e shoqërisë, pa rritur profilin e riskut të institucionit dhe duke synuar përmirësim të mëtejshëm të përfitueshmërisë së institucionit.

Niveli i rrezikut: I Mesëm

4. Rreziku i likuiditetit

Ky është rreziku i mungesës së likuiditeteve për shlyerje në afat të detyrimeve që emetuesi ka kundrejt te tretëve, përfshirë obligacionmbajtësit. Mungesë likuiditeti do të konsiderohet çdo situatë në të cilën emetuesi:

- nuk disponon aktive likuide të mjaftueshme ose ka vështirësi për t'i realizuar ato në treg, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kur ato maturohen dhe kërkohen nga kreditorët, ose
- nuk ka mundësi të financojë rritjen e aktiveve të veta (pra nuk ka mundësi të rrisë portofolin e kredive).

Burimet prej nga krijohen likuiditetet janë flukset hyrëse si pasojë e shlyerjes së kredive të klientëve dhe injektimi i parasë së re nga financuesit. Performanca e kredive (shlyerjet e tyre), sikurse kemi theksuar gjërësisht më lart, ndikohet si nga faktorë të jashtëm të tillë i stadi i ekonomisë, ngjarje/forca madhore (si pandemia, katastrofa natyrore ose sociale etj) etj ashtu edhe nga faktorë të brendshëm si cilësia e vendimmarrjes për kreditim dhe aftësia e ekipit të monitorimit dhe mbledhjes së kredive.
Nga ana tjetër, edhe aftësia e aksesimit të financimeve të partnerëve, me kushte të favorshme financiare, është subjekt i faktorëve të ndryshëm, duke filluar nga faktorë jashtë kontrollit të saj e deri

tek faktorët e brendshëm si mënyra e menaxhimit të marrëdhënieve me partnerët dhe aftësia për të përmbushur kushtet e vendosura prej tyre për financim.

Shoqëria ka ngritur sistemin e administrimit të rrezikut të likuiditetit i cili mbështetet në politikat dhe procedurat për administrimin e rrezikut të likuiditetit, njësinë e posacmë që përgjigjet për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve të institucionit si dhe sistemin/funksionin e kontrollit të brendshëm.

NOA, në bazë të modelit solid të parashikimit të cashit që ka krijuar, është në gjendje të parashikojë me përafërsi, por në mënyrë të kënaqshme, flukset monetare nga aktivitetet operacionele, investuese e financuese dhe në bazë të këtij parashikimi të realizojë planifikimet për ecurinë kreditimeve, investimeve të fondeve përkohësisht të lira dhe nevojave për financime shtesë në periudha të caktuara si dhe të vendosë mbi maturitetin e aseteve dhe detyrimeve me qëllim arritjen e një niveli optimal përputhshmërie mes tyre.

Rrezikut të likuiditetit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe Banka e Shqipërise. Kështu, në përmbushje të detyrimeve ligjore, respektohen në çdo kohë treguesit e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit, siç përcaktohet në raportet e mëposhtme:

- raporti i aktiveve me maturitet të mbetur deri në një muaj ndaj detyrimeve me maturitet të mbetur njëmujor, nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);
- raporti i aktiveve me maturitet të mbetur deri në tre muaj ndaj detyrimeve me maturitet të mbetur tremujor, nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind).

Në përputhje me parashikimet e drejtuesve të shoqërisë, shlyerja e detyrimeve ndaj obligacionmbajtësve do të realizohet pa vonesa pasi shoqëria do të vijojë të ruajë një niveli të kënaqshëm asetesh likuide.

Niveli i rrezikut: I Mesëm

5. Grupi i Rreziqeve të Tregut

5.1. Rreziku i ndryshimit të normave të interesit

Ndryshimi i normave të interesit në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar ndikon në mnëyrë të drejtëpërdrejtë në koston e financimit të biznesit. Kështu, një rritje e normave të interesit në treg mund të shkaktojë rritje të kostos së financimit të aktivitetit dhe si pasojë mund të ulë përfitueshmërinë financiare (ul marzhin e fitimit nga huadhënia) dhe/ose të ushtrojë presion në drejtim të rritjes së normave të interesit të kredive për klientët duke rrezikuar atraktivitetin dhe konkurrueshmërinë e produkteve të Institucionit.

Drejtimi i shoqërisë ka marrë masat e mëposhtme për menaxhimin sa më efektiv të këtij rreziku:

- Marrëveshjet e financimit nga partnerët e huaj janë negociuar me norma interesi preferenciale dhe fikse përgjatë gjithë jetëgjatësisë së huave;
- Gjatë operacioneve të vendosjes së depozitave në Euro dhe huamarrjes në Lekë nga bankat lokale, është negociuar marzh mes interesave të huamarrjes dhe investimit në depozitë dhe nuk janë trajtuar produktet si të ndara nga njëra-tjetra, duke siguruar mbrojtjen nga rreziku i rritjes së normës së financimit (rritje vetëm në njërin kah);
- Financimet në Lekë nga bankat lokale, janë marrë përgjithësisht të formës "ovërdraft". Nisur nga dinamika e lartë e flukseve hyrëse (shlyerjet e kredive të klientëve) dhe dalëse (disbursime kredish dhe shlyerje deyrimesh) si dhe nga sezonaliteti i flukseve të lidhura me financimet e disa agrokulturave, vlerësohet si zgjedhja më e mirë për limitimin e cashit në llogari duke paguar interesa vetëm për nivelin e përdorimit të tyre.

Niveli i rrezikut: I Mesëm

5.2. Rreziku i luhatjes së padëshirueshme të kursit të këmbimit

Ndërkohë që shumica e marrëveshjeve të financimit të NOA-s nga palë të treta janë në monedhën Euro (75% per vitin 2022), të ardhurat e saj nga aktiviteti (interesat nga portofoli i kredisë) janë kryesisht në monedhën Lekë pasi portofoli i kredisë së NOA-s është në masën 86% i denominuar në monedhën vendase si më 31 Dhjetor 2022.

Mospërputhja e valutës së detyrimeve të NOA-s (Euro) me valutën e të ardhurave të saj, e ekspozon institucionin ndaj rrezikut të zhvlerësimit të monedhës Lekë (monedhës së të ardhurave). Në rast zhvlerësimi të Lekut ose humbje të fuqisë blerëse të tij, do të nevojiteshin gjithnjë e më shumë "Lekë" për shlyerjen e detyrimeve kontraktuale në Euro të NOAs.

Drejtimi i shoqërisë është kujdesur për të menaxhuar në mënyrë të kënaqshme riskun e luhatjes së kursit të këmbimit përmes mekanizmit/skemës mbrojtëse të mëposhtme:

- Fondet e huazuara në monedhën Euro vendosen depozita me afat ose investohen në formën e aseteve të tjera financiare (blerje e titujve të denominuar në euro) dhe në vijim vendosen kolateral për financime në monedhën Lekë nga banka lokale.

Deri më sot, kjo mënyrë mbrojtjeje ka qënë mëse efektive për institucionin megjithatë më poshtë parashtrojmë edhe disa disavantazhe të mundshme të skemës në fjalë:

- Shpenzimet për interesat e financimeve nuk janë të përfshira në këtë skemë, çka do të thotë se shoqëria e ka marrë përsipër rrezikun e zhvlerësimit të Lekut për pjesën e interesave të huave. Zhvlerësimi eventual i Lekut do të sillte një rritje indirekte të kostove të financimit të institucionit.
- Në rast rivlerësimi të madh të monedhës Lekë, do të kishim një rënie të vlerës së kolateralit të financimit nga bankat lokale, pra të depozitave më euro të vendosura kolateral për kreditë në Lekë të marra nga bankat lokale. Në këtë rast bankat lokale mund të kërkonin rritje të vlerës së kolateralit. Gjithsesi, në kushtet që kolaterali është 106% deri 110% e vlerës së financimeve, ky risk vlerësohet jo i rëndësishëm për institucionin.

Niveli i rrezikut: I Ulët

6. Rreziku Operacional

Rreziku operacional konsiderohet mundësia e humbjes që vjen si pasojë e dështimit apo e papërshtatshmërisë së proceseve të brendshme, njerëzve dhe sistemeve apo nga ngjarje të jashtme. NOA ka marrë masat e nevojshme për të zbutur, kufizuar dhe/ ose shmangur ekspozimin ndaj ngjarjeve me risk operacional, duke rritur kontrollet e brendshme dhe ato të jashtme si dhe duke implementuar politika e procedura robuste për matjen dhe menaxhimin e risqeve operacionale.

Biznesi i NOA-s mbështetet në aftësinë e shoqerisë për të proçesuar një numër të madh transaksionesh në mënyrë efiçente dhe korrekte. Sistemet e inteligjencës së shoqërisë mund të performojnë kontrolle financiare dhe operacionale, të monitorojnë dhe menaxhojnë mbledhjen e kredive dhe të ndihmojnë në zhvillimin dhe shitjen e produkteve dhe shërbimeve. Gjithsesi, e ardhmja e aktivitetit varet nga suksesi i planifikimit të vazhdimesisë se biznesit, funksionimi efiçent dhe i panderprere i sistemeve te informacionit dhe te komunikimit, perfshirë teknologjine e informacionit dhe zhvillimin e implementimin e sistemeve te reja. Sistemet teknologjike te informacionit mund te shkaktojne deme si pasoje e proçeseve te pamjaftueshme ose te deshtuara te kontrollit dhe mbrojtjes; gabimeve njerezore; mashtrimit; apo ngjarje te jashtme qe shkaktojne nderprerjen e biznesit. Keto raste perveç humbjes se te dhenave, rezultojne ne rënien e cilesise se sherbimit ndaj klienteve.

Shoqëria NOA, jo vetem ka investuar dhe ngritur sisteme informatike solide qe mbeshtesin aktivitetin e saj, por gjithashtu ka hartuar procedura dhe praktika digjtale duke zhvilluar shume procese te automatizuara per minimizimin e gabimeve njerezore si dhe ka qenderzuar veprimet operacionale ne menyre qe te minimizoje risqet operacionale duke sherbyer me eficience dhe ne kohe reale klienteve te saj. Gjithashtu, janë marrë masat e nevojshme ne lidhje me ruajten dhe

zbatimin e standarteve per sigurine e informacionit duke u certifikuar gjithashtu me standartin ISO270001 nga TUV Austria.
Perveç sa më sipër në kontrollin e menaxhimit të rreziqeve të emetuesit janë të përfshirë Auditorët e jashtëm të cilët evidentojnë rastet e aktiviteteve apo proceseve me risqe operacionale.

Niveli i rrezikut: I Mesëm

7. Rreziku i incidenteve kibernetike

Rreziku i incidenteve kibernetike përfaqëson humbjen e mundshme të natyrës financiare, ndërprerje biznesi apo dëmtim/shkatërrim të reputacionit të shoqërisë si pasojë e sigurisë së ulët të sistemeve të teknologjisë së informacionit në përdorim nga Emetuesi. Departamenti i Teknologjisë së Infomacionit vlerëson nivelin e rrezikut të incidenteve kibernetike në bazë të sistemeve në përdorim si dhe në bazë të të dhënave që administron.

Institucioni i ka kushtuar vëmendje të veçantë teknologjisë së informacionit, jo vetëm në aspektin e zhvillimit,përmirësimit, sofistikimit të saj por edhe në aspektin e rritjes së sigurisë së teknologjive në përdorim prej stafit të saj.

Duke qënë se Institucioni administron të dhëna sensitive të klientëve, publikimi i mundshëm i tyre ose kërcënimi për publikimin e tyre do të shkaktonte një dëm financiar dhe reputacional për institucionin. Njësoj i dëmtuar do të ishte emetuesi nëse si pasojë e një sulmi ndërpritet aktiviteti i tij si pasojë e bllokimit të aksesit në sistemet e tij.

Në kuadër të rritjes së numrit të incidenteve kibernetike përgjatë viteve të fundit, NOA ka marre masat e nevojshme ne lidhje me ruajten dhe zbatimin e standarteve për sigurinë e informacionit duke u certifikuar gjithashtu me standartin ISO270001 nga TUV Austria.
Se fundmi ka kryer dhe investimet ne sistemet SIEM Implementation, xDR dhe Network upgrade, si me poshte:.

- SIEM Implementation, një sistem qe mbledh dhe monitoron në kohë reale të dhëna lidhur me aktivitetin qe kryhet në sistemet informatike duke mundësuar monitorim dhe marrjen e masave në kohë për çdo aktivitet të dyshimtë.
- xDR implementation, një sistem që analizon në mënyrë inteligjente çdo aktivitet dhe sjellje në sistemet informatike duke reaguar në mënyrë të shpejtë dhe automatike për dedektim dhe bllokim të çdo aktiviteti të dyshimtë.
- "Network Upgrade", Upgrade i sistemit të firewall-eve nga firewalle tradicionale në ato të generates tjetër (Next Generation Firewalls). Ky përmirësim rrit ndjeshëm mbrojtjen ndaj sulemeve kibernetike duke analizuar me detaje çdo aktivitet të dyshimtë në sistemet informatike si dhe duke marrë masa në kohë reale për aktivitete "malinj" që mund të hasen në rast sulmi të mundëshëm kibernetik.

Niveli i rrezikut: I Mesëm

8. Evente/ngjarje kritike të natyrës politike / gjeopolitike si dhe recensioni i ekonomisë në përgjithësi

Ngjarje/situata të tilla mund të ndikojnë në uljen e kërkesës për kredi dhe/ose në përkeqësimin e cilësisë së portofolit të kredisë së NOA, dhe si pasojë në performancën financiare të shoqërisë. Situata aktuale makroekonomike, me një normë inflacioni përtej targetit të Bankës së Shqipërisë dhe kundërpërgjigjia e rregullatorit duke rritur normën bazë të interesit, ka shtuar pasiguritë e operatorëve ekonomikë në vend.
Megjithatë, sipas deklaratës së Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë më 03.08.2022, pavarësisht sfidave ekonomike që ka sjellë viti 2022, ekonomia Shqiptare ka patur një ecuri relativisht solide gjatë gjysmës së parë të vitit 2022 dhe kërkesa për kredi vijon të qëndrojë e lartë. Cilësia e portofolit të

kredisë vijon të mbetet e shëndetshme dhe treguesi i kredive me probleme në nivelet më të ulëta të dekadës së fundit. Sinjalet inkurajuese që vijnë nga tregu i punës (rritje e punësimit, rënie e papunësisë, rritje e pagave në sektorin privat etj) krijojnë pritshmëri pozitive se rritja ekonomike do të vijojë edhe në periudhën e mbetur të vitit.

Sikurse lexohet edhe nga rezultatet e aktivitetit të NOAs përgjatë vitit 2022 dhe tremujorit të parë vitit 2023, në sportelet e NOAs nuk është ndjerë ndonjë tendencë rënie/tërheqje në kërkesën e konsumatorit për kredi; përkundrazi volumet e disbursuara dhe numri i kredive të disbursuara gjatë periudhës në fjalë janë ndër shifrat më të mira të arritura nga institucioni. Portofoli i kredisë është rritur me 20% gjatë vitit 2022 dhe me 7.4% përgjatë tremujorit të parë të vitit 2023

Niveli i rrezikut: I Mesëm

9. Rreziku Ligjor dhe Rregullator

Rreziku ligjor përfaqëson mundësinë që emetuesi të pësojë humbje financiare si rezultat i moszbatimit ose zbatimit në mënyrën jo të duhur të detyrimeve ligjore dhe/ose kontraktuale, duke përfshirë dhe procedura të tjera ligjore të cilat mund të ndikojnë negativisht në rezultatin financiar. NOA ka personel të kualifikuar për të vlerësuar në cdo kohë përputhshmërinë e veprimtarisë dhe praktikave të shoqërisë me të gjitha kërkesat ligjore në fuqi si dhe me praktikat më të mira të tregut.

Aktiviteti ushtrohet në përputhje me legjislacionin e posacëm për Bankat e Institucionet Financiare Jo-Banka në fuqi dhe mbikëqyret nga rregullatorët, si Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Është me vlerë të theksohen disa prej kërkesave rregullatore më të rëndësishme (që lidhen me nivele të treguesve financiare, kryesisht "mjaftueshmërisë së kapitalit") që monitorohen rreptësisht nga institucioni si dhe Banka e Shqipërisë :

- Raporti kapital mbi totalin e aktiveve duhet të jetë jo më poshtë se 10%;
- Raporti kapital mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara nuk duhet të jetë më pak se 100%;
- Raporti i kapitalit me totalin e kredive me probleme (neto), nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind)
- Raporti i kapitalit të paguar në natyrë ndaj totalit kapitalit të nënshkruar të mos tejkalojë 50%;
- Ekspozimi ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, nuk mund të tejkalojë 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të kapitalit të NOA;
- NOA nuk mund të marrë përsipër ekspozime të mëdha, të cilat të marra së bashku tejkalojnë 600% të kapitalit të subjektit;
- Raporti i aktiveve të qëndrueshme (neto) mbi totalin e aktiveve, nuk duhet të jetë më shumë se 10% (dhjetë për qind);
- Raporti i aktiveve që sjellin të ardhura me detyrimet që shkaktojnë shpenzime, nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);
- Raporti i kredisë me totalin e aktiveve të subjektit, nuk duhet të jetë më shumë se 95% (nëntëdhjetë e pesë për qind);
- Çdo investim në tituj, me përjashtim të investimeve në titujt e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe titujve të emetuar nga qeveritë dhe/ose bankat qendrore të vendeve të OECD, nuk duhet të tejkalojë 5% (pesë për qind) të kapitalit të subjektit;
- Totali i investimeve në tituj, me përjashtim të investimeve në titujt e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe titujve të emetuar nga qeveritë dhe/ose bankat qendrore të vendeve të OECD, nuk duhet të tejkalojë 40% (dyzetë për qind) të kapitalit të subjektit.
- Të tjera.

Sa më sipër kanë rëndësi të vecantë për shëndetin financiar të shoqërisë dhe mospërmbushja e tyre mund të sjellë pasoja negative financiare për shoqërinë deri tek revokimi i liçencës së saj.

	Një tjetër rrezik brenda kësaj kategorie është edhe paqartësia dhe pasiguria që shoqërojnë ndryshimet të kuadrit ligjor e rregullator të cilat shkaktojnë efekt të dukshëm në eficencën e aktivitetit deri sa ato të adoptohen plotësisht nga personeli. Stafi drejtues i shoqërisë qëndron i përditësuar me cdo ndryshim ligjor e rregullator dhe në rast paqartësish mbi detyrimet ligjore të shoqërisë, ndiqet praktika e konsultimit me ekspertë ligjorë të jashtëm dhe/ose me rregullatorët me qëllim garantimin ne cdo kohë të përmbushjes së detyrimeve ligjore. Si më datën e publikimit të këtij Prospekti, emetuesi vlerëson se nuk ka ndonjë ngjarje,faktor apo praktikë të tij në kundërshtim me ndonjë ligj apo akt nënligjor që mund të shkaktojë humbje. *Ndryshime ligjore që mund të prekin në mënyrë direkte aktivitetin e shoq*ërisë - Ndryshimi i legjislacionit ekzistues, rregulloreve, udhëzimeve, politikave Qeveritare dhe interpretimeve të tyre, mund të impaktojnë mënyrën si operon emetuesi në treg. - Cdo ndryshim në rregullore apo ligje i cili kufizon apo ndikon në mënyrën se si zhvillohet kredidhënia, qoftë përmes ndryshimit të trajtimit fiskal të aktivitetit, vendosjes së tavaneve të cmimeve apo kërkesave të shtuara rregullatore ose që ndikon shoqërinë në mbledhjen e detyrimeve të klientëve të saj në vonesë, do të kishte impakt negativ në biznesin e saj, situatën financiare dhe rezultatet e operacioneve të saj. Ky rrezik është i paparashikueshëm dhe ndaj tij ekspozohen të gjitha institucionet kredidhënëse në Republikën e Shqipërisë. Niveli i rrezikut: I Ulët 10. Rreziku reputacional Rreziku reputacional eshte rreziku aktual ose i ardhshem, i cili shkakton humbje per shkak te perceptimit te pafavorshëm të imazhit të një nstitucioni financiar nga konsumatorët, bashkëpunëtorët, aksioneret, investitorët dhe autoritetet mbikqyrëse. Rreziku reputacional, si një nga rreziqet që mund të dëmtojë institucionet financiare në mënyrë të menjëhershme dhe te drejtperdrejte, ka si element kryesor vlerësimin e dyshimeve te mundshme për përfshirje apo përdorim të institucioneve financiare për qëllime të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit; mungesën e transparencës në marrëdhëniet me klientët; mosrespektimin e kushteve të punës; mosrespektimin e termave të kontratave, praktikave jo të mira të mbrojtjes së konsumatorit, etj. Niveli i rrezikut : I Ulët

RUBRIKA 4 --INFORMACION RRETH EMETUESIT

Pika 4.1	Pika 4.1 Emri juridik dhe tregtar i emetuesit. NOA Emri tregtar i Emetuesit përkon me emrin juridik të tij: "NOA"
Pika 4.2	Pika 4.2 Vendi i regjistrimit të emetuesit, numri i tij i regjistrimit dhe numri i identifikimit si subjekt juridik (NIPT). NOA , shoqëri aksionare e organizuar dhe që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, është e regjistruar pranë Regjistrit Tregtar në Qëndrën Kombëtare të

	Regjistrimit në përputhje me **vendimin Nr. 25341, datë 2 Mars 2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, me NIPT **K11604002V.** Sqarojmë se: • Institucioni, është themeluar në vitin 1998 në kuadër të një projekti të financuar nga USAID, nën emrin "Partneri Shqiptar në Mikrokredi"dhe fillimisht ka qënë i formës "shoqëri kursim krediti". • Në vitin 2001, me vendimin Nr.25341, datë 02.03.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është miratuar shndërrimi i shoqërisë "Partneri Shqiptar në Mikrokredi" nga shoqëri kursim krediti në shoqëri aksionare (sh.a). • Në vitin 2007, shoqëria u licencua nga Banka e Shqipërisë për të vepruar si Institucion Financiar Jo-Bankë, në përputhje me Licencën e Aktivitetit nr. 09, datë 06.06.2007 (nr. 09/1, datë 1.3.2022). • Në vitin 2008, emri i Institucionit u ndryshua nga "Partneri Shqiptar në Mikrokredi"në "Opportunity Albania". • Në vitin 2011, me vendimin Nr.28.03.2011 të asamblesë së aksionarëve, ndryshohet emri i shoqërisë në "**NOA**".
Pika 4.3	**Pika 4.3 Data e themelimit dhe kohëzgjatja e emetuesit**. Data e themelimit : 26.02.2001 Data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar (QKB): 04.04.2001 Kohëzgjatja e shoqërisë: 26.02.2001-25.02.2051 (kohëzgjatje 50 vjecare)
Pika 4.4	**Pika 4.4 Selia qendrore dhe personaliteti juridik, legjislacioni në bazë të të cilit vepron emetuesi, vendi i themelimit, adresa, numri i telefonit të adresës së regjistruar dhe faqja e internetit të emetuesit, me një paralajmërim se informacioni në faqen në internet nuk është pjesë e prospektit.** Selia Qëndrore ndodhet në adresën: Rr. "Tish Daia", Komuna e Parisit, Kompleksi Haxhiu (Kika 2), P. 2, K. 1, Tiranë, Shqipëri. Personaliteti juridik: shoqëria është e formës shoqëri anonime (sh.a.) me afat të caktuar 50 vjeçar dhe vepron si Institucion Financiar Jo-Bankë, në përputhje me Licencën e Aktivitetit nr. 09, datë 06.06.2007 lëshuar nga Banka e Shqipërisë si dhe Licencën nr.701, datë 27.06.2016, për veprimtarinë e Agjentit në sigurime lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Licencat nuk janë të kufizuara në kohë dhe nuk janë të transferueshme ose tjetërsueshme. Legjislacioni në bazë të të cilit vepron NOA sha : NOA sha ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Akti nënligjor që rregullon në mënyrë të posacme licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve financiare jo-banka është Rregullorja e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me Vendim Nr. 01, datë 17.01.2013, "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", e ndryshuar . Vendi i themelimit : Shqipëri Adresat e shoqërisë (përvec selisë qëndore paraqitur më sipër) / vende të ushtrimit të aktivitetit janë: 1. Dega Tiranë, Rruga Ferit Xhajko nr 128 Tiranë, Albania. TEL +355 68 40 01 335

2. Dega Ali Demi, Rruga “Ali Demi”, nr. 150 Tiranë, Albania.Tel +355 68 40 29 762
3. Agjencia Rruga e Durresit, Rruga e Durrësit, përballë sheshit “Adem Jashari”, Tirana, Albania, +355 69 40 29 576.
4. Dega Don Bosko, Rruga ”Don Bosko”, Pallati Aurora Konstruksion, Njësia Nr.3 Tiranë, Albania,+355 68 40 29 574
5. Agjencia Komuna e Parisit, Rruga “Dervish Bej Mitrovica”, Komuna e Parisit Tiranë, Albania,+355 69 40 29 576.
6. Dega Unaza e Re, Rruga “Teodor Keko”, Unaza e Re, Kompleksi “ALES”, kati II Tiranë, Albania,+355 69 70 97 357.
7. Dega Kombinat, Rruga Llazi Miho, Pallati Nr. 99, Hyrja 6, Kombinat, Tiranë Tiranë, Albania, +355 68 90 38 865.
8. Dega Kamëz, Bulevardi Blu, pranë shkollës “Ibrahim Rugova” Kamëz, Albania, +355 68 40 29 819.
9. Dega Durrës, Rruga Aleksandër Goga, L.6, pranë shkollës Nënë Tereza Durrës, Albania, +355 69 40 75 288.
10. Dega Elbasan, Rruga “Bedri Xhomo”, Elbasan, Shqipëri Elbasan, Albania, +355 68 40 29 754.
11. Dega Lushnje,Lagja Xhevdet Nepravishta, Rruga “Marin Barleti”, prane Shëtitores “Kongresi i Lushnjes” Lushnje, Albania,+355 68 90 32 376.
12. Dega Lezhë, Lagjia ” Beslidhja”, Shëtitorja, ” Gjergj Fishta Lezhë, Albania. +355 67 48 33 334
13. Dega Berat,Lagja “10 Korriku”, Rr. “Antipatrea”, Berat, Shqipëri Berat, Albania,+355 68 90 32 376.
14. Dega Fier,Rr. Jani Bakalli, Fier” Fier, Albania,+355 68 90 38 861.
15. Agjencia Fier,Pedonale Fier, +355 68 90 38 861.
16. Dega Shkodër,Lagjja "Vasil Shanto", Rruga "Studenti", Godina Nr.2, Shkodër, Albania,+355 68 90 32 375.
17. Dega Pogradec, Lagja Nr 5, Rruga e Unazës,Godina Nr.4, Pogradec, Shqipëri Pogradec, Albania,+355 69 21 21 203.
18. Dega Kukës, Rruga “Dituria”, përballë gjimnazit “Havzi Nela”, Kukës Kukës, Albania,+355 68 40 29 516.
19. Dega Vlorë, Rruga Sulejman Delvina, Përballë Lulishte “Avni Rustemi”, Vlorë Vlorë, Albania, +355 68 40 29 546.
20. Dega Korcë,Rruga Konferenca e Pezës, pranë parkut “Vangjush Mio”, Korcë, Shqipëri Korcë, Albania,+355 68 40 29 696.
21. Agjencia Bilisht,Shëtitorja “Fuat Babani”, Bilisht Bilisht, Albania,+355 68 90 31 030.
22. Dega Gjirokastër,Bulevardi “18 shtatori”, përballë rrugës “Doktor Vasil Jorgji”, Gjirokastër Gjirokastër, Albania,+355 68 20 17 900.
23. Dega Sarandë,Lagja 3, Rr. Adem Sheme, Sarandë Sarandë, Albania,+355 68 40 29 580
24. Agjencia Peshkopi,Lagjja "Gjok Doci", Bulevardi "Elez Isufi, Peshkopi, Albania.+355 68 40 22 783

	25. Agjencia Durrës 2,Kompleksi "Port Vieë Durrës", Lagja 17, Rruga e tregut industrial.+355 68 40 01 306. 26. Dega Ali Demi 2,Bulevardi Bajram Curri, afër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Tiranë,+355 68 40 29 649. Numër telefoni i selisë qëndrore: +355 (0) 4 451 1011 Faqja e internetit: https://noafin.al/ KUJDES! : Informacioni i shpalosur në faqen e internetit të institucionit NOA nuk është pjesë e këtij Prospekti! Investitorët potencialë duhet ti referohen së pari informacionit në këtë Prospekt për të marrë vendimin për investimin në obligacionet e NOA dhe në formë plotësuese mund t'i referohen edhe informacionit të paraqitur në ëeb-in e shoqërisë. Ky prospekt , përmban informacion të detajuar mbi situatën financiare të shoqërisë, rreziqet me të cilat përballet biznesi si dhe tiparet e obligacioneve- të cilat nuk janë të shpalosura me detaje në faqen e internetit. Gjithsesi, ky Prospekt do të jetë i publikuar si dokument më vete, ne seksionin/rubrikën Raporte Vjetore.

Pika 1	RUBRIKA 5 -- PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I AKTIVITETIT Pika 1. Veprimtaritë kryesore ➢ *Veprimtaria kryesore e NOA është **kredidhënia**.* Në bazë të licencave të institucionit, veprimtarite financiare të lejuara janë disa, por aktiviteti primar për të cilin NOA është e specializuar dhe njihet publikisht, mbetet financimi me kredi i bizneseve të vogla e të mesme, individëve, agrobizneseve dhe fermerëve . Në saj të eksperiencës rreth 24 vjecare në kredidhënie, NOA ka krijuar kapacitete të padiskutueshme njerëzore dhe ka adaptuar procedura efektive pune duke arritur standardet më të larta profesionale të vlerësimit të kredikërkuesve si dhe eficencë të kenaqshme në përdorimin e burimeve të saj. Sikurse theksuar edhe në pjesë të tjera të këtij Prospekti, aktiviteti i institucionit, pra kredidhënia, është financuar kryesisht me hua/kredi nga partnerë të huaj dhe vendas dhe, në një pjesë më të vogël, nga kapitali i aksionarëve. ➢ *Segmentet e Klientelës* Në bazë të rregullave të brendshme të kategorizimit të klientëve të saj, NOA i shërben këtyre segmenteve : - **Biznese të vogla e të mesme**-subjekte biznesi të formave të ndryshme ligjore dhe që operojnë në fusha të ndryshme të ekonomisë, përveç agrobiznesit; - **Agrobiznese e fermerë**- subjekte që operojnë në fushën agrobiznesit si dhe fermerë të vegjël; - **Individë**- persona me të ardhura nga punësimi; ➢ *Produktet dhe Shërbimet e NOA-s* NOA ofron 3 kategori bazë shërbimesh e produktesh të cilat janë: -**Financimet e drejtëpërdrejta.** Kreditimi i përshtatet segmenteve të klientelës me produkte të ideuara posacërsiht për nevojat e secilës kategori. Produktet e financimit variojnë për nga qëllimi i përdorimit të fondeve, limitit maksimal të financimit, dokumentaconit të vlerësimit të rastit dhe kërkesës apo jo për kolateral/garanci. Kreditë, për nga qëllimi, mund të mbështesin investimet, kapitalin qarkullues, rinovimin e mjediseve të biznesit apo të familjes, blerjen e makinerive apo dhe nevoja të paparashikuara; kanë afate kohore nga 2 muaj deri ne 7 vite, si dhe vlera që shkojnë deri në 20 milionë Lekë. Në fund të vitit 2022, kredia për segmentin biznese përfaqëson 62% të totalit të portofolit aktiv, kredia për segmentin agro 21% dhe për individët 17%. -**Partneriteti**-.Bashkëpunimi me operatorët tregtare me qëllim ofrimin e " blerjes me këste" të produkteve të tyre. Klienti, i cili nuk disponon vlerën monetare për realizimin e blerjes në dyqan, përdor financimin e shpejtë nga NOA, me këste fikse dhe për një afat maksimal prej 24 muajsh. Aplikimi për blerjen me këstë realizohet në ambjentet e tregtarit, pa qënë nevoja e paraqitjes në zyrat e NOA-s. **- Këshillimi.** NOA ofron këshillim për agrobizneset dhe fermerët e vegjël lidhur me menaxhimin financiar të sipërmarrjeve të tyre, aplikimit të fermerëve në skemat e mbështetjes në bujqësi (AZHBR, IPARD etj), procesit të çertifikimit të cilësisë dhe sigurisë së produkteve bujqësore ejt. ➢ Portofoli i kredisë Në këtë Prospekt, ndalemi gjatë në analizën dhe informacionin mbi Portofolin e Kredisë- i cili është aseti më i rëndësishëm i institucionit dhe ecuria e tij dëshmon se si insitucioni ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë të suksesshme. Si më 31 Dhjetor 2022, portofoli i kredive të klientëvë ze një peshë prej rreth 87% të totalit të aseteve dhe ka një vlerë neto rreth 6,9 miliardë Lekësh. Portofoli i kredisë ne volum, ndahet në raportin 82,9% kredi për subjektet (Biznese) dhe 17,1% kredi për idividë (Retail). Indikatorë të rëndësishëm të Portofolit të Kredisë paraqiten në dinamikën e tyre nëpërmjet grafikëve e tabelave të mëposhtme:



Grafiku i mësipërm paraqet madhësinë e portofolit neto të kredisë si dhe % e portofolit me vonesë mbi 90 ditë në shlyerje, përgjatë 7 viteve të fundit të aktivitetit të NOA-s. Ky grafik dëshmon më së miri "rritjen" e insitucionit ndër vite, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor.

Rritja e portofolit të kredisë dhe mbajtja e një niveli minimal vonesash është arritur në saj të një menaxhimi shumë të kujdesshëm të aktivitetit, mbështetur nga këto shtylla kryesore: profesionalizmi i lartë i stafit të shitjes dhe analizës financiare; modeli efektiv i vendimarrjes për kreditim dhe sistemi i fortë i kontrollit.

Përgjatë 5 viteve të fundit, portofoli neto i kredisë ka shënuar një normë të përbërë rritjeje vjetore (CAGR-compounded annual groëth rate) prej rreth 11,62% në vit (CAGR=9,8% në vit përgjatë 10 viteve të fundit) . Ky nivel rritjeje vjetore, duke patur në konsideratë maturitetin e shkurtër të kredive të NOA-s (maturiteti mesatar i një kredie është rreth 24-26 muaj), dëshmon punën e vazhdueshme dhe të pandërprerë të ekipit shitës së NOA-s për afrimin e klientëve të rinj si dhe kreativitetin e menaxherëve të institucionit duke dizenjuar vazhdimisht produkte të reja që i përgjigjen më së miri nevojave të klientëve dhe duke lehtësuar e modernizuar procedurat e vlerësimit dhe miratimit të kërkesave për kredi.

Vetëm 2.02% e portofolit të kredisë së NOA-s rezulton me vonesa mbi 90 ditore si më 31 Dhjetor 2022. Jo vetem për vitin 2022, por historikisht, NOA ka qënë ndër të rrallat insitucione kredidhënëse në Shqipëri me nivele të tilla minimale të kredive me probleme (pra treguesit të % së portofolit me vonesa në shlyerje mbi 90 ditë) në mënyrë të vazhdueshme përgjatë viteve.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten tregues të cilësisë së portofolit, për 3 vitet e fundit financiare:

Tregues të Cilësisë së Portoflit*	**2022**	**2021**	**2020**
PAR +30 (portofoli me vonesa mbi 30 dite) ndaj totalit	3.5%	3.5%	5.0%
PAR +90 (portofoli me vonesa mbi 90 dite) ndaj totalit	2.0%	2.2%	2.4%
PAR+90 & Kredi të fshira	5.5%	6.4%	6.3%

**Treguesit e mesiperm jane paraqitur bazuar ne pasqyrat financiare te pergatitura sipa politikave te grupit*

Si më 31 Dhjetor 2022, totali i kredive me probleme dhe atyre të fshira nga bilanci, shënuan 5.5% të totalit të portofolit të kredisë. Ndonëse NOA synon të minimizojë cfarëdolloj problematike me kreditë, niveli prej 5.5% i kredive me probleme (përfshirë kreditë e fshira nga bilanci) përfaqëson një nivel relativisht të ulët nëse krahasohet me tregun. Kjo cilësi portofoli dëshmon vëmendjen e madhe që institucioini i kushton vlerësimit të kredikërkuesve në momentin e aplikimit dhe modelin e suksesshëm të mbledhjes së kredive.



Numri i kredive të disbursuara varion nga një vit në tjetrin si pasojë e faktorëvë e ndryshëm, duke filluar nga kushtet makroekonomike në përgjithësi dhe niveli i kërkesës për kredi deri tek faktorë të brendshëm të tillë si lancimi i produkteve të reja, decentralizimi i vendimarrjes për kredidhënie për shuma të vogla, lehtësimi i procedurave të brendshme për vlerësimin dhe aprovimin e rasteve etj. .
Disbursimet e kredive, në pjesën më të madhe realizohen në monedhën Lekë pasi kjo është edhe monedha në të cilën arkëtojnë të ardhurat pjesa dërrmuese e klientëve të NOA-s. Vetëm 1,4% e numrit te kredive disbursohen në monedhën Euro.



Viti 2022 ka qënë viti më i mirë për sa i përket volumeve të disbursuara nga NOA. Një faktor i rëndësishëm që ka ndikuar në volumet më të larta të kreditimit ka qënë shërbimi i një numri më të madh "biznesesh të mesme e të vogla (SME)". Klientët SME nuk kanë qënë në fokus të NOA-s vite më parë por prej të paktën 5 viteve të fundit, NOA ka përshtatur produktet e saj edhe për këte kategori klientele dhe është duke punuar fort për afrimin e një numri gjithnjë e më të madh klientësh SME.
Sikurse theksuar edhe në paragrafinmë sipër, kreditë e denominuara në monedhën Lekë mbizotërojnë ndaj atyre në monedhën Euro, duke përberë rreth 85% të total disbursimeve te vitit 2022.



Grafiku i mësipërm paraqet normat e rritjes së portofolit neto të kredisë si dhe vlerave të disbursuara përgjatë 7 viteve të fundit. Sikurse shihet grafikisht, viti 2022, ka qënë një vit shumë pozitiv sa i takon kredidhënies së institucionit pasi disbursimet e reja shënuan rritjen vjetore prej 23,9%. Përvec vitit 2020, gjatë të cilit u disbursua pothuaj e njëjta vlerë si në vitin paraardhës (2019), përgjatë cdo viti tjetër të periudhës së marrë në shqyrtim më sipër, disbursimet vjetore kanë tejkaluar vlerat e vitit pararendës në mënyrë të ndjeshme. Edhe madhësia e portofolit gjendje ka ndjekur një ritëm përshpejtues rritjeje përgjatë viteve të fundit, duke garantuar të ardhura më të larta nga interesat dhe përmirësim të vazhdueshëm të përfitueshmërisë së institucionit .

Kjo "rritje"e biznesit të NOA-s përtej normës së rritjes ekonomike të Shqipërisë dhe përtej normës mesatare së rritjes së sektorit bankar e financiar ka ardhur si rezultat i zbatimit të një strategjie biznesi të mirëmenduar nga ekipi drejtues i NOA-s. Në qëndër të strategjisë afatmesme të NOA-s janë shtyllat e mëposhtme:

- Zgjerimi i target grupeve të klientelës. Nëse para disa viteve klientela e NOA-s përbëhej kryesisht nga individë dhe biznese të cilët nuk shërbeheshin nga sektori bankar për shkak të kritereve të shtrenguara për financime që bankat aplikojnë, përgjatë viteve të fundit NOA eshte perballur me nje kerkese ne rritje nga kliente te bankave, per arsyen paresore te sherbimit te shpejte dhe fleksibel, sidomos tek biznesi i vogel dhe i mesem, ku koha e financimit eshte thelbesore per nevojat e biznesit. Nderkohe, edhe ofrimi i kredisë konsumatore dhe mundësia e pagesave me këste për blerje produktesh në pikat e bashkëpunëtorëve të saj, janë disa nga veprimet e ndërmarra nga NOA për zgjerimin e kategorive të klientelës së saj.
- Diversifikimi i vazhdueshëm i kanaleve të shpërndarjes/shitjes dhe dizenjimi i produkteve të reja që i përgjigjen kërkesave të klientelës dhe tendencës botërore të digjitalizimit të shërbimeve.
- Zgjerimi i shërbimeve financiare. Brenda një periudhe afatmesme (2024) NOA do të zgjerojë gamën e shërbimeve financiare për klientelën e saj. NOA është duke vlerësuar përgatitjen e kuadrit të brendshëm rregullativ si dhe duke ngritur infrastrukturën e nevojshme për ofrimin masiv të shërbimeve të pagesave , transfertave dhe këmbimit valutor.

Portofoli i kredisë së NOA sh.a. është financuar/krijuar përmes fondeve të përfituara nga kredi dhe linja të huave që kompaniaka marrë nga institucione financiare ndërkombëtare ndër vite. Partnerë të huaj kanë financuar dhe rifinancuar NOA sh.a ndër vite pasi institucioni ka qënë dhe është në përmbushje të kushteve të vendosura prej tyre,-kushte të cilat lidhen kryesisht me misionin paresor te kompanise per perfshirje sociale dhe financiare te segmenteve te nen-sherbyera financiarisht, cilësinë e portofolit të kredisë si dhe me tregues (indikatorë) të tjerë që dëshmojnë nivelin e shëndetit financiar të Institucionit.

Pika 5.1.1	**5.1.1 Përshkrimi i faktorëve kryesorë për natyrën e veprimtarisë e tij kryesore, duke përcaktuar kategoritë kryesore të produkteve të shitura dhe/ose shërbimeve të kryera për çdo vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat historike financiare.** *Faktorët që ndikojnë aktivitetin.* Ecuria e aktivitetit të kredidhënies ndikohet nga faktorë të jashtëm e të brendshëm, ndër të cilët më të rëndësishmit i kemi listuar më poshtë: - **Niveli i kërkesës për kredi** është faktori thelbësor i cili përcakton rrjedhën e biznesit të NOA-s. Kërkesa për kredi është e impaktuar drejtëpërdrejtë nga faktorë makroekonomikë të tillë si situata ekonomike në përgjithësi , normat e interesit në treg, niveli i inflacionit etj. Kushtet aktuale makroekonomike, me një inflacion ndjeshëm mbi objektivin e Bankës së Shqipërisë dhe me norma interesi që po rriten në mënyrë të vazhdueshme prej disa muajsh tashmë, nuk janë optimalet për nxitjen e mëtejshme të kreditimit të ekonomisë; madje nëse do tí referohemi teorisë ekonomike, këto kushte do të ndikonin në tkurrjen e kërkesës për kredi. Megjithatë, referuar situatës së Shqipërisë dhe mbështetur në deklaratat për shtyp të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë por edhe opinioneve të drejtuesve të lartë të Bankave dhe Institucioneve të ndryshme kredidhënësë, parashikohet se situata inflacioniste nuk do të impaktojë në mënyrë të ndjeshme kërkesën për kredi, ekonomia shqiptare pritet të vijojë rritjen dhe inflacioni të ulet gjatë vitit 2023. Ky faktor ndikon në mënyrë të njëjtë mbi për të gjithë operatorët ekonomikë që veprojnë në sektorin financiar , atë të kredidhënies. - **Atraktiviteti i produkteve të NOA**. Kushtet dhe termat financiarë të produkteve të NOA-s luajnë një rol thelbësor mbi kërkesën e klientelës për to. Shërbimet plotësuese si këshillimi dhe ndërmjetësimi në sigurime janë të tjerë elementë që i shtojnë vlerë produktit të kredisë dhe e bejnë shërbimin e NOA-s të preferuar nga një numër gjithnjë e më i madh klientësh. - **Procesi i vlerësimit të kërkesave (dhe koha aprovimit).** NOA ka adaptuar një proces të shpejtë vlerësimi të rasteve. Koha mesatare e aprovimit të një kredie është rreth1,5 ditë nga kërkesa e klientit. Vendimarrja për kreditim kryhet në nivele të ndryshme komitetesh, bazuar në nivelin e rrezikut të cdo rasti si dhe në shumën e financimit të kërkuar, me qëllim arritjen e fleksibilitetit, vendimeve të shpejta e cilësore. Procesi i vlerësimit të rrezikut është i qëndërzuar për të gjitha kreditë, por pa humbur eficencën e vendimarrjes. Me këtë "përgjigje"të shpejtë ndaj kredikërkuesit, besojmë se NOA shënon një avantazh të rëndësishëm konkurrues në raport me bankat dhe disa institucione të tjera financiare jo-banka. - **Kontrolli dhe Monitorimi i Aktivitetit.** Po aq i rëndësishëm sa vlerësimi fillestar i rrezikut të kredikërkuesit në momentin e aplikimit për kredi, është edhe procesi i kontrollit dhe monitorimit të kredive dhe ecurisë së klientëve kredimarrës. "Kujdesi" i institucuonit pas disbursimit të kredive impakton në mënyrë të drejtëpërdrejtë cilësinë e portofolit të kredisë. Në përputhje me praktikat më të mira të kreditimit dhe me qëllim identifikimin e menjëhershëm të problematikave të mundshme lidhur me cilësinë e portofolit të kredisë, NOA ka ngritur një strukturë të dedikuar për kontrollin e kredidhënies, e cila realizon kontrollin e 40% të kredive të lëvruara gjatë muajit të mëparshëm, kontroll i kryer në terren gjatë vizitave monitoruese me klientin. Me vlerë të përmendet është edhe funksioni i Komitetit të Manaxhimit të Riskut të Kredisë. Ky komitet përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Drejtori Riskut, Drejtori i Operacioneve, Drejtori i Finances dhe mblidhet çdo tre muaj. Ky komitet ka synim vendosjen dhe monitorimin e limiteve të ekspozimit për çdo sektor, rajon, autoritet aprovues, produkt, etj., bazuar në analizën e cilësisë së portofolit në vonesë ose jo, degës dhe produktit etj.. Rezultatet dhe analizat respektive, të kombinuara me gjetjet nga kontrollet e Njësisë së Parandalimit te Mashtrimit, i shërbejnë drejtuesve të Institucionit për të marrë vendime të

rëndësishme të lidhura me produktet e kredisë, proçeset dhe proçedurat përkatëse, por edhe për të kryer parashikimet e mëtejshme në zhvillimin e portofolit të kredisë.

Në mënyrë që të maksimizohet kthimi i kredive sipas afateve të kontratave me klientët dhe me qëllimin për të mbajtur nën kontroll cileësinë e portofolit, NOA ka ngritur në strukturat e saj edhe skuadrën e mbledhjeve të kredisë e cila përbëhet nga oficerët e mbledhjes së kredisë që ndodhen në Degë dhe Drejtorët Zonal të Mbledhjes së kredive, të cilët udhëzohen dhe drejtohen nga Njësia e Mbledhjes së Kredisë të vendosur pranë zyrës qendrore. NOA respekton të gjitha të drejtat e klientëve në vonesë si dhe i mban ata gjatë gjithë kohës të informuar mbi pasojat financiare të mosrespektimit të afateve kontraktuale për pagesën e kredive.

- **Menaxhimi financiar i Institucionit/ mënyra e përdorimit të burimeve.** Duke qënë se NOA financon aktivitetin e saj kryesisht nëpërmjet huamarrjes dhe në masë më të vogël nga kapitali aksionar, cështja e sigurimit e përdorimit të fondeve si dhe menaxhimit të kostove të tyre është thelbësore për suksesin e aktivitetit.
    - **Marredhënia me partnerët financues.** NOA prej 22 vitesh, ka krijuar një rrjet të gjërë partneritetesh financiare me institucione bankare të huaja dhe kombëtare, si Banka Europiane e Investimeve, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka e Detit të Zi për Zhvillim e Tregti etj. Në kuadër të këtyre partneriteteve, NOA i nënshtrohet, çdo vit, disa proceseve të monitorimit të aktivitetit të saj, verifikimit nëse operon konform kushteve kontraktuale (përfshire respektimin e treguesve/normave financiare) dhe standarteve të raportimit si dhe respektimit të kushteve të rregullatorëve lokale. Vetëm gjatë 5 viteve të fundit, NOA ka qarkulluar mbi 83 milion euro financime të siguruara nga partnerët si pasojë e performancës dhe rezultateve pozitive të institucionit, kjo bën që institucioni të jetë gjithmonë konform standarteve më të larta të raportimit dhe respektimit të treguesve/normave financiare ndërkombëtare dhe lokale.. Termat e financimit nga partnerët luajnë një rol të rëndësishëm në përfitueshmërinë e aktivitetit pasi ato ndikojnë drejtëpërsëdrejti në marzhin e fitimit të NOA-s.
    - **Menaxhimi i fondeve.** Mënyra e përdorimit të fondeve të huazuara është thelbësore për përfitueshmërinë e këtij biznesi. Fondet e marra hua nga partnerët janë përgjithësisht në monedhën Euro (e ndryshme nga monedha bazë e kreditimit të klientëve) ndaj NOA ka përdorur një strategji mbrojtje nga rreziku i luhatjes së padëshirueshme të kursit të këmbimit duke i angazhuar këto fonde në depozita ose investime të tjera financiare dhe më pas , duke përdorur këto depozita/investime si garanci, është financuar nga bankat lokale në monedhën Lekë. Kjo strategji e ka mbrojtur institucionin nga goditjet e që mund të kishte pësuar gjatë periudhave në të cilat Leku është zhvlerësuar në raport me Euron. Aspekt tjetër akoma më i rëndësishëm i menaxhimit të fondeve në dispozicion të aktivitetit, është alokimi eficient i tyre në zërat më profitabël të aktiveve. Fondet, janë angazhuar në krijimin e një portofoli kredie cilësor, me tregues NPL (kredi me probleme) vetëm 2% (2022 dhe i cili i siguron institucionit një normë efektive interesi prej 23,75% (2022).

Produktet e Financimit

NOA ofron lloje të ndryshme produktesh financimi (kredish) të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra për nga qëllimi për të cilën përdoren si dhe procedura e vlerësimit të riskut të secilës (niveli i kërkesës për dokumentacion dhe koha e aprovimit). Produktet e NOA-s janë:

Produktet për Segmentet BIZNES dhe AGRO:

- **Kredia ECO** – financim për përmirësimin e kushteve të ambjenteve të biznesit, me synim përmirësimin e eficencës së përdorimit të energjisë.
    - Financim deri në 1,5 milion lekë;
    - Afat shlyerje deri në 60 muaj;
    - Normë interesi duke filluar nga 18% dhe NEI 20.80%;

- Pa bashkëkredimarrës;

- **Kredia FAST**- financim i shpejtë për investime në makineri, linja prodhimi, pajisje, automjete pune, rregullime te ambientit të punës apo blerje të ambienteve të punës. Financim nga 150,000 Lekë deri në 1,000,000 Lekë;
  - Afat shlyerje deri në 48 muaj;
  - Këste fleksibël sipas nevojave të klientit;
  - Norme interesi duke filluar nga 20.04% dhe NEI 23.53% ;

- **Kredi për INVESTIME –** financime për investime me vlerë të madhe deri në 14.000.000 Lekë, për blerje makinerish, linja prodhimi, pajisje, automjete pune, rregullime te ambientit të punës apo blerje të ambienteve të punës.
  - Afat shlyerje deri në 72 muaj;
  - Këste fleksibël sipas nevojave të klientit;
  - Norme interesi duke filluar nga 16% dhe NEI 18.09% ;

- **Kredia për Aktive Qarkulluese (Me Afat dhe FLEXi) -**"Kredi me afat" deri në 36 muaj me këste të përshtatura sipas sezonalitetit të biznesit si dhe "Kredi flex" me mundësinë per të përdorur lirshëm fondet e kredisë gjatë të gjithë periudhes 12 mujore për çdo nevoje për shtim inventari, për investime në inventar të ri, për pagesa të furnitoreve apo për parapagime të ndryshme.
  - Financim deri në 14.000.000 Lekë;
  - Afat shlyerje deri në 36 muaj;
  - Norme interesi duke filluar nga 16% dhe NEI 19.03% ;

- **Kredia Agro-CERTIFIKIM** (vetëm për segmentin AGRO)-Kredi deri ne 1.000.000 Lekë me afat deri në 48 muaj (4 vite) me këste fleksibël të përshtatura sipas nevojave të fermerëve/agrobizneseve me qëllim financimin e marrjes së standarteve nga ana e fermerëve apo agro-bizneseve shqiptare. Një produkt financiar që synon forcimin e kapaciteteve të fermerit shqiptar. Financimi nëpërmjet një kredie të këtyre çertifikatave bujqësore synon ndër të tjera dhe uljen e ndikimit negativ konvencional të bujqesisë mbi mjedisin, por dhe adresimin e impakteve negative në shendetin e të punësuarëve në bujqësi dhe blegtori. Format e certifikimit qe mbeshteten nga ky produkt janë:
  - Standarti HACCP (Hazard Analysis of Critical Points)
  - Standarti ISO 22000
  - GlobalGAP6.
- **Kredi për Përfituesit nga Skemat e Mbështetjes në Bujqësi** (vetëm për segmentin AGRO) – financime të fermerëve që janë pjesë e skemave të mbështetjes në bujqësi (IPARD, AZHBR).
  - Financim deri në 20 milion Lekë
  - Normë interesi duke filluar nga 16% dhe NEI 19.03%
  - Kolateral jo i domosdoshëm
  - Mbyllje e pjesshme pa komisione

<u>Produktet për Segmentin Individë</u>:

1. **Kredia HABITAT (ECO)**- financim për përmirësimin e kushteve të ambjenteve të banesës, me synim përmirësimin e eficencës së përdorimit të energjisë dhe jo vetëm. Rimobilimi, izolimi, rikonstruksioni apo investime me fokus performancën energjetike për banesën janë disa nga qëllimet për të cilat ky produkt përdoret më së shumti.

	- Financim deri në 5 milionë lekë; - Afat shlyerje deri në 120 muaj; - Normë interesi duke filluar nga 18% dhe NEI 21.47%; 2. Kredi 60' -Një financim dedikuar individit, me qëllim mbulimin e çdo nevoje të momentit apo shpenzimeve të paparashikuara, personale apo familjare. Vlerë financimi deri në 60,000 leke me afat kthimi 2 muaj. Për klientët që financohen për herë të parë, për shuma deri në 30,000 Lekë financim me 0% interes. 3. Kësti FIKS- Një risi për tregun financiar e cila konsiston në përshtatjen e shumës së kredisë dhe afatit në bazë të kështit të përzgjedhur në aplikim nga klienti. Financim në çast vetëm me ID për mbulimin e nevojave personale për shuma deri në 200,000 Lekë. 4. Kredi PERSONALE- Mbulim i nevojave për investime familjare apo personale të rëndësishme si riparimet e banesave, blerja e një automjeti familjar apo personaletj. - Financim deri në 1 milion Lekë; - Afat shlyerje deri në 60 muaj; - Normë interesi duke filluar nga 23% ; NEI 27.92%; - Me pagesa të rregullta mujore; Produkt tjetër i ofruar nga NOA, i përbashkët për të gjithë segmentet e klientelës, është edhe "Blerja me këste" nga partnerët e institucionit. Nëpërmjet këtij produkti, klienti mund të realizojë blerjen pajisjeve personale apo të biznesit, mjeteve bujqësore, orendive, elektroshtëpiakeve, automjete, teknologji etj menjëherë në ambjentet e tregtarit (partner i NOA-s) duke përdorur këtë formë financimi të menjëhershëm me këste fikse.
Pika 5.1.2	Pika 5.1.2 Një përshkrim i çdo produkti dhe/ose shërbimi të ri të rëndësishëm të futur rishtazi dhe, në masën që zhvillimi i këtyre produkteve apo shërbimeve të reja është bërë publik, të tregohet statusi i zhvillimit të tyre. Produktet dhe shërbimet "risi" të prezantuara kohët e fundit nga NOA janë "aplikimi online për kredi" dhe financimi i llojit "blerje me këste" nga rrjeti i tregtarëve partnerë të NOA-s. Aplikime Online per Kredi Prej vitit 2018, NOA realizoi zhvillimet e duhura teknologjike dhe ofroi mundësine e aplikimit online për kredi nga faqja e internetit të institucionit (www.noafin.al). Aplikimet online për kredi fituan gradualisht popullaritet në rradhët e klientëve të NOA. Rreth 21.5% e aplikimeve për kredi gjatë vitit 2022, u realizuan në formën online. Aplikimi online për kredi u është mundësuar të gjithë kategorive/segmenteve të klientelës së NOA dhe për cdo produkt por deri më sot segmenti "Individë" është ai që ka shënuar pjesën më të madhe të aplikimeve online. Përpos avantazheve në drejtim të optimizimit të menaxhimit të kohës së oficerëve të kredisë, aplikimet online shoqërohen me risqe, kryesisht të lidhura me vërtetësinë e të dhënave të deklaruara dhe dokumentave të ngarkuar online. Për minimizimin e këtyre rreziqeve, për çdo aplikim online të miratuar, kërkohet konfirmimi i tij edhe fizikisht me paraqitjen e detyruar të klientit në degë. Shërbimi i aplikimit online, është aktualisht 100% i realizuar dhe funksional për publikun. *Figura e mëposhtme është pamje nga web-i i NOA-s, seksioni aplikim online.*



Blerjet me Këste

Paralelisht me zhvillimet për aplikimet online, NOA krijoi gjithashtu mundësinë që klientët të realizojnë "blerje me këste"nga tregtarët partnerë me të cilët NOA nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi. Financimi i NOA-s i llojit "blerje me këste"është një financim i shpejtë, aplikimi për të cilin realizohet në ambjentet e tregtarit me suportin e stafit të trajnuar të këtij të fundit. Aktualisht, ky shërbim 100% i zhvilluar, i ofrohet të gjithë segmenteve të klientelës dhe blerjet e financuara mund të jenë të shumëllojshme duke filluar nga elektroshtëpiaket, pajisje elektronike deri tek automjetet, makineritë e biznesit, pajisje agro-përpunuese etj të cilat shiten nga tregtarët partnerë të NOA-s.

Si më datën e këtij Prospekti NOA numëron 77 tregtarë me të cilët ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për "blerjet me këste" dhe lista e tyre gjendet e publikuar në faqen e internetit të NOA-s në seksionin "Partnerë Biznesi", https://noafin.al/partner-biznesi .

Investime/Projekte në Teknologji Biometrike

Me qëllim rritjen e cilësisë dhe sigurisë së komunikimit me klientët si dhe të uljes së kostove dhe risqeve operacionale që shoqërojnë aplikimin për kredi dhe komunikimin virtual me klientët, NOA ka investuar përgjatë dy viteve të fundit në adaptimin e teknologjive biometrike dhe standardizimit të komunikimit në distancë me klientët e saj. Këto investime do të mundësojnë përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe të shpejtësisë së verifikimit të klientëve në terren nga njëra anë, si dhe të cilësisë së shërbimit ndaj klientëve nga ana tjetër. Realizimi 100% i kësaj nisme, në bashkëpunim me partnerë të jashtëm si ALEAT, përfaqëson një histori suksesi për mbarë sektorin e mikrofinancës në Shqipëri dhe në rajon.

Shërbime të Reja Financiare

NOA është duke përgatitur ofrimin e shërbimeve të reja financiare për klientët e saj, brenda një periudhe afatshkurtër në afatmesme. Shërbime të tilla si:

- këmbime valutore;
- ofrimi i transfertave dhe pagesave;
- ndërmjetësimi në sigurime përtej produktit të sigurimit "Payment Protection Insurance" për kredimarrësit e saj;
- shërbime të tjera plotësuese të shërbimeve të mësipërme ;

planifikohen të ofrohen për klientët ekzistues e të rinj me qëllim plotësimin e gamës së shërbimeve financiare që mund të ofrohen, për të plotësuar shërbimet bazë të klientëve tanë, qoftë të një biznesi të vogël apo familje, pa i detyruar ata të lëvizin në institucione të ndryshme për shërbime të ndryshme, gjë e cila rrit koston dhe kohën e shërbimit të klientëve. Gjithashtu, ofrimi i këtyre shërbimeve

mundëson diversifikimin e burimit të të ardhurave te Institucionit, përtej atij te gjeneruar prej aktivitetit kredidhënës. Ofrimi i këtyre shërbimeve nuk kërkon rritje kapitali apo ndryshim të modelit të biznesit, duke qënë se janë brenda natyrës së produkteve / sherbimeve financiare dhe kapitali aktual i Institucionit është mjaftueshmërisht i lartë. Por sigurisht, Institucioni është duke përgatitur kuadrin e brendshëm rregullativ për secilin prej shërbimeve të mësipërme dhe po vlerëson investimet e mundshme në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit që të bëjë të mundur realizimin e shërbimeve shtesë në mënyrë sa më eficiente, të sigurtë dhe të shpejtë. Disa shërbime shtesë parashikohet të ofrohen për klientët brenda vitit 2023, të tjera brenda vitit 2024.

Pika 5.2

Pika 5.2 Tregjet kryesore Një përshkrim i tregjeve kryesore, në të cilat konkurron emetuesi, përfshirë një pasqyrë të të ardhurave të përgjithshme sipas segmentit të tregut të produktit dhe atij gjeografik për çdo vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat historike financiare.

NOA operon në sektorin e kredidhënies, në nivel kombëtar, duke u fokusuar në kreditimin e bizneseve të vogla e të mesme, të bujqësisë dhe të nevojave të familjes, çka njihet në përgjithësi si sektori i mikrofinancës. Në këtë treg, në të cilin operojnë subjekte të licencuara nga Banka e Shqipërisë si Institucione Financiare Jo-Banka dhe Institucione Mikrofinanciare, NOA është aktori i dytë më i madh në terma portofoli outstanding si dhe në numër stafi.

Si më datën e këtij Prospketi, numërohen 38[4] Institucione Financiare Jo-Banka në vend, prej të cilave 10 janë të licencuara për kredidhënie dhe 7 për mikrokredi (2021: 35 IFJB në total; 9 institucione të licencuara për kredidhënie dhe 6 të licencuara për mikrokredi). Subjektet e listuara më poshtë konsiderohen konkurrentët e linjës së parë për NOA pasi të gjithë japin kredi të vogla, kanë një përqindje relativisht të lartë klientësh në zona rurale, nuk kanë të drejtën e pranimit të depozitave dhe që të gjitha kanë kërkesë relativisht më të ulët për dokumentacion dhe garanci se sa subjektet e sektorit bankar.

Institucioni	Kredidhënie	Mikrokredi
Agrokredit	√	
Ak-Invest	√	
Fondi Besa	√	
NOA	√	
Tranzit	√	
FIN - AL	√	
Crimson Finance Fund	√	
Micro Credit Albania	√	
Albanian Financial Institution	√	
FAB-INVEST	√	
Agro & Social Fund		√
MIA Finance (ish Capital Invest)		√
Iutecredit Albania		√
Agro Partner		√
Kredo Financë		√
Credital (ish Micro Credit Risk)		√
Lendal		√

[4] Informacion sipas faqes zyrtare tw Bankës së Shqipërisë, visituar më 11.04.2023.
https://www.bankofalbania.org/rc/doc/WEB_BSH_LISTA_E_SFJB_TE_LICENCUARA_2_2023_shqip_23445.xlsx

Burimi : Banka e Shqipërisë, Subjekte të Licencuara[5]

Nëse do të analizojmë tregun e Institucioneve Financiare Jo Banka (IFJB) pwr vitin 2021[6], konstatohet një pozicionim shumë i mirë dhe solid i NOA-s në të.

Portofoli bruto i kredisë sipas veprimtarive (31 Dhjetor 2021)	Total IFJB	NOA
Kredidhënie	16.6	6.3
Mikrokredi	15.4	
Qira financiare	9.6	
Faktoring	0.5	
Portofoli bruto në miliardë Lekë	**42.1**	**6.3**

Portofoli bruto i NOAs ndaj Totalit IFJB në %	15%
Portofoli bruto i NOAs ndaj Totalit të Institucioneve të licencuara per Kredidhënie dhe Mikrokredi në %	20%
Portofoli bruto i NOAs ndaj Totalit të Institucioneve të licencuara per Kredidhënie në %	38%

Burimi : Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes 2021

Portofoli bruto i kredisë i institucioneve që mbartin risk kredie, pra ato që janë të licencuara për aktivitetet e paraqitura në tabelën e mësipërme, ka qënë 42.1 miliardë Lekë si më 31.12.2021. Portofoli Bruto i NOAs, për të njëjtën periudhë, është 6.3 miliardë Lekë ose 15% e totalit të tregut. Nëse NOA-n e krahasojmë me institucionet të cilat kanë të njëjtën licencë aktiviteti (kredidhënie), portofoli i NOAs ndaj totalit të portofolit të këtij grupi është 38%.

Më poshtë, paraqitet madhësia relative e NOAs në raport me tregun e Institucioneve Financiare Jo Banka si më 31 Dhjetor 2021. Treguesit e analizuar më poshtë janë më të rëndësishmit për vlerësimi e madhësisë së Institucionit : Asetet, Portofoli Bruto dhe Portofoli Neto i Kredisë. Pozicionimi i NOAs, sipas praqitjes grafike të mëposhtme, do të ishte ndjesëm më i mirë nëse krahasimi do të realizohej me institucionet që kanë licencë të njëjtë me NOA-n (kredidhënie), por për shkak të mungesës së të dhenave për atë pjesë tregut, NOA është vendosur përballë total tregut të IFJB.



[5] Informacion sipas faqes zyrtare tw Bankës së Shqipërisë, visituar më 11.04.2023. (https://abcxyzhttp://abczyvbankofalbania.org/rc/doc/WEB_BSH_LISTA_E_SFJB_TE_LICENCUARA_2_2023_shqip_23445.xlsx)

[6] Nw momentin e hartimit tw kwtij Prospekti, nuk pa patur tw dhwna publike, tw konsoliduara dhe nga burime zyrtare mbi aktivitetin kredidhwnws tw IFJB pwr vitin 2022.

Asetet e NOAs përbëjnë rreth 9% të totalit të aseteve të tregut të IFJB, i cili , si më 31 Dhjetor 2021 përbëhej nga 35 shoqërive të licencuara në total.

Në grafikun e mëposhtëm paraqesim treguesit "Kredi me Probleme", "ROA" dhe "ROE" për tregun e IFJB (total 35 institucione) dhe NOA për vitin 2021. Referuar cilësisë së portofolit të kredisë, konstatohet një epërsi e NOAs ndaj Tregut; kështu raporti i kredive me probleme të NOAs (NPL) ka qenë 2.23% për fundin e vitit 2021 ndërkohë që raporti i kredive me probleme të total tregut ishte 3.96%. Ky indikator perllogaritet sipas standarteve te raportimit SRU prane Bankes se Shqiperise, raport i gjendjes se kredive ne vonese (NPL) mbi gjendjen e portofolit bruto te kredise. Kjo diferencë mes treguesve të cilësisë së portofolit të NOAs dhe Tregut, është evidencë e standardeve të larta të menaxhimit të emetuesit në përgjithësi dhe vendimmarrjes së duhur për kreditim dhe monitorimit të fortë të kredive në veçanti.

Treguesit e përfitueshmërisë së NOAs, gjithashtu, kanë rezultate relative më të mira se ato të tregut të institucioneve financiare jo banka.



Kështu, Kthimi nga Aktivet (ROA) për NOA-n ishte 5.06% në fund të vitit 2021 ndërkohë që ky tregues për totalin e tregut ishte 4.8%. Kthimi nga Kapitali, për vitin 2021, rezultoi 18.8% për NOA-n dhe 13.8% per tregun. Nëse do ti referoheshim rezultatit financiar neto, në vlerë absolute, tregu i IFJB shënoi një fitim total prej rreth 3.66 miliardë Lekë në vitin 2021, ndërkohë vetëm NOA kontribuoi në këtë rezultat me 322 milionë Lekë ose rreth 9% të totalit.

Nëse do të analizojmë klientelën e krediruar nga NOA dhe tregu i IFJB në total për vitin 2021 , do të konstatojmë strukturat e meposhtme të klientelës së shërbyer, për nga natyre e tyre biznes apo individë:





Sikurse shihet, aktiviteti i kredidhënies mbetet i orientuar drejt biznesit, me mbi 80% të portofolit te kredise të perqendruar tek ky segment me financime. Struktura e portofolit të kredise në NOA është pothuajse e njëjtë me atë të tregut të IFJB. Duke qënë se institucione të ndryshme kanë segmentime të ndryshme të brendshme të klientelës, rezulton e pamundur një analizë krahasuese e klientëve të

financuar nga tregu i IFJB sipas segmenteve të bredshme të NOA: Biznes i Vogel e i Mesëm , Agro dhe Individë.

Në aspektin gjeografik, aktiviteti/portofoli i NOA-s është i ndarë në katër rajone: Veri, Jug, Agro/Qëndër dhe Tirana. NOA ka një prezencë treg prej 26 degësh në 15 qytete të rëndësishme të vendit. Me vlerë është analiza historike e kredimarrësve në zona rurale dhe urbane, paraqitur më poshtë:



Në vitin 2022, 85% e klientelës së shërbyer me financime ka rezidencë në zona urbane dhe vetëm 15% e klientelës banon në zona rurale. Gjatë 3 viteve të fundit vihet re një rënie e % së klientëve të financuar në zona rurale dhe rritje e vazhdueshme e atyre në zona urbane. Rritja e "konkurrueshmërisë" së produkteve të NOA-s në raport me institucionet e tjera por edhe me bankat, rritja më e lartë ekonomike e zonave kryesore urbane, migrimi i popullsisë nga zonat rurale në ato urbane etj janë disa nga arsyet që kanë favorizuar rritjen e raportit të klientëve të financuar në zona urbane.

Të ardhurat e institucionit, sipas qarqeve, paraqiten në grafikët e mëposhtëm:





Së fundmi, analizojmë edhe kreditimin e NOAs sipas sektorëve të ekonomisë për të evidentuar fushat në të cilat NOA është më " prezente" me produktet e saj të financimit. Si më 31.12.2022 , sektorët më të kredituar nga NOA ishin Shërbimet më 28% të portofolit, Tregtia me 23% dhe Agrikultura me 18%. Nëse i referohemi informacionit të publikuar nga Banka e Shqipërisë, në Raportin Vjetor të Mbikëqyrjes 2021[7], sektorët më të financuar nga Tregu i Institucioneve Financiare Jo Banka ishin "Tregtia, riparimi i automjeteve" me 19.2% të portfolit të biznesit të tregut, "Aktivitete të tjera shërbimi" me 16.8% dhe " Ndërtimi" me 13%.

Pika 5.3

Pika 5.3 Ngjarjet e rëndësishme në zhvillimin e aktivitetit të emetuesit.

Me ngjarje të rëndësishme, Emetuesi nënkupton ndryshimet apo risitë të cilat kanë patur impakt në aktivitetin e kredidhënies gjatë viteve të shkuara. Më poshtë listohen ngjarjet e rëndësishme për Emetuesin, të datuara në këto 4 vitet e fundit :

[7] Nw datwn e kwtij Prospekti nuk disponohen tw dhwnat e tregut pwr vitin 2022.

	- Modernizimi i infrastrukturës teknologjike mbështetëse të shoqërisë duke rritur cilësinë dhe performancën teknike, monitoruese dhe atë financiare në të zhvilluarin e biznesit. (2019-2021), duke perforcuar me tej avantazhin konkurues te Institucionit ne treg - shpejtesine e sherbimit, dhe duke rritur numrin e klienteve te sherbyer ne nje afat kohor me te shkurtër. - Mundësimi 100% i aplikimeve në distancë nga faqja e internetit të NOA-s (2018), nga mjediset e biznesit të partnerëve (2019), nga hapësira e klientëve online "Llogaria Ime" (2021) si dhe nga faqet Online të vetë partnerëve. (2022) Kjo ka mundësuar rritjen e numrit te aplikimeve te kredise me rreth 450 aplikime te reja ne muaj, ose 20%. - Marrja e certifikatës nga Komisioni Europian si Institucion që vepron konform praktikave më të mira të ofrueseve të shërbimeve mikrofinanciare (2019) si dhe nga TUV Austria mbi sigurinë teknologjike. (2022) Kjo ngjarje ndihmon në rritjen e reputacionit të Institucionit kundrejt financuesve, autoriteteve mbikqyrëse dhe palëve të treta, si dhe është një element shumë i rëndësishëm tregues për standarte të larta të qeverisjes korporative dhe sigurisë së informacionit. - Zhvillimi i të gjithë procesit të aplikimit për kredi nëpërmjet tabletave në terren (qe prej 2015), ku përfshihet jo vetëm leximi i të dhënave të mbajtura në ID, por dhe autentifikimi biometrik. (2021) Ky zhvillim ka reduktuar kohën e procesimit për të gjithë aplikimet e kredise, duke e cuar kohen e aprovimit në 1.2 ditë, dhe sidomos përben një avantazh konkurues për produktet e biznesit të vogël të cilët ofrohen edhe për 20 minuta. - Zgjerimi i shërbimit të këshillimit nga thjesht këshillim financiar, në këshillim teknik duke u fokusuar kryesisht në bujqësi (trajnime në terren, partneritete, vizita jashtë vendit, këshillim digjital). (2019 – 2021) Nëpërmjet këtij shërbimi, synohet rritja e aftësive manaxhuese të klientëve në bizneset e tyre, rritje e standarteve dhe permirësim i kushteve të punës per stafin, mbrojtja e ambjentit dhe eficenca e energjisë, si pjesë të misionit social të Institucionit tonë. - Mundësimi për klientët e NOA të shlyejnë detyrimet e tyre pranë Sporteleve të EasyPay dhe Posta Shqiptare (2020) duke reduktuar kohën dhe koston e tyre për të kryer këtë shërbim pranë vendit të tyre të punës apo banimit. Gjithashtu, kjo ka ulur edhe me 40% numrin e veprimeve te kryera ne deget e Institucionit duke krijuar eficenca te brendshme. - Zbatimi i një sistemi të ri pikezimi të kredisë me impakt pozitiv në mbajtjen e nivelit të portofolit në risk në nivele të ulëta.(2018)
Pika 5.4	Pika 5.4 Strategjia dhe objektivat. Një përshkrim i strategjisë dhe objektivave tregtare, financiare e jofinanciare (nëse ka) të emetuesit. Ky përshkrim merr parasysh sfidat dhe perspektivat e ardhshme të emetuesit NOA harton dokumentin e Strategjisë Afatmesme të Biznesit cdo tri vite kalendarike dhe e rishikon atë me baza vjetore, në varësi të zhvillimeve të ambjentit të jashtëm dhe faktorëvë të brendshëm të organizatës. Strategjia e zgjedhur e biznesit për periudhën tre vjecare 2020-2022 ka qënë " Për çdo nevojë, në çdo kohë dhe në çdo vend" . Strategjia 2020-2022 NOA ka synuar të ruajë dhe përforcojë pozicionin e saj si një ndër institucionet financiare jo banka lidere të kreditimit, jo vetëm në terma numerikë por dhe të standarteve të ofruara në drejtim të klientëve të shërbyer. #ReinventingMicrofinance është termi kyç që përcakton këtë ambicie si një mënyrë për të vijuar historinë e suksesshme që daton prej vitit 1998, por duke u adaptuar nevojave të reja të tregut. Thelbi i kësaj strategjie rrotullohet rreth konceptit të ofruarit të shërbimeve të saj financiare ku(R)do : në çdo çast, për çdo fazë, dhe në çdo vendndodhje ku gjenden klientët e NOA. Ky objektiv, për të rizbuluar vetveten duke qenë ku(r)do, mori formën e strategjisë 3 x 3 përsa i përket tregut financiar në të cilin operon NOA : tre produkte, tre kanale, për tre segmente.

Strategjia e produkteve nënkupton ofrimin e shërbimit gjatë të gjithë zinxhirit tregtar të klientëve tanë, që nga kontaktimi i paraprak, dhe deri në marrjen e shërbimit post-kreditim me qëllim që marrëdhënia mes NOA e klientëve të jetë sa më afatgjatë dhe e plotë. Kështu, produkti 1 është këshillimi, i cili synon që klientët e NOA të jenë gjithmonë sa më të mirë informuar para se të angazhohen në një detyrim financiar. Këshillimi nënkupton edukimin financiar të klientëve tanë (një kuptim sa më i plotë i termave) por dhe ndërmjetësimin për një produkt specifik (shembull pajisje bujqësore) në mënyrë që klientët të bëjnë gjithmonë zgjedhjen më inteligjente. Produkti 2 është kredia. Me qëllim diferencimin nga sektori bankar dhe ai jo-bankar, kreditë e NOA janë të thjeshta për t'u aksesuar, të shpejta për t'u disbursuar dhe transparente për t'u kuptuar në mënyrë që kostot dhe rreziqet që lidhen me ofrimin e kredive të jenë sa më të ulëta. Produkti 3 është partneriteti. Çdo biznes partner i NOA-s ka mundësi të shesë produktet e tij me këste nëpërmjet financimit të ofruar nga NOA.

Me qëllim mbulimin sa më të plotë të tregut në të cilin NOA operon, tre produktet e sipërpërmendura ofrohen nëpërmjet tre kanaleve specifike : online, rrjeti i degëve dhe rrjeti i partneriteteve. Këshillimet tona ofrohen online, nga stafet e degëve tona si dhe nga partnerët e shoqërisë. E njëjta gjë për kreditë të cilat mund të aplikohen nga klientët online, pranë mjediseve fizike të degëve tona por dhe nëpërmjet rrjeteve të partnereve tanë. Po kështu së fundmi për partneritetet: shitjet më këste nga partnerët tanë mund të bëhen direkt online nga faqet e partnerëve, nga oficerët e NOA në terren dhe sigurisht pranë dyqaneve të vetë partnerëve. Së fundmi, gjithmonë brenda konceptit 3x3, gjithçka përshkruar sa më sipër, i ofrohet secilit prej tre segmenteve të klientelës : individëve, bizneseve dhe agro. Ky mbulim në produkte, kanale dhe segmente, i mundëson NOA-s të sigurojë një strategji shitjeje dhe zgjerimi 360' duke u siguruar që është në gjendje të shërbejë ku(r)do klientët e saj.

Në nivel shoqërie, strategjia e NOA-s është që konceptin 3x3 ta jetësojë sipas standardeve më të larta që ofron tregu mikrofinanciar në vend. Kjo nënkupton në rradhë të parë një investim konsistent në aftësitë teknologjike të shoqërisë. Mbrojtja e të dhënave, siguria ndaj sulmeve kibernetike, shpejtësia e aksesimit ne distancë, kapaciteti biometrik etj. janë të gjitha përfitime të cilat rrisin nivelin e shërbimit të ofruar duke e vendosur NOA-n në paravijën e revolucionit digjital financiar. Së dyti, një element thelbësor i shoqërisë janë të mbeturit besnik ndaj vlerave themeluese të aktivitetit historik të NOA-s. Akses në financa por dhe në punësim të barabartë për të gjithë; praktika me impakt pozitiv social, mjedisor dhe ekonomik; edukim dhe komunikim transparent dhe njerëzor më çdo staf dhe klient; dinamizëm dhe pro-aktivitet në shërbimin ndaj klientit por dhe në adresimin e çdo çështjeje administrative brenda shoqërisë etj., këto dhe të tjera janë gjitha vlera të strategjisë së NOA-s për të ruajtur avantazhin krahasues me institucionet e tjera kredidhënëse e bankare në vend. Por jo vetëm, me qëllim rritjen e impaktit në ekonominë e vendit, si një institucion që ka si mision primar zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, NOA ka si pjesë thelbësore të strategjisë së saj dhe rritjen e prezencës institucionale duke u investuar maksimalisht në fuqizimin e zërit të mikrofinancës dhe të NOA-s karshi institucioneve publike, ndërkombëtare dhe të biznesit. Kështu, NOA synon të rrisë aktivitetin e saj institucional si psh: anëtarësime, pjesëmarrjet në forumet e takimet biznesi, dalje mediatike etj., - në nivel kombëtar, rajonal e europian - me qëllim që aksesi në një financë etike dhe cilësore të jetë gjithmonë një e drejtë e pacenuar për çdo klient të NOA-s. Fokusi ndaj impaktit real të çdo kredie të NOA-s është dhe ajo çka na drejton në këtë strategji e cila është dhe do të mbetet simbol i ambicieve të institucionit për të rishpikur instrumentat, por duke mbetur gjithmonë besnik ndaj vetvetes, #ReinventingMicrofinance.

Strategjia 2023-2025

Strategjia për periudhën e ardhshme tre-vjecare, nuk do të ketë ndryshime thelbësore dhe përfaqëson një zgjatim dhe plotësim të strategjisë 2020-2022. Në draftimin e kësaj strategjie janë marrë në konsideratë si rezultatet e kënaqshme të konceptit 3 x 3 ashtu edhe kushtet e ambjentit të jashtëm i cili karakterizohet nga një konkurrencë e fortë mes aktorëve të sektorit. Në prag të finalizimit të dokumentit

	të strategjisë së re të biznesit, për vitet 2023-2025, drejtimi i NOAs ka përcaktuar tashmë shtyllat kryesore mbi të cilat ngrihet kjo strategji afatmesme dhe ato listohen si më poshtë: • **Zgjerimi i target grupeve të klientelës**. Nëse para disa viteve klientela e NOA-s përbëhej kryesisht nga individë dhe biznese të cilët nuk shërbeheshin nga sektori bankar përshkak të kritereve të forta për financime që bankat aplikojnë, përgjatë viteve të fundit NOA zgjodhi të konkurrojë bankat duke synuar edhe një pjesë të klientelës së tyre, kryesisht individë por edhe biznese të vogla. NOA do të vijojë të tërheqë këtë klientelë duke ofruar produkte të shpejta (që kanë kërkesa të ulëta për dokumentacion), duke përdorur kanalet alternative të shitjes dhe mbi të gjitha procedurë të shkurtër vlerësimi të rastit dhe disbursimi. Shërbimi i klientelës në cdo fazë të procesit të kredimarrjes, duke filluar që nga këshillimi para akordimit të kredisë e deri tek asistenca për pjesëmarrjen në skemat e mbështetjes së bujqësisë apo suporti për blerjen e mjeteve specifike bujqësore etj do të vijojë të jetë ndër pikat e forta të shërbimit të NOAs për fitimin e kësaj klientele të re. Përshtatja e produkteve të NOAs me kërkesat dhe nevojat e kategorive të synuara (jo ekzistuese) të klientelës do të jetë në qëndër të planeve afatmesme të NOAs. Kështu, shtimi i "shërbimeve online" , shtimi i produkteve të shpejta të financimit, këshillimi i personalizuar për klientelën, zgjerimi i rrjetit të bashkëpunëtorëve do të jenë disa nga planet taktike të NOAs me synim përmbushjen e objektivit për zgjerimin e target grupeve të klientëve. • **Diversifikimi i vazhdueshëm i kanaleve të shpërndarjes/shitjes dhe dizenjimi i produkteve të reja** që i përgjigjen kërkesave të klientelës dhe tendencës botërore të digjitalizimit të shërbimeve. NOA ka dëshmuar të jetë pararojë e zhvillimeve teknologjike të përqafuara nga sektori financiar në Shqipëri e do të vijojë t'i kushtojë vëmendje maksimale teknologjisë së re me synimin përmirësimin e cilësisë së komunikimit virtual me klientët si dhe shtimin e kanaleve digjitale të komunikimit dhe ndërveprimit me klientët. Shtimi i partnerëve, licencimi i agjentëve, bashkëpunimi me banka dhe institucione të tjera financiare janë disa nga mundësitë e reja që do të vlerësohen me kujdes nga NOA , për të mundësuar rritjen e prezencës së saj ne treg (shtimin e kanaleve të shitjes). Me një ekip të dedikuar për studimin e tregut, nevojave dhe kërkesave të klientelës, NOA do të punojë për pasurimin e gamës së saj të produkteve përgjatë periudhës së ardhshme 3 vjecare. • **Zgjerimi i shërbimeve financiare**. Brenda një periudhe afatmesme (2024) NOA do të zgjerojë gamën e shërbimeve financiare për klientelën e saj. NOA është duke vlerësuar përgatitjen e kuadrit të brendshëm rregullativ si dhe duke ngritur infrastrukturën e nevojshme për ofrimin masiv të shërbimeve të pagesave , transfertave dhe këmbimit valutor. Me këto shërbime shtesë, për të cilat NOA është e licencuar nga Banka e Shqipërisë, sipas licencës Nr 09, datë 06.06.2007, do të mund ti ofrojë klientit një shërbim të gjithanshëm duke plotësuar pjesën më të madhe të nevojave të tij për shërbime financiare.
Pika 5.5	**Pika 5.5 Nëse janë të një rëndësie materiale për veprimtarinë tregtare ose fitimet e emetuesit, informacione përmbledhëse për nivelin e varësisë së emetuesit nga patenta ose licenca, kontrata industriale, tregtare ose financiare, ose procese të reja prodhimi.** <u>Licencat e NOAs</u> NOA ushtron veprimtarinë e saj bazuar në licencat e përfituara nga Autoritetet Mbikëqyrëse, respektivisht Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si më poshte: 1. Licencë Nr. 09, date 06.06.2007 lëshuar nga Banka e Shqipërisë, për të vepruar si Institucion Financiar Jo Bankë dhe për të është truar këto veprimtari financiare të lejuara : a. Të gjitha format e kredidhënies, b. Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave, c. Ofrimi i garancive,

d. Këmbim valutor,
e. Agjent në sigurime,

2. Licencën Nr. 701, datë 27.06.2016, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për veprimtarinë e agjentit në sigurime.

Këto licenca të Emetuesit janë të një rëndësie materiale për ushtrimin e aktivitetit të tij, pasi në rast pezullimi apo revokimi të tyre, NOA nuk do të mund të ushtronte aktivitetin e kredidhënies dhe të tjerat sipas licencave. Pra, **varësia e Emetuesit nga licencat e tij është absolute** pasi veprimtaritë financiare që NOA ushtron mund të ushtrohen vetëm nga subjekte të licencuara dhe që ushtrojnë aktivitetin në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi. Monitorimi i Mbikëqyrësve mbi aktivitetin e subjekteve të licencuara është i vazhdueshëm nëpërmjet raporteve periodike të subjekteve si dhe inspektimeve në ambjentet e ushtrimit të veprimtarisë.

Më poshtë, licencat aktive të NOA sha:

Licenca Nr.09 , datë 06.06.2007, nga Banka e Shqipërisë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

Nr. 09/1 Tiranë më 1.3.2022

LICENCË
Nr. 09, datë 06.06.2007

PËR TË VEPRUAR SI SUBJEKT FINANCIAR JOBANKË
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe të rregullores " Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka" miratuar me vendimin nr. 01, datë 17.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar, Banka e Shqiperise i jep shoqërisë "NOA"[1] sh.a. licencën për të ushtruar veprimtaritë financiare të përshkruara në aneksin bashkëlidhur.

Licenca është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme ose e tjetërsueshme.

Gent SEJKO
GUVERNATOR

Licenca përditësohet me qëllim reflektimin e ndryshimit të emrit të subjektit nga "PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI" sh.a. në "NOA" sh.a.

Licenca Nr. 701, datë 27.06.2016,nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të vepruar si Agjent në Sigurime:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

LICENCË

PËR USHTRIM VEPRIMTARIE AGJENTI NË SIGURIME
Nr.701, datë 27.06.2016

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr.9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të ndryshuar, të Ligjit Nr.52/2014, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", të Rregullores Nr.79, datë 31.08.2015 "Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës" dhe të Vendimit Nr.94, datë 27.06.2016 të Bordit të AMF,

LICENCON

Shoqërinë "NOA" sh.a.

për të ushtruar veprimtari agjenti në sigurime, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA" sh.a., në klasat e jetës.

Licenca është e patransferueshme dhe e patregtueshme.
Licenca është me afat të pacaktuar.

Enkeleda SHEHI

DREJTORI I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

amf ALBANIA

Veprimtaria e agjentit në sigurime ushtrohet nga subjektet e licencuara vetëm nëpërmjet punonjësve të licencuar për të vepruar si agjentë individë në sigurime, ndaj NOA si më datën e hartimit të këtij Prospekti ka 8 punonjës agjentë të licencuar rregullisht nga AMF si "agjent në sigurime" që veprojnë në emër e për llogari të NOAs.

Investitori mund të informohet në vijimësi mbi licencat aktive të Institucionit në:

- Rubrikën "Subjekte të Licencuara-Institucione Financiare Jo Banka", në faqen e Bankës së Shqipërisë(https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/Subjekte_Financiare_jobanka/) .
- Rubrikën "Regjistri i të Licencuarve, Tregu i Sigurimeve, Agjent dhe Broker në Sigurime, Subjekte të tjera Agjent", (https://amf.gov.al/ts_abs_subjekte_agjent.asp?r=5) .

Marrëveshjet/Kontratat e Huave:

Marrëveshjet e huave nga partnerët e saj të huaj dhe vendas, veç e veç nuk kanë rëndësi materiale për vijimësinë e aktivitetit të Institucionit pasi për secilën prej marrëveshjeve mund të gjendet një palë zëvendësuese. NOA tashmë ka një eksperiencë të gjatë me bashkëpunëtorë financues dhe gjithashtu ka kapacitete shumë të mira për të negociuar dhe përfituar financime nga palë të treta.

Megjithatë, nëse vlerësuar së bashku, marrëveshjet e huave, fitojnë rëndësi të madhe për vijimësinë dhe suksesin e aktivitetit të NOAs. Duke qënë se detyrimet për hua/kredi përbëjnë më shumë së 68% të total pasiveve në Bilancin e NOAs, mund të themi se ato janë një faktor i rëndësishëm biznesi pasi mund të ndikojnë drejtëpërsëdrejti në kapacitetet e NOAs për të rritur kreditimin e saj si dhe në kostot e financimit të aktivitetit. Megjithatë, sikurse trajtuar në seksionin " Rreziqet kryesore për Emetuesin", drejtimi i shoqërisë ka marrë të gjitha masat për minimizimin e rrezikut të varësisë nga financuesit.

Certifikata e Markës

Gjithashtu NOA ka të regjstruar markën e saj pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale me numër regjistrimi 20104 sipas Çertifikatës së Markës Nr. 1008/6, datë15.01.2020. Aktiviteti i NOAs nuk ka ndonjë lidhje varësie nga kjo çertifikatë, por kjo e fundit i jep NOAs të drejtën ekskluzive të

	përdorimit të markës së saj , në përputhje me të drejtat e parashikuara nga ligji për Pronësinë Industriale. Regjistri publik i markave të regjistruara mund të aksesohet nga investitorët nëpërmjet linkut: http://regjistriobjektevepi.dppi.gov.al/wopublishsearch/public/trademarks;jsessionid=94F811D3D61B1533EA39C6D39A4EC67E?0&query=OFCO:AL# . <u>Certifikatë e "Vlerësimit Institucional" të NOA sh.a. nga MFR SRL</u> Informacion mbi agjencinë e vlerësimit MFR MFR është një agjenci ndërkombëtare vlerësimi ("rating agency") e specializuar kryesisht në sektorin financiar me mbi 20 vite eksperiencë dhe prezencë në 4 kontinente. E themeluar në vitin 2000 brenda shoqërisë mëmë Microfinanza SRL, MFR u lancua si shoqëri më vete në vitin 2006. MFR ka seli qëndrore në Milano, Itali dhe ofron shërbimet e saj në botë nëpërmjet një rreti zyrash rajonale (Ekuador,Kenia,Republika e Kirgistanit) dhe zyrash shtetesh (Bolivi, Meksikë, Peru, Filipine) duke siguruar një shtirje gjeografike dhe gamë klientele të gjerë. Klientët e MFR janë kryesisht insitucione financiare, investitorë, rregullatorë, kompani që operojnë në fushën e energjisë së rinovueshme dhe rrjete/organizata që punojnë për të siguruar përfshirje financiare (financial inclusion) dhe zhvillim të qëndrueshëm. MFR, krahas vlerësimeve të pavarura të llojit "ratings" , ofron gjithashtu shërbimin e vlerësimeve (due-diligence, consumer protection assessment etj), certifikimeve (çertifikime mbi "Client Protection", "European Code of Good Conduct Evaluation") asistencës teknike, menaxhim dhe krahasimin /" benchmark" të dhënash nëpërmjet platformës së saj ATLAS etj. MFR ofron këto lloj vlerësimesh të llojit "ratings": - "Social Rating"; - "Institutional Rating"; - "Credit Rating"; - "MIV Rating"; - "Islamic Finance Rating". Informacion mbi Vlerësimin Institucional ("Institutional Rating") Vlerësimi Institucional siguron një opinion mbi qëndrueshmërinë afatgjatë të isntitucionit financiar nëpërmjet vlerësimit të kujdesshëm të proceseve të brendshme, kornizës rregullative të administrimit të rreziqeve dhe performancës. Për realizimin e vlerësimit institucional është e nevojshme të përformohet një analizë cilësore dhe sasiore e fushave të listuara më poshtë. Përbri cdo fushe analize është shënuar edhe pesha respektive në gradën finale - Profili financiar i shoqërisë (31%); - Cilësia e portofolit (19%); - Sistemet dhe kontrollet e brendshme (18%); - Qeverisja korporative & strategjitë (28%) ; - Ambjenti/faktorët e jashtëm (4%). Fazat në të cilat kalon procesi i Vlerësimit Institucional listohen si më poshtë. : - Grumbullimi i të dhënave dhe informacionit; - Vizita në vend (Intervistimet dhe validimi i të dhënave); - Draft raporti dhe kontrolli i cilësisë; - Feedback (nga institucioni që po vlerësohet); - Mbledhja e komitetit të vlerësimit dhe marrja e vendimit për gradën e vlerësimit. Grada e Vlerësimit Insitucional të Emetuesit NOA sh.a.

Me përfundimin e procesit të vlerësimit, MFR i ka akorduar Emetuesit NOA sh.a. Certifikatën e Vlerësimit Institucional me gradën "α- high" në Janar të vitit 2023. Kjo Certifikatë ka vlefshmëri 1 vjecare nga momenti i lëshimit të saj.

Gjatë periudhës 2011 – 2023, janë kryer 3 vlerësime institucionale për NOA sha nga e njëjta agjenci, MFR.

Insitucioni	Lloji i Vleresimit	Grada e Vlerësimit	Data
NOA sha	" Institutional Rating"	α- High	Janar 2023
NOA sha	"Microfiance Institutional Rating"	BBB Stable	Janar 2017
NOA sha	"Microfiance Institutional Rating"	BB- Positive	Dhjetor 2011

Vlerësimet janë të publikuara në faqen zyrtare të MFR si vijon:
https://www.mf-rating.com/reports/?sreport=noa

MFR

INSTITUTIONAL RATING

The MFR Rating Committee assigns to

NOA, Albania

Grade: α- High

Good outlook for financial sustainability, which may be affected by a deterioration of the operations or economic conditions. Good fundamentals.

Milan, January 2023

Aldo Moauro
Managing Director

MAKE THE DIFFERENCE WE PROVE IT MFR

Ivan Sannino
Head of Rating Committee

UNLESS EARLIER REVOKED BY MFR OR BY MATERIAL CHANGES THAT AFFECT RATING STATUS, THIS CERTIFICATE IS VALID FOR 12 MONTHS FROM THE DATE OF EMISSION OF THE RATING

Pika 5.6

Pika 5.6 Burimin e çdo deklarate të bërë nga emetuesi për pozicionin e tij konkurrues në treg.

Të gjitha të dhënat që lidhen me pozicionin konkurrues të NOAs në tregun e Institucioneve Financiare Jo Banka, janë marrë ose perllogaritur në bazë të të dhënave të publikuara nga Banka e Shqipërisë (BSH) në dokumentin " Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes 2021" dhe të dhënat financiare të audituara të vetë shoqërisë.

Kështu, kudo në këtë Prospekt ku eshte shprehur për "pjesë/përqindje tregu" kalkulimet janë bërë duke marrë në konsideratë:

- vlerën e treguesit të analizuar (si përshembull Asetet, Portofoli Bruto dhe Neto i Kredise) për total tregun sikurse paraqitur në Raportin Vjetor të Mbikëqyrjes 2021 të BSH;
- vlerën e treguesit, sikurse paraqitur në pasqyrat financiare të audituara.

Pika 5.7	**Pika 5.7 Investimet**
Pika 5.7.1	Pika 5.7.1 Një përshkrim (përfshi vlerën) të investimeve kryesore të emetuesit për çdo vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat historike financiare deri më sot. • Në linjë me strategjinë zhvillimore të biznesit dhe me synimin rritjen e eficencës operacionale dhe të standardeve të menaxhimit dhe komunikimit me klientelën, NOA ka investuar në mënyrë të vazhdueshme në përmirësimin e teknologjive dhe të infrastrukturës së TI - mbështetëse të aktivitetit të saj, duke kryer në mënyrë të vazhdueshme përditësime që sigurojnë qëndrueshmeri dhe akses në të dhëna sipas niveleve më të larta të sigurisë. Vlera totale e investimeve në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit në tre vitet e fundit është 44 milionë Lekë, dhe kryesisht është investuar në përmirësimin e teknologjisë së serverave në cloud, sistemet e sigurisë dhe fireëall, pajisje kompjuterike për stafin (tableta, laptop, desktop, etc) • Investime në zhvillimin e sistemeve dhe aplikacioneve të ndryshme për të siguruar procese shumë të shpejta për klientët, të kontrolluara dhe 100% të automatizuara. Që prej vitit 2015, oficerët e kredisë janë të pajisur me tablet, duke iniciuar përmes tyre aplikimet për kredi për të gjithë segmentet e klientelës. Gjithashtu, është zhvilluar edhe identifikimi dhe autentifikimi i të dhënave të klientëve nëpërmjet bashkeëunimit me ALEAT. Për përmirësimin e vlerësimit të aplikimeve për kredi, janë zhvilluar sistemë të brendshme "scoring" në bashkëpunim me Frankfurt School of Finance, duke shkurtuar vendimarrjen. Investimet në tre vitet e fundit përsa i përket këtij subjekti janë afërsisht në vlerën 33 milionë Lekë. • Investime në përmiresimin e kushteve të punes dhe ambjenteve pritëse për klientët, në përputhje me "brand" identitetin e ri kanë qënë ndër zërat e rëndësishëm të investimeve që prej vitit 2018. Vlera e ketyre Investimeve, përgjatë tre viteve të fundit është rreth 7 milionë Lekë. • Investime në flotën e makinave me qëllim sigurimin e mjeteve të nevojshme të punës, për të gjithë stafin tonë në terren, numri i cilëve ka qënë në rritje të vazhdueshme në vitet e fundit. Vlera e këtyre investimeve, gjatë dy viteve të fundit, arrin në 17,6 milionë Lekë. Më poshtë paraqiten shtesat në aktive fikse të detajuara sipas viteve:

Investimet në mijë Lekë	2022	2021	2020
Pajisje Elektronike	19,142	6,044	18,673
Automjete	7,504	10,123	-
Pajisje dhe mobilje	7,937	2,706	1,703
Permiresime te ambienteve me qera	3,523	2,240	1,375
Programe kompjuterike dhe licensa	1,536	10,420	20,919
Totali i investimeve	**39,642**	**31,533**	**42,670**

Pika 5.7.2	Pika 5.7.2 Një përshkrim të investimeve kryesore të emetuesit, të cilat janë në proces ose për të cilat janë marrë përsipër angazhime, përfshirë shpërndarjen gjeografike të këtyre investimeve dhe mënyrën e financimit. • Shoqeria ka investuar ne depozita në monedhën Euro ne bankat lokale në vleren ekuivalente ne Lekë prej 2,7 miliardë Lekësh. Keto depozita jane te vendosura si kolateral per overdraftet ne Lekë te financuara nga bankat lokale dhe jane paraqitur ne pasqyra financiare neto nga vlera e overdraftit (105,6 milionë Lekë si më 31.12.2022). • Për vitin 2023, NOA ka planifikuar investime afatgjata në vlerën 89 milionë Lekë nga te cilat 42 milionë Lekë janë investime në software dhe aplikacione të ndryshme, 15 milionë Lekë në investime në Hardware dhe 32 milionë Lekë në përmirësime të ambjenteve të punës dhe flotës së makinave. • Gjatë vitit 2022 NOA ka filluar procesin e perditesimit te sistemit SASPO, i cili permban te gjithe modulet e ciklit te kredidhenies duke filluar nga procesi i aplikimit te kredise deri në aprovim të

	kredise dhe firmosje te kontrates me klientin, moduli i manaxhimit te klienteve sipas nje rankimi te brendshem,moduli i ndjekjes se kredive ne vonese apo te fshira.
Pika 5.7.3	**Pika 5.7.3 Informacion në lidhje me sipërmarrjet e përbashkëta dhe shoqëritë ku emetuesi zotëron një pjesëmarrje të tillë në kapital.** Më 10 Tetor 2022, aksionarët e NOA-s vendosën të themelojnë një institucion financiar jobankar që operon në Kosovë duke investuar 60% të kapitalit të shoqerisë së re. Shoqëria është e regjistruar në Agjensinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë me numër unik identifikues 811987968 me emrin I.F.J.B NOA Sh.A. me seli në adresen Rr.Anton Cetta 5A, Prishtine, Kosove dhe kapital total 500,000 Euro. Aksionet (e nënshkruara dhe paguara) në zotërim të NOA sha janë në vlerën 300,000 Euro, ekuivalenti në Lekë 35,031 mijë. Filiali ka marrë licencën nga Banka Qendrore e Kosovës si Institucion Financiar Jo Bankar më 27 shkurt 2023, me numër IFJB/084.
Pika 5.7.4	**Pika 5.7.4 Një përshkrim i çdo problemi mjedisor, që mund të ndikojë në përdorimin që u bën emetuesi aktiveve afatgjata materiale.** Aktivitet afatgjata materiale të NOAs si më 31.12.2022 janë vetëm pasuritë e paluajtshme të përshtatura dhe përdorura si ambjente pune për stafin e shoqërisë, automjetet, pajisjet "data processing" ejt. Theksuar sa më sipër, nuk ka ndonjë problem mjedisor që të mund të ndikojë në mënyrën e përdorimit të këtyre aseteve. Gjithsesi me vlerë është të theksohet se NOA dhe stafi i saj është kujdesur për zbatimin e parimeve të ruajtjes dhe përdorimit eficient të energjisë gjatë shfrytëzimit/përdorimit të aktiveve të saj. Referuar çështjes së mjedisit dhe ndjeshmërisë së institucionit tonë ndaj mbrojtjes së tij, NOA ka vendosur të zbatojë politikat në favor të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit edhe gjatë aktivitetit të saj të kredidhënies. Kështu, NOA nuk financon aktivitete të cilat janë në konflikt me parimet e ruajtjes dhe mirembajtjes së shëndetit & mjedisit në komunitetin ku vepron. Në zbatim të këtyre politikave, në cdo rast të aplikimit për kredi, NOA vlerëson: - Nëse aktiviteti është i përfshirë në industritë e ndaluara për tu financuar sipas politikës së saj të Riskut dhe mbrojtjes së shëndetit & mjedisit; - Vlereson nivelin e Riskut mjedisor, shëndetesor dhe social. Në përputhje me direktivat dhe rregulloret e Ministrisë së Mjedisit , Komunitetit European dhe investitorëve(financuesve) të saj, NOA nuk financon asnjë subjekt I cili lidhet me aktivitete që kanë një impakt negativ shëndetsor, shoqëror dhe mjedisor.

RUBRIKA 6 --STRUKTURA ORGANIZATIVE

Pika 6.1	**Pika 6.1 Nëse emetuesi është pjesë e një grupi duhet të jepet një përshkrim i shkurtër i grupit dhe i pozicionit të emetuesit brenda grupit** NOA sh.a. është një shoqëri e kontrolluar nga subjekte të specializuara në fushën e shërbimeve financiare dhe të cilat kanë eksperiencë të gjatë në sektorin financiar në tregje të ndryshme në zhvillim, në disa kontinente. NOA Holdings NV, aksionare e 99.9986% e kapitalit aksionar të NOA sha , është një shoqëri aksionare me një staf të vogël udhëheqës dhe të kualifikuar të cilët punojnë ngushtë dhe në mënyrë aktive me skuadrën lokale të menaxhimit të NOA sha me qëlim ofrimin e mbështetjes së nevojshme për një rritje të vazhdueshme të biznesit dhe përmbushjen e objektivave të shoqërisë. BFSE Holding BV dhe Creation Investment Social Ventures Fund, shoqëritë që zotërojnë NOA Cooperatief U.A (aksionare e Noa Holdings B.V) janë shoqëri të specializuara në menaxhimin e

investimeve private dhe administrimin e kapitaleve private në industrinë e shërbimeve financiare, në vende të ndryshme. Në saj të njohurive të thella dhe eksperiencës së gjerë në fushën e sektorit bankar e financiar, këto shoqëri marrin vendime për investime në subjekte (që operojnë në industrinë e sherbimeve financiare) me potencial të lartë zhvillimi, ekzekutimin e strategjive të blerjeve-bashkimeve , financimin nëpërmjet huave të instucioneve mikrofinanciare dhe bizneseve të vogla me qëllim krijimin e një impakti pozitiv në ekonomitë lokale.

Më poshtë, struktura e pronësisë së NOA-s deri në nivelin e aksionarëve të tërthortë të linjës së parë. (struktura e plotë paraqitet në Kreu I, Rubrika 2, Pika 1.3). Aksionarët e paraqitur në skemën e mëposhtme ofrojnë "know-how]" e tyre për të mbështetur vendimet e biznesit të NOA sha.



Pika 6.2

Pika 6.2 Një listë e shoqërive të kontrolluara më të rëndësishme

NOA sha zotëron 60% pjesëmarrje në Institucionin Financiar Jo Bankë në Kosovë I.F.J.B NOA sh.a me adrese Rruga Anton Ceta, Prishtine, Kosove me numer unik 811987968. Data e rregjistrimit te shoqerise është 18 Nentor 2022. Shoqeria I.F.J.B NOA ka marrë licencën nga Banka Qendrore e Kosovës si Institucion Financiar Jo Bankar më 27 shkurt 2023, me numër IFJB/084.

		31 Dhjetor 2022
Filiali	Shuma (mijë Lekë)	% ne aksione
I.F.J.B NOA sh.a Kosova	35,031	60%

Pika 7.1

Pika 7.1 Gjendja financiare

Emetuesi, NOA sh.a, gëzon një gjendje financiare të shëndoshë dhe solide e cila është premtuese për një të ardhme akoma më të suksesshme. Më poshtë, paraqitet Pasqyra Individuale e Bilancit (Pozicionit Financiar) të shoqërisë për vitet 2020-2022:

BILANCI [8] *(shifrat në "mijë Lekë")*	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
AKTIVET			
Mjete monetare	608,744	451,896	354,295
Kredi për institucionet financiare	105,563	167,175	338,167
Kredi dhe paradhënie për klientët	6,913,435	5,751,651	5,082,474
Inventar dhe asete te tjera	90,488	66,530	46,887
Aktive afatgjata materiale	184,017	191,426	182,873
Aktive afatgjata jomateriale	18,329	26,140	23,973
Investime në Filial	35,031		
Aktive tatimore të shtyra	24,644	20,705	23,003
Totali i Aktiveve	**7,980,252**	**6,675,523**	**6,051,672**
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrimet			
Detyrime tatimore	16,915	6,571	7,521
Detyrime të tjera	239,009	231,837	238,192
Huamarrje	5,605,951	4,561,472	4,252,620
Totali i Detyrimeve	**5,861,875**	**4,799,880**	**4,498,333**
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	731,838	731,838	731,838
Rezerva ligjore	73,184	64,027	50,067
Fitimi i pashpërndarë	1,313,355	1,079,778	771,434
Totali i Kapitalit	**2,118,377**	**1,875,643**	**1,553,339**
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit	**7,980,252**	**6,675,523**	**6,051,672**

Sikurse të dhënat financiare të mësipërme tregojnë, ecuria financiare e NOA sha ka qënë shumë e mirë dhe në përmirësim të vazhdueshëm gjatë periudhës në shqyrtim.

Më poshtë , nja analizë e shpejtë e Aseteve, Detyrimeve dhe Kapitalit të NOAs si më 31.12.2022:

Asetet



[8] Pasqyrë Individuale e Pozicionit Financiar

Në linjë me sa deklaruar mbi aktivitetin primar të NOA sh.a., aseti më i rëndësishëm i shoqërisë është **portofoli i kredive të klientëvë të saj, i cili ze një peshë prej rreth 87% të totalit të aseteve** dhe ka një vlerë neto rreth 6,9 miliardë Lekësh si më 31 Dhjetor 2022. Portofoli i kredisë së NOA sh.a. është financuar/krijuar përmes fondeve të përfituara nga kredi dhe linja të huave që NOA sh.a ka marrë nga institucione financiare ndërkombëtare ndër vite. Partnerë të huaj kanë financuar dhe rifinancuar NOA sh.a ndër vite pasi institucioni ka qënë dhe është në përmbushje të kushteve të vendosura prej tyre,- kushte të cilat lidhen kryesisht me cilësinë e portofolit të kredisë si dhe me tregues (/indikatorë) të tjerë që dëshmojnë nivelin e shëndetit financiar të Institucionit.

Asetet e tjera të NOA sh.a. zenë vetëm 13,4% të totalit të aseteve dhe kryesisht janë asete në funksion të aktivitetit primar, kredidhënies, të tilla si :

- "Paraja dhe Ekuivalentët e saj" të cilat zenë rreth 7,6% të totalit të aseteve ose rreth 609 milionë Lekë si më 31 Dhjetor 2022. Këto vlera monetare shërbejnë për kreditimet e reja të klientelës si dhe për shlyerjen e të gjitha detyrimeve afatshkurtra të shoqërisë. Njësia e Thesarit menaxhon me kujdes likuiditetet e shoqërisë në mënyrë që te garantojë shlyerjen e detyrimeve, disbursimet e shpejta të kredive të miratuara nga komiteti i kredisë dhe maksimizimin e fitimit të shoqërisë në saj investimeve afatshkurtra të likuiditeteve përkohësisht të lira.
- Aktivet afatgjata materiale të shoqërisë zenë 2,3% të aseteve totale ose rreth 184 milionë Lekë si më 31 Dhjetor 2022. Ndërtesat në përdorim të shoqërisë, pajisjet e procesimit të të dhënave si dhe automjetet (në pronësi dhe ato në posedim të shoqërisë), janë elementët më të rëndësishëm të kësaj kategorie asetesh.
- Teprica (si pasojë e netimit) e depozitave në monedhën Euro të vendosura "cash-kolateral"për financimet në formën e overdrafteve në monedhën Lekë në bankat e nivelit të dytë me një vlerë rreth 106 milionë Lekë dhe që përbëjnë 1,3% të total aseteve. Vlera totale e ovërdrafteve në monedhën Lekë si më 31 Dhjetor 2022 ishte rreth 2.57 miliardë Lekë. Kolateral për këto financime nga bankat lokale shërbyen rreth 2,68 miliardë Lekë depozita në monedhën Euro.

Detyrimet dhe Kapitali



Zëri më i rëndësishëm i Detyrimeve në Bilancin e shoqërisë është ai i Huave/Borxhit nga palët e treta. NOA sh.a është financuar nga institucione ndërkombëtare me terma financiarë preferenciale si dhe nga banka lokale që ushtrojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.

Si më 31 Dhjetor 2022, balanca e kredive të marra nga Institucionet e huaja (të cilat janë kryesisht në monedhën Euro: 93% e tyre janë në Euro) arrin në një total prej 4,55 miliardë Lekësh (kundërvlera në Lekë e borxhit në Euro) dhe ze 81 % të totalit të kredive të marra nga NOA. Financimi në Euro i shoqërisë është realizuar përkundrejt normave fikse të interesit. Interesi mesatar i ponderuar për borxhin në Euro të shoqërisë është 4,62% në vit. Kreditë e marra në Lekë nga Institucionet e huaja janë në total rreth 336

milionë Lekë. Duke qënë se pjesa më e madhe e kredive që NOA akordon klientëve është në monedhë lokale, shoqëria ka aplikuar mekanizmin e mbrojtjes nga luhatja e kursit të këmbimit duke investuar fondet e huazuara në monedhën Euro në formën e depoziteve me afat ose titujve e në vijim duke i vendosur ato kolateral për t'u kredituar nga bankat lokale në lekë.

Kreditë e marra nga Bankat lokale, të cilat janë në monedhën Lekë, janë në vlerën e prej rreth 1,06 miliardë Lekësh si më 31 Dhjetor 2022 dhe zenë rreth 19% të totalit të kredive të marra nga NOA sh.a. Financimi në Lekë i shoqërisë është realizuar kryesisht përkundrejt normave variabël të interesit (78% e borxhit në Lekë ka regjim interesi variabël). Interesi mesatar i ponderuar për borxhin në Lekë të shoqërisë është 6.9% në vit.

Si më 31 Dhjetor 2022, NOA sh.a ka aktive kontrata financimi me Institucionet financiare kombëtare dhe ndërkombëtare: Banka Kombëtare Tregtare, Tirana Bank, Union Bank, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bank im Bistum Essen, Black Sea Trade & Development Bank, BlueOrchard, Developing World Markets , Frankfurt School of Financial Services, Symbiotics SA dhe Tripple Jump B.V.

Kapitali i shoqërisë, si më 31 Dhjetor 2022, ishte 2,12 miliardë Lekë. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë, me vlerë rreth 732 milionë Lekë përbëhet nga 73.183 aksione (plotësisht të shlyera) me vlerë nominale 10.000,12 Lekë për aksion. Aksionet i përkasin kategorisë së aksioneve të zakonshme dhe me të drejtë vote.

Zërat e tjerë të kapitalit, rezervat ligjore dhe fitimi i pashpërndarë , arritën përkatësisht vlerat e 73 milionë Lekëve dhe 1,31 miliardë Lekëve.

Pika 7.1.1

Pika 7.1.1 Një vlerësimi drejtë i zhvillimit dhe rezultateve të aktivitetit tregtar të emetuesit dhe gjendjes së tij financiare për çdo vit dhe për periudhat e ndërmjetme, për të cilat kërkohen të dhëna historike financiare, përfshi shkaqet e ndryshimeve kryesore

Më poshtë, paraqiten treguesit më të rëndësishëm të performancës financiare të Emetuesit për vitet e marra në shqyrtim (2020-2022).

Treguesit Kryesorë të Performancës Financiare	2022	2021	2020
% e Rritjes së Aseteve	20%	10%	4%
% e Rritjes së Detyrimeve	22%	7%	-1%
% e Rritjes së Total Kapitalit	13%	21%	22%
% e Rritjes së Portofolit Neto	20%	13%	8%
% e Rritjes së Portofolit Bruto	20%	14%	6%
Portofol Kredie Neto /Asete	87%	86%	84%
Raporti i Kapitalizimit (Kapitali/Gjendje portofoli)	31%	33%	31%
Kthimi nga Aktivet (ROA)	5%	5%	5%
Kthimi nga Kapitali (ROE)	20%	19%	20%
Raporti Aktive / Kapital	3.8	3.6	3.9
Raporti i Levës Financiare	2.8	2.6	2.9
Kapitali / Aksion (mijë Lekë)	28.95	25.6	21.2
Fitimi për Aksion (mijë Lekë)	5.5	4.4	3.8
Numri i Aksioneve	73,183	73,183	73,183
Vlera e dividentit të pagauar (mijë Lekë)	156,538	-	-

Normat e rritjes së biznesit të NOA, si të aseteve, kapitalit ashtu edhe portofolit të kredisë, janë të kënaqshme dhe evidentojnë ecurinë pozitive të aktivitetit.

Treguesit e strukturës së aseteve dhe pasiveve të shoqërisë dëshmojnë përdorimin e mirë të levës financiare (borxhi ndaj kapitalit) për krijimin e asetit më të rëndësishëm të Emetuesit, portofolit të kredisë i cili përben 87% të aktiveve të tij.

Treguesit e përfitueshmërisë nga ana tjetër (ROA, ROE, Fitimi për aksion) , jo vetëm japin një pamje të qartë mbi rezultatet pozitive financiare të institucionit ndër vite por gjithashtu, nëse krahasuar me vlerat e tregut[9], dëshmojnë edhe mirëpozicionim e NOAs ndaj tregut në aspektin e përfitueshmërisë.

Pika 7.1.2

Pika 7.1.2 Përshkrim i aktiviteteve të Emetuesit në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit.

Në përputhje me natyrën e biznesit, NOA sha nuk zhvillon aktivitete në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit.

Pika 7.2

Pika 7.2 Rezultatet e Aktivitetit

Rezultatet e aktivitetit të NOAs kanë qënë ndër vite pozitive dhe në vlera të kënaqshme.Më poshtë paraqitet Pasqyra Individuale e Fitim-Humbjes së Emetuesit, për vitet 2020-2022.

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET[10] *(në mijë Lekë)*	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Të ardhura nga interesi	1,479,629	1,278,642	1,176,234
Shpenzime interesi	-336,396	-297,333	-286,430
Të ardhura neto nga interesi	**1,143,233**	**981,309**	**889,804**
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	103,047	92,247	70,811
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet	-2,276	-2,141	-2,044
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	**100,770**	**90,106**	**68,767**
Rikuperimet nga kreditë e fshira	94,185	127,839	97,003
Të ardhura të tjera	13,288	9,746	62,072
Te ardhura operacionale neto	**1,351,477**	**1,209,000**	**1,117,646**
Shpenzime personeli	-423,588	-375,668	-346,893
Shpenzime të tjera	-187,652	-187,545	-166,350
Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhëniet për klientët	-196,047	-188,615	-209,321
Amortizimi i pajisjeve	-70,910	-62,902	-59,296
Zhvlerësimi i aktiveve jomateriale	-9,348	-8,253	-2,987
Fitim/ (humbje) nga kursi i këmbimit	8,160	2,075	-1,980
Totali i shpenzimeve	**-879,384**	**-820,908**	**-786,827**
Fitimi para tatimit	**472,092**	**388,092**	**330,819**
Tatimi mbi fitimin	-72,821	-65,788	-51,620
Fitimi i Vitit	**399,271**	**322,304**	**279,199**

Zëri më i rëndësishëm i të ardhurave të shoqërisë natyrisht është ai i të ardhurave nga interesi i portofolit të kredive. Në linjë me dinamikën pozitive, në rritje, të madhësisë së portofolit të kredive, të ardhurat nga interesi kanë njohur një rritje të vazhdueshme duke shënuar vlerën më të lartë historike prej rreth 1,48 miliardë Lekë në fund të vitit 2022.

[9] Kreu I, Rubrika 5, pika 5.2

[10] Pasqyra Individuale e Fitimit soe Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse

Përveç, të ardhurave nga interesi, burimi tjetër i të ardhurave të shoqërisë janë "komisionet dhe tarifat". Përgjatë vitit 2022 janë njohur rreth 103 milionë Lekë të ardhura nga komisionet, prej të cilave 92 milionë Lekë kanë qënë komisione të fituara nga shoqëritë e sigurimit për ndërmjetësimin e siguracioneve të kredimarrësve dhe 11 milionë Lekë komisione administrimi të kredive.

Përsa i përket shpenzimeve të shoqërisë, shpenzimet për personelin si dhe shpenzimet për interesat e financimit të shoqërisë nga palët e treta përbëjnë zërat me peshën më të madhe në rradhën e shpenzimeve të shoqërisë. Shpenzimet për interesat e huamarrjeve (dhe mjeteve të marra me qira financiare) arriten vlerën e rreth 336 milionë Lekë në fund të vitit 2022. Nga ana tjetër shpenzimet për personelin, prej rreth 424 milionë Lekësh, shënuan një rritje prej 13% krahasuar me vitin paraardhës si pasojë e rritjes së numrit të personelit me rreth 10%.

Seksionin mbi rezultatet e aktivitetit, e përmbyllim duke sjellë në vëmendje të publikut faktet e mëposhtme të cilat dëshmojnë dhe përshkruajnë më së miri situatën financiare të shoqërisë:

- NOA ka rezultuar me fitim, cdo vit financiar përgjatë gjithë 11 viteve të fundit;
- Fitimi i NOAs ka ardhur në rritje të vazhdueshme e të ndjeshme prej vitit 2014 e në vijim;
- Fitimi mesatar i 10 viteve të fundit rezulton rreth 200 milionë Lekë (ose rreth 1,7 milionë Euro);
- Fitimi mesatar i 5 viteve të fundit rezulton rreth 290 milionë Lekë (ose rreth 2,5 milionë Euro);
- Fitimi mesatar i 3 viteve të fundit është rreth 336 milionë Lekë (ose rreth 2,9 milionë Euro);
- Fitimi i vitit të fundit, 2022, është 399 milionë Lekë (ose rreth 3,48 milionë Euro).

Përmirësimi i vazhdueshëm i përformancës financiare të institucionit, edhe në kushtet e konkurrencës së fortë mes institucioneve kredidhënëse Jo-Banka, dëshmon menaxhimin e suksesshëm të aktivitetit nga ekipi drejtues profesionist dhe vizionar i NOA-s.



Grafiku i mësipërm, paraqet ecurinë e të ardhurave dhe shpenzime nga interesi, totalin e shpenzimeve të tjera (administrative, paga, zhvleresime dhe amortizime) dhe fitimit neto të shoqërisë.

Pika 7.2.1	Pika 7.2.1 Informacio n mbi faktorët që ndikojnë në mënyrë thelbësore në të ardhurat e emetuesit, duke përcaktuar masën me të cilën preken të ardhurat.

Të ardhurat nga aktiviteti ndikohen nga një sërë faktorësh të brendshëm e të jashtëm. Më poshtë paraqesim një listë të faktorëve që kanë ose mund të kenë ndikim të rëndësishëm mbi të ardhurat e NOA-s.

- **Niveli i kërkesës për kredi** është faktori më i rëndësishëm, i cili jo vetëm është përcaktues i nivelit të të ardhurave të institucionit por gjithashtu është thelbësor për ekzistencën dhe rrjedhën e biznesit të NOAs. Në kushtet që kredidhënia është veprimtaria kryesore e NOAs, faktori "kërkesë për kredi" është parakushti për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të biznesit nga NOA. Rritja e kërkesës për kredi, në kushtet e mirëpozicionimit të NOAs në treg, do të sillte rritje të "shitjeve" të saj e si pasojë rritje të të ardhurave të shoqërisë. E kundërta është gjithashtu e vërtetë; rënia e kërkesës për kredi do të reflektohej edhe në kërkesën për produktet e financimit të ofruara nga NOA. Kërkesa për kredi në nivel kombëtar është e lidhur ngushtë me kushtet makro-ekonomike të vendit, në mënyrë të vecantë me rritjen ekonomike (Prodhimit të Brendshëm Bruto (GDP)) dhe nivelin e inflacionit. Gjatë vitit 2022 ekonomia Shqiptare filloi të përjetojë pasojat e rritjes së cmimeve ndërkombëtare të energjisë dhe ngadalësimit ekonomik në Evropë , manifestuar këto nëpërmjet rritjes së shpejtë të inflacionit përtej normës objektiv prej 3% (siç vendosur nga Banka e Shqipërisë me qëllimin e arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të cmimeve). Në përgjigje të kësaj situate, Banka e Shqipërisë vendosi të ndryshojë drejtimin e politikës monetare, duke rritur pesë herë brenda vitit 2022 normën bazë të interesit, si një masë e domosdoshme për frenimin e rritjes dhe më pas zbutjen e inflacionit. Sipas parashikimeve më të fundit të Bankës së Shqipërisë (deri më datën e këtij Prospekti), inflacioni pritet të reduktohet progresivisht gjatë vitit 2023, ndikuar nga rënia e presioneve në tregjet e huaja dhe normalizimi i qëndrimit të politikës monetare,dhe të kthehet në objektiv në mesin e vitit 2024. Gjithashtu Banka e Shqipërisë parashikon se pavarësisht sfidave me të cilat po përballen individet, operatorët sektorit privat e publik, ekonomia shqiptare do të vazhdojë të rritet.
  Niveli lartë i inflacionit dhe kujdesi i shtuar i institucioneve financuese/kredidhënëse te huaja e vendase, nuk kanë ndikuar aktivitetin kreditues të NOA-s. Gjatë vitit 2022 NOA shënoi vlerën rekord të disbursimeve dhe siguroi një rritje portofoli të kredisë (neto dhe bruto) prej 20% krahasuar me vitin 2021.
  Gjithsesi, në bazë të analizave të ndjeshmërisë që Departamenti i Riskut & Përputhshmërisë realizon, një ulje e mundshme e kërkesës për kredi në masën 10% do të provokonte një rënie të nivelit të disbursimeve më të njëjtin volum dhe do të tkurrte portofolin e kredisë me 6%. Gjatë përllogaritjeve, NOA ka konsideruar rënien e volumit të disbursimeve për secilin segment klientele në masën 10%, pa ndryshuar përqindet /peshat e disbursimeve për secilin segment. Impakti në të ardhurat e institucionit do të ishte ulje me 3-5.5%.

- **"Cmimi"** i financimeve që ofron NOA ose **Marzhi i Fitimit**. Sa më i lartë "marzhi i fitimit"nga financimi i klientëve aq më të larta do të jenë të ardhurat e institucionit. Interesat e kredive të NOAs përcaktohen në bazë të një metodologjie të brendshme e cila merr në konsideratë elementë të ndryshëm si koston e fondeve, të ardhurat nga komisionet e lidhura me kredinë, koston e angazhimit të stafit shitës dhe atë të vlerësimit të riskut si dhe interesat e tregut. Duke qënë se konkurrenca në tregun e institucionve financiare jo banka që japin kredi dhe mikrokredi është e lartë interesat që ofrohen nga institucione të krahasueshme me njëra tjetrën tentojnë të jenë të ngjashme me njëra -tjetrën, niveli i kostove është ai që përcakton në një masë të madhe marzhin e fitimit. Nese gjate vitit 2023 do te kishim nje reduktim te cmimit te kredise me 5% per te gjitha segmentet /produktet e kredise njesoj te

ardhurat nga interesi do te impaktoheshin me te njejten % dhe në vlerë afërsisht 97 milionë Lekë.

Menaxhimi i kujdesshëm i burimeve dhe kostove të lidhura me to është detyrë primare e ekipit drejtues të NOAs me qëllim ruajtjen e një niveli të kënaqshëm marzhi fitimi dhe njëkohësisht tarifimit të kredive me norma interesi të pranueshme dhe jo më të larta se mesatarja e tregut. Gjetja e financimeve me interesa preferencialë nga NOA, manaxhimin e kostos per mbrojtjen nga rreziku i kursit të këmbimit me kosto sa më të ulët dhe arritja e eficencës së punës së stafit të angazhuar në procesin e kredisë janë objektiva të vazhdueshëm të NOAs , me qëllim mbajtjen nën kontroll të kostove dhe maksimizimin e fitimit. Nese gjate vitit 2023 do te kishim nje rritje te normes se interesit me 2 deri ne 2.5 pike perqindje mbi normen aktuale shpenzimet e interesit do te rriteshin me nje vlere 130 milionë Lekë .

Pika 7.2.2

Pika 7.2.2 Kur të dhënat financiare historike paraqesin ndryshime thelbësore në të ardhurat ose shitjet neto, bëni një argumentim përshkrues të arsyeve për këto ndryshime

Treguesit kryesorë financiarë të NOAs (asete, portofol, detyrime për kredi, të ardhura e shpenzime) kanë ardhur në rritje të vazhdueshme por brenda intervaleve normale të diktuara nga rezultatet pozitive të aktivitetit. Pra, nuk ka patur ndryshime drastike në treguesit financiarë që mund të lidheshin me vendimarrje apo ndryshime radikale të rrjedhës së biznesit.

Norma më të mëdha rritje të aseteve dhe detyrimeve vihen re në vitet në të cilat janë përfituar financime të reja nga NOA, sic ishte edhe viti 2022. Gjatë 2022, portofoli i kredisë u rrit me 20% dhe detyrimet për hua me 23%. Ndërkohë zeri i kapitalit është rritur me rreth 20% cdo vit përgjatë periudhës 3-vjecare 2021-2019, si pasojë e kontabilizimit/njohjes së fitimit ushtrimor si fitim i pashpërndarë dhe vendimeve të asamblesë për mos shpërndarje divitenti gjatë 2021 dhe 2020. Në vitin 2022, Asambleja e aksionarëve vendosi shpërndarjen e rreth 156 milionë Lekë në formë dividendi për aksionarët.

Ndryshimi i zërave kryesorë	Ndryshimi %2022-2021	Ndryshimi %2021-2020	Ndryshimi %2020-2019
% e Rritjes së Aseteve	19.5%	10.30%	4.30%
% e Rritjes së Portofolit Neto	20.2%	13.20%	8.00%
% e Rritjes së Huamarrjeve (Detyrime per Kredi)	22.9%	7.30%	0.20%
% e Rritjes/zvogëlimit të Detyrimeve	22.1%	6.70%	-0.60%
% e Rritjes së Total Kapitalit	12.9%	20.70%	21.90%

RUBRIKA 8 - BURIMET E FINANCIMIT

Pika 8.1	Pika 8.1 Informacion për burimet e kapitalit të emetuesit NOA sha financon aktivitetin e saj nëpërmjet huave të marra nga palë të treta si dhe kapitalit të aksionarëve.



Nga pikëpamja e menaxhimit financiar të Institucionit, NOA ka shfrytëzuar një nivel relativisht të kënaqshëm të levës financiare i cili përfaqësohet nga një raport Detyrime ndaj Kapitalit prej 2,8 herë (që do të thotë detyrimet janë 2,8 herë më të mëdha se kapitali i shoqërisë, si më 31 Dhejtor 2022. Mesatarja e raportit Detyrime-Kapital për Institucionet Mikrofinanciare në Evropë është 4,2% (2019)[11] .

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë , prej vitit 2013 është në nivelin e rreth 732 milionë Lekëve. Deri në datën e këtij Prospekti, asambleja e përgjithshme e aksionarëve nuk ka planifikuar ndonjë emetim aksionesh të reja apo ndonje operacion tjetër të lidhur me aksionet e shoqërisë. Duke qënë se zëri "Kapital" është më pak dinamik se sa "financimet nga të tretët" dhe ze një peshë më të vogël se huatë e institucionit, analiza e këtij seksioni i dedikohet financimeve nga të tretët.

- **Struktura e financimit të biznesit sipas origjinës së financuesit**

Partnerët financues të NOAs, kanë qënë dhe vijojnë të jenë kryesisht institucione të huaja financiare dhe më pak banka lokale që operojnë në Shqipëri.

Borxhi nga partnerët e huaj përgjithësisht është: i denominuar në Euro, me interesa fikse dhe i pa-garantuar.

Borxhi nga bankat lokale përgjithësisht është: i denominuar në Lekë, kryesisht me interes variabël dhe i garantuar (me depozite, portofol kredie ose garanci nga palë të treta).

Si më 31.12.2022

	Financues të Huaj	Banka/Institucione Lokale	Total
Detyrime për Kredi (mijë Lekë)	4,549,745	1,056,205	5,605,951

Si më 31.03.2023

	Financues të Huaj	Banka/Institucione Lokale	Total
Detyrime për Kredi (mijë Lekë)	4,694,974	1,108,654	5,803,628

Huamarrja nga Bankat lokale ka qënë domosdoshmëri për të evituar ekspozimin ndaj kursit të këmbimit[12] (mqs financimet nga partnerët e huaj janë në monedhën Euro ndërsa kreditimi i klientelës realizohet kryesisht në Lekë). Në rast se financimet e huaja do të mund të kishin qënë në monedhën Lekë, NOA nuk do të kishte hyrë në të gjtha marrëveshjet e financimit që ka nënshkruar me bankat lokale. Huamarrja nga bankat lokale, për nevoja likuiditeti, përfaqëson vetëm 19% të këtyre huave; pjesa tjetër e marrëveshjeve janë në kuadër të mekanizmit të mbrojtjes nga luhatja e kursit të këmbimit. Përgjithësisht, ato financime nga bankat lokale që janë marrë për nevoja likuiditetesh janë marrë kundrejt kolateralit "portofol kredie i klientëve të NOAs"ose garanci nga palë të treta. Raporti i mbulimit me këtë lloj kolaterali është rreth 110-130%.

Pra, në mbyllje te vitit 2022 si dhe në mbyllje të tremujorit të parë të vitit 2023, 81 % e financimeve të NOAs vijnë nga financues të huaj ndërsa pjesa tjetër, 19% e totalit të kredive, janë përfituar nga bankat lokale.

- **Struktura e financimit të biznesit sipas afatit të shlyerjes**

11 Microfinance in Europe: Survey Report 2020 edition nga Justyna Pytkowska.

[12] NOA financohet në Euro nga partnerët e huaj; I angazhon këto fonde në formën e depozitave me afat në bankat lokale ose investime në tituj të denominuar në Euro; Më pas financohet nga bankat locale në Lekë kundrejt kolateralit "depozitë në euro/tituj".

Ndërkohë që financimi nga aksionarët është afatgjatë, detyrimet për hua kanë maturitete kryesisht afatshkurtra deri në afatmesme. Kështu, struktura e borxhit të shoqërisë , sipas afatit të shlyerjes, paraqitet si vijon:

Si më 31.12.2022

	Maturitet -3 muaj	Maturitet 3-12 muaj	Maturitet 1-5 vite	Total
Detyrime për Kredi në mijë Lekë	355,233	1,706,396	4,078,109	6,139,738

Afati mesatar i kredive të institucionit është 36 muaj. Kreditë janë të pagueshme kryesisht në këste mujore për kredidhënësit lokalë dhe me këste periodike ose me një pagesë të vetme të principalit për kredidhënësit e huaj. Si më 31 Dhjetor 2022, principali i pagueshëm brenda 12 muajve është 1,77 miliardë Lekë ose 32 % e totalit të detyrimeve për hua.

- Struktura e financimit të biznesit sipas monedhës

Nëse analizuar sipas monedhës, borxhi i denominuar në valutën Euro është mbizotërues në Bilancin e Emetuesit. Struktura e borxhit sipas monedhës, paraqitet si më poshtë:

Si më 31.12.2022

	Lekë	Euro	Total
Detyrime për Kredi në mijë Lekë	1,392,322	4,213,629	5,605,951

Si më 31.03.2023

	Lekë	Euro	Total
Detyrime për Kredi në mijë Lekë	1,441,846	4,361,782	5,803,628

- Struktura e financimit të biznesit sipas llojit të interesit

Nëse analizuar sipas interesit të pagueshëm të kredive, në strukturën e borxhit të shoqërisë mbizotërojnë marrëveshjet e huave me interes fiks- të pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së kredive.

Si më 31.12.2022	Interes FIKS		Interes VARIABËL		
mijë Lekë	Lekë	Euro	Lekë	Euro	Total
Detyrime për Kredi	306,647	4,216,419	1,082,886	-	5,605,951

Si më 31.03.2023	Interes FIKS		Interes VARIABËL		
mijë Lekë	Lekë	Euro	Lekë	Euro	Total
Detyrime për Kredi	277,718	4,361,782	1,164,128	-	5,803,628

Marrëveshjet me intetres fiks janë përgjithësisht ato të lidhura me financuesit e huaj, ndërsa marrëveshjet e financimit nga kreditorët lokalë janë përgjithësisht me interes variabël (normë titulli reference +marzh).

Pika 8.2

Pika 8.2 Një shpjegim të burimeve dhe vlerave dhe një përshkrim të flukseve monetare të emetuesit.

Burimet e financimit të biznesit, sic theksuam edhe më sipër, janë huamarrjet dhe kapitali aksionar. Me një portofol të mirë-diversifikuar kontratash financimi si dhe me politikën e saj të kujdesshme lidhur me shpërndarjen e dividentëve, drejtimi i NOAs i ka siguruar këtij biznesi mbështetjen e duhur me likuiditete në mënyrë që të garantonte "rritjen" e tij në mënyrë natyrale dhe sipas potencialit të tiij.

Më poshtë paraqiten detyrimet për hua sipas financuesve të ndryshëm me 31 Dhjetor 2022:

Financuesi/ Funding Partner	Monedha	Teprica e kredise ne mije Leke	Maturiteti Kontraktual
Banka Kombetare Tregtare	ALL	691,791	36M
Union Bank	ALL	168,213	36M
Tirana Bank	ALL	188,552	36M
Ministria e Finances dhe Ekonomise	EUR	3,609	36M
BlueOrchard	EUR	624,228	36M
Frankfurt School of Financial Services	EUR	510,702	36M
Triple Jump	EUR	680,894	36M
Symbiotics	EUR & ALL	427,920	36M
Incofin CVBA	EUR	680,351	36M
Bank im Bistum Essen eG	EUR	114,209	36M
Black Sea Trade and Development Bank	EUR	90,498	36M
Developing Ëorld Markets	EUR & ALL	1,041,263	36M
Proparco	EUR	336,154	60M
interest accrued	EUR&ALL	47,568	
TOTAL		5,605,951	

Nisur nga benefitet e huamarrjes nga publiku përmes emetimit të titujve, NOA planifikon përsëritjen e këtij operacioni në të ardhmen e afërt dhe zëvendësimin gradual të disa financimeve nga të tretë me këtë lloj borxhi.

Referuar flukseve monetare, më poshtë përshkrimi i zërave/elementëve më të rëndësishëm hyrës dhe dalës:

Flukse monetare hyrëse:

1. Shlyerja e kredive (ripagesa e principalit dhe interesave) nga klientët;
2. Pagesa e komisioneve dhe tarifave nga klientët;
3. Disbursimet e financimeve të reja nga palë të treta etj.

Flukse monetare dalëse:

1. Disbursimet e kredive të klientëve;
2. Shlyerja e detyrimeve për huatë/kreditë (ripagesa e principalit dhe interesave palëve të treta);
3. Realizimi i shpenzimeve të tjera për mirëfunksionimin e shoqërisë (paga, qera, utilitete, marketing, konsulenca, taksa e tatime etj)
4. Investime etj.

Pra, mjetet monetare me të cilat NOA ushtron aktivitetin e saj (kredidhënien) janë ato që gjenerohen nga shlyerjet e portofolit të saj të kredive, pagesat e interesave dhe komisioneve nga klientët si dhe disbursimet e financimeve të reja të NOAs.

Pasqyra Individuale e Flukseve Monetare, për vitet 2022, 2021 dhe 2020 paraqitet si më poshtë:

Pasqyra e Flukseve Monetare (mijë Lekë)

I. Flukset e parasë nga aktiviteti operativ	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Fitimi para tatimit	472,092	388,092	330,819
Rregullime për:			
Shpenzime zhvlerësimi	70,910	62,902	59,296
Shpenzimet financiare për detyrimet e qirasë	6,103	6,853	6,795
Shpenzime Amortizimi	9,348	8,253	2,987
Humbje nga asgjësimi i pajisjeve	9		99
Humbjet nga zhvlerësimi i kredive për klientët	196,047	188,615	209,321
Humbje neto nga kursi i këmbimit	-8,160	-2,076	2,641

Amortizimi i granteve			
Të ardhura nga Interesat	-1,479,629	-1,278,642	-1,176,234
Shpenzime për Interesa	330,293	290,480	279,635
Ndryshime në:			
Kredi dhe paradhënie për klientët	-1,227,334	-855,428	-577,833
Kredi për institucionet financiare	61,612	170,992	202,492
Aktive të tjera	-23,958	-19,643	-19,006
Detyrime të tjera	-4,064	-11,961	36,585
Interesi i arketuar	1,324,896	1,275,860	1,168,246
Interesi i paguar	-320,527	-291,170	-285,011
Tatimi i paguar	-66,416	-64,439	-52,484
Hyrje/dalje neto e flukseve të parase nga aktiviteti operativ	**-658,778**	**-131,312**	**188,348**
II. Flukset monetare nga aktiviteti investues			
Blerje e aktiveve (pajisje, mjete etj.)	-38,105	-21,999	-21,751
Blerje e aktiveve jomateriale	-1,536	-10,420	-20,919
Hyrje/dalje neto e flukseve të parase nga aktiviteti investues	**-39,641**	**-32,419**	**-42,670**
III. Flukset monetare nga aktivitetet financuese			
Hyrje nga huatë (disbursime)	3,456,135	2,353,940	1,563,213
Shpyerje e huave	-2,411,656	-2,045,089	-1,555,189
Shlyerja e detyrimeve të qirasë	-50,760	-49,456	-49,150
Dividenti i paguar	-156,538		
Shlyerje e obligacioneve			-81,867
Hyrje/dalje neto e flukseve të parasë nga aktiviteti financues	**837,181**	**259,395**	**-122,993**
Flukse neto te parase gjate 2022	**138,762**	**95,664**	**22,685**
Mjetet Monetare në fillim të periudhës kontabël	**451,896**	**354,295**	**327,691**
Diferenca e këmbimit valutor në mjete monetare dhe ekuivalentët e saj	18,087	1,937	3,919
Mjetet Monetare në fund të periudhës kontabël	**608,745**	**451,896**	**354,295**

Drejtimi i NOAs, njësia e Thesarit, kujdeset për një menaxhim sa më efektiv të "cashit"/likuiditetit për të garantuar shlyerjen e detyrimeve sipas afateve kontraktuale si dhe për të siguruar rritjen e aktivitetit (plotësimin e kërkesave për kredi nga klientela pa vonesa). Për të garantuar sa më sipër, NOA mban një nivel të kënaqshëm aktivesh likuide (para, depozita afatshkurtra) dhe si përpiqet të përputhë maturitetet e aseteve dhe detyrimeve të saj. Politikat dhe procedurat e menaxhimit të likuiditetit janë objekt miratimi nga Komiteti i Menaxhimit të Aseteve dhe Detyrimeve (ALCO).

Si më 31.12.2022, Asetet dhe Detyrimet Financiare të NOAs kishin maturitete të mbetura kontraktuale si më poshtë:

	Deri ne 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Total
Asete Financiare					
Cash dhe ekuivalentë	608,744				608,744
Kredi për institucionet financiare	58,288	-	54,665		112,953
Kredi dhe paradhënie për klientët	372,504	681,978	3,316,473	4,463,636	8,834,591
Asete te tjera	8,734	-	2,358	-	11,092
Total Asete Financiare	**1,048,270**	**681,978**	**3,373,496**	**4,463,636**	**9,567,380**
Detyrime Financiare					

Hua	61,680	293,553	1,706,396	4,078,109	6,139,738
Detyrime Qeraje	4,079	8,157	36,709	72,644	121,589
Total Detyrime Financiare	65,759	301,710	1,743,105	4,150,753	6,261,327
Pozicion Neto	982,511	380,268	1,630,391	312,883	3,306,053
Pozicion Neto Akumulativ	982,511	1,362,779	2,993,170	3,306,053	
Pozicion Neto	982,512	380,267	1,630,392	312,882	3,306,053
Pozidioni Neto Akumulativ	982,512	1,362,779	2,993,171	3,306,053	-

Diferencat pozitive mes aseteve e detyrimeve garantojnë përmbushjen e të gjitha detyrimeve në kohë, pasi hyrjet e pritshme nga maturimi i aseteve tejkalon daljet e pritshme për shlyerjen e detyrimeve.

Pika 8.3

Pika 8.3 Informacion për kërkesat për huamarrjen dhe strukturën e financimit të emetuesit.

Referuar nevojave të ardhshme që NOA mund të ketë për fonde dhe nisur nga avantazhet e emetimit të borxhit, drejtimi i shoqërisë do të konsiderojë përsëri emetimin e obligacioneve si një ndër instrumentat e financimit të biznesit.
Me qëllim financimin e rritjes së portofolit të kredisë, NOA parashikon rinovimin e financimeve që maturohet brenda këtij 3 vjecari si dhe disa financime shtesë në formën e kredive dhe emetimeve të tjera të obligacioneve. Më poshtë paraqitet parashikimi mbi balancat e portofolit të kredisë si dhe detyrimeve për hua kundrejt të tretëve dhe obligacionmbajtësve.

Shifrat në mijë Lekë	31 Dhjetor 2022 (I audituar)	31 Dhjetor 2023 Parashikim*	31 Dhjetor 2024 Parashikim*	31 Dhjetor 2025 Parashikim*
Kredi dhe paradhënie për klientët	6,913,435	7,793,225	8,816,247	9,938,239
Rritje nga viti në vit		*879,790*	*1,023,022*	*1,121,992*
Obligacione të Emetuara		500,000	1,000,000	1,500,000
Huamarrje	5,605,951	5,954,711	6,352,180	6,959,710
Total detyrime Huamarrje dhe Obligacione	5,605,951	6,454,711	7,352,180	8,459,710
Rritje nga viti në vit		*848,760*	*897,469*	*1,107,531*

Nëpërmjet emetimeve të obligacioneve drejtimi synon t'i krijojë institucionit hapësirën për shfrytëzimin maksimal të këtyre fondeve/likuiditeteve pasi shlyerja e këtij lloj borxhi realizohet me një pagesë të vetme në datën e tij të maturimit. Duke patur parasysh maturitetin mesatar relativisht te shkurtër (rreth 24-26 muaj) të kredive të NOA-s (kredi për klientët), fondet e huazuara nga obligacionmbajtësit mund të "hidhen" disa herë në biznes e të "shfrytëzohen maksimalisht" me qëllim përfitimin financiar të institucionit. Një arsye tjetër në favor të financimit të biznesit nëpërmjet emetimit të obligacioneve në vend të huamarrjes nga institucione financiare të huaja e vendase, është liria e emetuesit për të vendosur vetë mbi të gjitha termat dhe kushtet e financimit, në përputhje të plotë me nevojat e tij dhe strukturën e tij të flukseve monetare.

Pika 8.4

Pika 8.4 Informacion për çdo kufizim për përdorimin e burimeve të kapitalit, që kanë ndikuar në mënyrë thelbësore ose mund të ndikojnë në mënyrë thelbësore, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në veprimtaritë tregtare të emetuesit.

	Nuk ka ndonjë kufizim për përdorimin e burimeve të kapitalit nga shoqëria që mund të ndikojë në veprimtarinë tregtare të NOAs.
Pika 8.5	**Pika 8.5 Informacion për burimet e parashikuara të financimit, që janë të nevojshme për përmbushjen e angazhimeve të përcaktuara në pikën 5.7.2.** Investimet në proces të shoqërisë, sikurse paraqitur në seksionin 5.7.2 të Kreu II të këtij prospekti, janë në vlera të ulëta nëse krahasuar me xhiron mujore të shoqërisë. Angazhimet në kuadër të këtyre investimeve në proces janë parashikuar të mbulohen me likuiditetet e krijuara nga aktiviteti normal i shoqërisë. Për finalizimin e tyre nuk do të jetë nevoja e ndonjë financimi të posacëm.

RUBRIKA 9 - MJEDISI RREGULLATOR

Pika 9.1	**Pika 9.1 Një përshkrim i mjedisit rregullator në të cilin ushtron veprimtari emetuesi dhe që mund të ketë ndikim të rëndësishëm në veprimtarinë e tij, së bashku me informacionin për çdo politikë qeveritare, ekonomike, fiskale, monetare ose politike ose faktorë, që kanë ndikuar në mënyrë thelbësore ose mund të ndikojnë në mënyrë thelbësore, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në aktivitetin tregtar të emetuesi.** NOA, si një shoqëri tregtare e themeluar dhe që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohet ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi të vendit tonë. Duke qënë se aktiviteti tregtar i NOAs, përfaqëson një veprimtari për të cilën është domosdoshmëri licencimi paraprak nga autoritetet mbikëqyrëse e licencuese si dhe mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme nga këto autoritete, NOA, krahas legjislacionit për shoqëritë tregtare i nënshtrohet dhe zbaton me rigorozitet cdo dispozitë të legjislacionit të posacëm që rregullon licencimin dhe ushtrimin e veprimtarive financiare në vend. Më poshtë, një listë, jo-ezauruese, e akteve ligjore në bazë të të cilave ushtrohet aktiviteti tregtar i NOAs: • Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar; • Ligji nr. 9901, datë 14. 04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; • Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe çdo akt nënligjor i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në zbatim të këtij ligji dhe që rregullon veprimtarinë e institucioneve financiare jobanka, prej të cilëve veçojmë për nga rëndësia : o Rregullore nr. 1, datë 17.01.2013 e Bankës së Shqipërisë “Per licencimin dhe ushtrimin e veprimtarise nga subjektet financiare jobankare”, e ndryshuar; • Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", i ndryshuar si dhe çdo akt nënligjor të miratuar nga Bordi i AMF-së në zbatim të këtij ligji; • Ligji nr.9917, date 19.05. 2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, dhe të gjitha aktet nënligjore në zbatim të tij; • Ligi nr. 9902, datë 17.042008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, • Ligji nr. 9887, date 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Autoritetet të cilat kanë licencuar NOA sha dhe që mbikëqyrin veprimtarinë e saj në vazhdimësi janë Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Përshkak të ushtrimit të një veprimtarie që kërkon liçencim, legjislacioni dhe ndryshimet e tij janë të një rëndësie të madhe për mbarëvajtjen e aktivitetit tregtar të NOAs. Për këtë arsye, NOA ka në strukturën e saj të brendshme organizative njësinë e posacme “Risk dhe Përputhsmëri” e cila, ndër të tjera, ka

	detyrë të "skanojë" cdo akt ligjor e nënligjor që prek aktivitetin e NOAs dhe në vijim të sigurojë përputhshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë me to.

RUBRIKA 10 - INFORMACION PËR PRIRJET

Pika 10.1

Pika 10.1 Një përshkrim të prirjeve më të rëndësishme të kohëve të fundit sa i takon prodhimit, shitjes së produktit të gatshëm/shërbimeve, kostove dhe çmimeve të shitjes, që nga mbyllja e vitit të fundit financiar deri në datën e prospektit dhe çdo ndryshimi të konsiderueshëm në ecurinë financiare të grupit, që nga mbyllja e periudhës së fundit financiare, për të cilën është publikuar informacioni financiar, deri në datën e prospektit ose paraqitje e një deklaratë përkatëse negative.

Të dhëna paraprake të biznesit për 3 mujorin e parë 2023.

Pavarësisht kushteve makroekonomike në momentin e publikimit të këtij Prospekti (normë inflacioni mbi vlerën e targetuar nga Banka e Shqipërisë dhe norma interesi në rritje), aktiviteti i NOAs ka shënuar një ecuri shumë të mirë përgjatë 3 muajve të parë të vitit 2023.

Kështu sipas të dhënave paraprake të shoqërisë, vetëm gjatë tremujorit të parë të vitit 2023, portofoli neto i kredisë u rrit me 7,4 % (ose me rreth 508 milionë Lekë) duke përmbushur mbi 57% të objektivit për rritjen vjetore të portofolit neto të kredisë, prej 13%. Ndikimin më të madh në këtë rritje të portofolit e ka patur kredidhënia për segmentin "biznes i vogël e i mesëm" i cili absorboi rreth 838 milionë Lekë .

Vlera totale e disbursimeve gjatë tremujorit të parë të vitit arriti në rreth 1.47 miliardë Lekë, ndërkohë numri i kredive të disbursuara për periudhën në fjalë është 3,744 kredi.

Vështrim i Shpejtë mbi Tremujorin i 2023	31 Mars 2023 Paraprake	2022
Disbursime në Vlerë (mijë Lekë)	1,471,626	5,497,412
Disbursime Segmenti "Biznes i vogel & i mesem"	837,826	3,194,649
Disbursime Segmenti "Agro"	242,118	1,013,985
Disbursime Segmenti "Individë"	391,682	1,288,777
Portofol Kredie Neto (mijë Lekë)	7,421,767	6,913,435
Numër kredish të disbursuara	3,744	13,536
Total Asete	8,447,427	7,980,252
Total Detyrime	6,448,719	5,861,875
% e Rritjes së Aseteve	5.9%	20.0%
% e Rritjes së Portofolit Neto	7.4%	20.0%
% e Rritjes së Detyrimeve	10.0%	22.0%

Rreth situatës ekonomike në vend dhe ndikimit të mundshëm të saj në kërkesën për kredi.

Kërkesa për kredi në nivel kombëtar është e lidhur ngushtë me kushtet makro-ekonomike të vendit, në mënyrë të vecantë me rritjen ekonomike (Prodhimit të Brendshëm Bruto (GDP)) dhe nivelin e inflacionit. Gjatë vitit 2022 ekonomia Shqiptare filloi të përjetojë pasojat e rritjes së cmimeve ndërkombëtare të energjisë dhe ngadalësimit ekonomik në Evropë, manifestuar këto nëpërmjet rritjes së shpejtë të inflacionit përtej normës objektiv prej 3% (siç vendosur nga Banka e Shqipërisë me qëllimin e arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të cmimeve). Në përgjigje të kësaj situate, Banka e Shqipërisë vendosi të ndryshojë drejtimin e politikës monetare, duke rritur 5 herë brenda vitit 2022 normën bazë të interesit, si një masë e domosdoshme për frenimin e rritjes dhe më pas zbutjen e inflacionit. Sinjalet e para pozitive në ekonomi erdhën përgjatë dy muajve të fundit të vitit 2022, kur

inflacioni shënoi rënie pas një periudhe pothuaj një vjecare në rritje të vazhdueshme. Arsyet e kësaj kthese në trajektoren e inflacionit lidhen kryesisht me rënien e cmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare megjithatë pritet që ky tregues të vijojë rënien edhe në muajt në vijim si pasojë e ndikimit të qëndrimit normalizues të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë por edhe faktorëve të tjerë si stabilizimi i cmimeve në tregjet ndërkombëtare etj.

Sipas parashikimeve të Bankës së Shqipërisë, shprehur në Raportin Tremujor të Politikës Monetare 2023/1, inflacioni pritet të reduktohet progresivisht gjatë vitit 2023, ndikuar nga rënia e presioneve në tregjet e huaja dhe normalizimi i qëndrimit të politikës monetare,dhe pritet të kthehet në objektiv në mesin e vitit 2024.

Normalizimi i politikës monetare së ndjekur nga Banka e Shqipërisë, është pasqyruar edhe në normat e interesit në tregun tone financiar, kështu prej muajve të fundit të vitit 2022 normat e interesit të depozitave dhe kredive të reja kanë shënuar rritje.Referuar kreditimit, në kushtet e pasigurisë mbi ecurinë ekonomike dhe aftësinë paguese të kredimarrësve në të ardhmen, sistemi bankar është duke aplikuar terma dhe kushte shtrenguese kreditimi.Pavarësisht kësaj, kreditimi i ekonomisë është rritur edhe gjatë tremujorit të fundit të 2022, ndonëse me ritëm të ngadalësuar krahasuar me periudhën pararendëse.

Banka e Shqipërisë parashikon se pavarësisht sfidave me të cilat po përballen individet, operatorët sektorit privat e publik, ekonomia shqiptare do të vazhdojë të rritet edhe përgjatë 2023.

Ndikimet më të rëndësishmë që situata ekonomike mund të ketë mbi aktivitetin e NOAs janë : ulja e mundshme e kërkesës për kredi dhe ndikimi i drejtëpërdrejtë i normave të rritura të tregut në kostot dhe marzhet e institucionit.

Sikurse lexohet edhe nga rezultatet e aktivitetit të NOAs përgjatë vitit 2022 dhe tremujorit të parë vitit 2023, në sportelet e NOAs nuk është ndjerë ndonjë tendencë rënie/tërheqje në kërkesën e konsumatorit për kredi; përkundrazi volumet e disbursuara dhe numri i kredive të disbursuara gjatë periudhës në fjalë janë ndër shifrat më të mira të arritura nga institucioni.

Rreth kostove të fondeve të NOAs dhe cmimeve të kredive për klientët.

Rritja e konsiderueshme e normës bazë të interesit nga rregullatorët (BQE, Banka e Shqipërisë) është e pritshme të reflektohet në formë zinxhir edhe në "cmimin" e kredive.

Kostot e fondeve të NOAs, kanë pësuar rritje si pasojë e përshtatjes së interesit variabël të financimeve më referencat e reja si dhe përshkak të interesave të rritura të financimeve të reja. Në fund të vitit 2022, NOA përshtati edhe termat e kredive të reja duke reflektuar një rritje prej 2-3 pikë përqindje .

Në mënyrë të përmbledhur, ndryshimin në normat interesit të borxhit, portofolit të kredive të klientëve dhe tepricës së depozitave në sistem bankar, e paraqesim përmes tabelës së mëposhtme.

Normat e interesit		31 Dhjetor 2022		31 Dhjetor 2021	
		Euro	Lekë	Euro	Lekë
Aktive	Hua të arkëtueshme nga institucionet financiare (teprica e depozitave)	0.29%	n/a	0.15%	n/a
	Hua dhe paradhënie klientësh	16.06%	20.65%	15.39%	20.62%
Detyrime	Hua	5.06%	5.67%	4.82%	4.86%

Nuk ka ndryshime të rëndësishme në përfitueshmërinë e aktivitetit kreditues të NOAs në vijim të rrijtes së kostove të fondeve dhe rishikimit në rritje të interesit për kreditë e reja për klientët.

Vendimarrja e ardhshme lidhur me interesat e kredive për klientët do të jetë ne varësi të masës së ndryshimit të kostove të fondeve të Emetuesit, çka mbetet për tu vlerësuar në viijm dhe do të jetë në varësi të drejtëpërdrejtë të lëvizjes së interesave në treg.

Pika 10.2	**Pika 10.2 Informacion për çdo prirje, pasiguri, kërkesë, angazhim ose ngjarje të ditur, të cilat ka mundësi të arsyeshme të kenë një ndikim thelbësor në perspektivat e emetuesit të paktën për vitin aktual financiar.** Drejtimi i NOAs nuk parashikon se në një periudhë kohore afatshkurtër do të ketë ngjarje , prirje që do të mund të ndikonin në **mënyrë thelbësore** në perspektivat e emetuesit për biznesin. Natyrisht, rritja e inflacionit dhe normave bazë të interesit, mund të këtë një ndikim në kostot e fondeve dhe si pasojë në interesat e kredive të klientëve të NOAs, përgjatë vitit 2023, por pritet që ndryshimet të mos jenë të mëdha dhe aq më pak frenuese të aktivitetit të kredidhënies.

RUBRIKA 11 -PARASHIKIMET OSE VLERËSIMET E FITIMEVE

Pika 11.1

Pika 11.1 Kur emetuesi vendos të përfshijë një parashikim të fitimit ose një vlerësim të fitimit, parashikimi ose vlerësimi i fitimit duhet të jetë i qartë, të mos lërë vend për keqkuptime dhe të shoqërohet nga një deklaratë, e cila përcakton supozimet kryesore mbi të cilat emetuesi ka mbështetur parashikimin ose vlerësimin si dhe një deklaratë se parashikimi ose vlerësimi i fitimit është përpiluar mbi një bazë që është e krahasueshme me të dhënat historike financiare dhe në përputhje me politikat kontabël të emetuesit.

Emetuesi, për qëllime të brendshme, përgatit projeksionet e biznesit dhe ato financiare për çdo vit financiar dhe i rishikon/korrigjon ato gjatë vitit nëse verifikohen ndryshime të rëndësishme në ambjentin e jashtëm apo atë të brendshëm.

Edhe pse informacioni mbi fitimin e pritshëm nuk është një informacion i detyrueshëm për t'u publikuar nga emetuesit, NOA, në shenjë transparence me investitorët, ka përfshirë parashikimet e saj financiare në brendësi të këtij Prospekti.

Më poshtë paraqiten projeksionet e drejtimit të shoqërisë lidhur me pozicionin financiar të shoqërisë për periudhën 2023-2025, paraqitur si pasqyra individuale.

BILANCI *(shifrat në "mijë Lekë")*	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
AKTIVET	(I audituar)*	Parashikim*	Parashikim*	Parashikim*
Mjete monetare	608,744	586,529	520,264	521,820
Kredi për institucionet financiare	105,563	300,011	364,823	424,835
Kredi dhe paradhënie për klientët	6,913,435	7,793,225	8,816,247	9,938,239
Inventar dhe asete te tjera	90,488	110,145	130,359	249,157
Aktive afatgjata materiale	202,346	262,958	296,971	321,972
Aktive afatgjata jomateriale				
Investime ne filial	35,031	60,000	60,000	60,000
Aktive tatimore të shtyra	24,644	25,000	25,000	25,000
Totali i Aktiveve	**7,980,252**	**9,137,868**	**10,213,663**	**11,541,023**
DETYRIMET DHE KAPITALI				
Detyrimet				
Grante				
Detyrime tatimore	16,915			
Detyrime të tjera	239,009	414,739	415,733	415,354
Obligacione të Emetuara		500,000	1,000,000	1,500,000
Huamarrje	5,605,951	5,954,711	6,352,180	6,959,710
Totali i Detyrimeve	**5,861,875**	**6,869,449**	**7,767,912**	**8,875,064**
Kapitali				

Kapitali i nënshkruar	731,838	731,838	731,838	731,838
Rezerva ligjore	73,184	73,184	73,184	73,184
Fitimi i pashpërndarë	1,313,355	1,463,396	1,640,728	1,860,937
Totali i Kapitalit	**2,118,377**	**2,268,419**	**2,445,751**	**2,665,959**
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit	**7,980,252**	**9,137,868**	**10,213,663**	**11,541,023**

* pasqyra financiare individuale

Më poshtë paraqiten projeksionet e drejtimit të shoqërisë lidhur me pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse të shoqërisë për periudhën 2023-2025, paraqitur si pasqyra individuale.

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET *(në mijë Lekë)*	31 Dhjetor 2022 (te audituara)*	31 Dhjetor 2023 Parashikim *	31 Dhjetor 2024 Parashikim*	31 Dhjetor 2025 Parashikim*
Të ardhura nga interesi	1,479,629	1,778,649	1,986,671	2,238,883
Shpenzime interesi	-336,396	-521,408	-640,981	-732,833
Të ardhura neto nga interesi	**1,143,233**	**1,257,241**	**1,345,690**	**1,506,051**
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	103,047	108,739	120,770	138,596
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet	-2,276	-2,500	-2,500	-2,500
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	**100,770**	**106,239**	**118,270**	**136,096**
Rikuperimet nga kreditë e fshira	94,185	79,970	84,317	84,405
Të ardhura të tjera	13,288	11,500	12,500	13,500
Te ardhura operacionale neto	**1,351,477**	**1,454,950**	**1,560,777**	**1,740,051**
Shpenzime personeli	-423,588	-461,257	-507,826	-572,408
Shpenzime të tjera	-187,652	-227,230	-235,754	-254,850
Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhëniet për klientët	-196,047	-248,087	-279,855	-311,101
Amortizimi i pajisjeve	-70,910	-86,672	-102,631	-114,433
Zhvlerësimi i aktiveve jomateriale	-9,348	-13,000	-13,000	-13,000
Fitim/ (humbje) nga kursi i këmbimit	8,160	-2,500	-2,500	-2,500
Totali i shpenzimeve	**-879,384**	**-1,038,745**	**-1,141,566**	**-1,268,292**
Fitimi para tatimit	**472,092**	**416,205**	**419,212**	**471,759**
Shpenzime tatimore	-72,821	-66,593	-67,074	-75,481
Fitimi i Vitit	**399,271**	**349,612**	**352,138**	**396,277**

* pasqyra financiare individuale

Deklarojmë se parashikimet e mësipërme financiarë janë përpiluar duke përdorur si bazë të dhënat dhe rezultatet më të fundit financiare, të cilat janë plotësisht të krahasueshme me të dhënat historike financiare dhe janë në përputhje me politikat kontabël të emetuesit.

Dekalrojmë gjithashtu se projeksionet e mësipërme të pozicionit financiar dhe të ardhurave e shpenzimeve të shoqërisë, janë mbështetur mbi të dhënat, parashikimet dhe supozimet e më poshtë listuara:

3. Zhvillimet makroekonomike të vendit do të jenë në të njëjtën linjë me parashikimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në dokumentin "Kuadri makroekonomik dhe fiskal 2024-2026" ;

4. Banka e Shqipërisë do të vijojë me hapat drejt normalizimit të politikës monetare dhe do të rrisë përsëri normën bazë të interesit gjatë 2023;
5. Struktura e portofolit të kredisë pritet të mos ketë ndryshime të mëdha përsa i përket
   - segmenteve të krediturar,
   - sektorëve të krediturar të ekonomisë,
   - monedhës kryesore të kreditimit dhe
   - cilësisë së portofolit.
6. Referuar kredisë së disbursuar, viti 2023 pritet të mbyllet me rreth 13% rritje krahasuar me vitin 2022, ndërsa rritja gjatë 2024 dhe 2025 pritet të jetë në nivelin 16%.

(mijë Lekë)	2022	2023	2024	2025
Disbursime kredi	**5,497,412**	**6,200,018**	**7,182,777**	**8,340,090**
Segmenti Agro	1,013,985	1,178,300	1,356,022	1,560,364
Segmenti Biznes i Vogel e i Mesem	3,194,649	3,737,648	4,425,909	5,226,441
Segmenti Individe	1,288,777	1,284,070	1,400,846	1,553,285

7. Kthimi nga portofoli i kredive do të mbetet në nivelet 23.5%-24.5% edhe përgjatë peirudhës 2023-2025 ndërsa treguesi i kredive me probleme (mbi 90 ditë vonesa) do të vijojë 2-2.5% në vitet në vijim.
8. Detyrimet për hua do të shlyhen sipas afateve kontraktuale. NOA parashikon rinovimin e financimeve që maturohet brenda këtij 3 vjecari si dhe disa financime shtesë në formën e kredive dhe emetimeve të tjera të obligacioneve.

(mijë Lekë)	2022	2023	2024	2025
Obligacione të Emetuara		500,000	1,000,000	1,500,000
Huamarrje	5,605,951	5,954,711	6,352,180	6,959,710
Totali i Detyrimeve nga të Tretë	**5,861,875**	**6,869,449**	**7,767,912**	**8,875,064**

9. Projeksionet janë realizuar mbi supozimin e shpërndarjes së pjesshme (jo të plotë) të fitimit ushtrimor të periudhave të ardhshme në formën e dividendit në rradhën e aksionarëve.
10. (Buxhetime të brendshme) Projeksionet janë mbështetur mbi buxhetet e të gjitha njësive (departamenteve) të NOAs si dhe rrjetit të degëve të shoqërisë.

RUBRIKA 12 - ORGANET ADMINISTRATIVE, DREJTUESE DHE MBIKËQYRËSE DHE DREJTUESIT E LARTË

Pika 12	Pika 12 Organizimi Organizimi Drejtimi i shoqërisë është në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të qeverisjes së korporatave si dhe kurdoherë në zbatim të parashikimeve të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ndryshuar si dhe Ligjit nr 62/2020, datë 14.5.2020, “Për tregjet e kapitalit”.

Aksionarët, këshilli i administrimit dhe administratori kanë organizuar shoqërinë në struktura të pavarura (kryesisht paralele) që kanë për qëllim drejtimin efektiv të shoqërisë dhe mbështetjen e biznesit me vendimmarrje të shpejta e cilësore si dhe kontroll të vazhdueshëm. Ndarja e funksioneve, kompetencave dhe përgjegjësive të njësive dhe organeve të ndryshme drejtuese e mbikëqyrëse është shumë e qartë dhe e mirëpërcaktuar në statutin e shoqërisë dhe akte të tjera të brendshme të emetuesit.

Më poshtë paraqitet organograma e NOAs , e cila sikurse shihet është një strukturë e sheshtë e cila synon te evitojë burokracitë e tepërta në vendimmarrje dhe të inkurajojë kreativitetin dhe sjelljen novatore në organizatë. Struktura organizative e NOAs, në kushtet e mungesës së shumë niveleve të hierarkisë, promovon delegimin dhe pavarësinë e punonjësve.



12.1

Emrat, adresat dhe funksionet që mbajnë pranë emetuesit, si edhe informacion për veprimtaritë kryesore të kryera jashtë emetuesit, kur këto janë të rëndësishme për emetuesin, për personat e mëposhtëm:

(a) anëtarët e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse;

1. Z.Andrew Walsh,

Adresa: Digby House,Station Road, Chilbolton,Stockbridge, Hampshire, S020, 6AË, Britani e Madhe.

Funksioni pranë NOA: Kryetar i Këshillit Administrativ (jo ekzekutiv).

Funksioni jashtë Emetuesit:

- Kryetar i Bordit Drejtues të Aura Technology Group Limited 2019 - vazhdim;
- Partner në Firestarter Hampshire 2004 - vazhdim;
- Kryetar i Këshillit të Administrimit Microinvest Moldova 2015-2017;
- Drejtues jo ekzekutiv pranë Inicjatyvëa Micro Poland 2016-2017,
- Drejtor i BuildRiver Limited, UK Property Developer 2004-2011;
- Drejtor i Redstone PLC, 2001-2004;
- Drejtor i Fastnet Systems PLC 1955-2000;
- Drejtor i DCM Services Limited 1990-1995.

2. Znj. Herjola Spahiu,

Adresa: Rruga "Tish Daia", Sh.9, AP.C, Kati 7, Tiranë, Shqipëri.

Funksioni pranë NOA: Zv/Kryetar i Këshillit Administrativ (ekzekutiv) dhe Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv.

Funksioni jashtë Emetuesit:

- Anëtar i Bordit të Shoqatës Europiane të Mikrofinancës (EMN), me qendër në Bruksel (prej Tetor 2021-vazhdim);
- Anëtare e Bordit Këshillues Forumi Ekonomik i Ballkanit (BEF) (2022-vazhdim);

- Anetare e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare (prej 2014-vazhdim)

3. Z. Petr Sastinsky,

Adresa: K Hořavce 337/9, 190 16, Prague 9, Kolodeje, Republika Çeke.
Funksioni pranë NOA: Anëtar i Këshillit Administrativ (jo ekzekutiv).
Funksioni jashtë Emetuesit:

- Anëtar i Këshillit të Administrimit Czech Consumer Non-Banking Credit Bureau (2016-2018;
- Anëtar i Këshillit të Administrimit Czech Leasing Association 1993-2018;

4. Z. Tomas Hlavac,

Adresa: V Kapslovne 2761/6 , Zizkov , 130 00, Prague 3 , Republika Çeke.
Funksioni pranë NOA: Anëtar i Këshillit Administrativ (jo ekzekutiv).
Funksioni jashtë Emetuesit: Menaxher i M&A Advisory, studio kontabiliteti ne Ceki (2010 – vazhdim).

5. Znj. Elona Gjika,

Adresa: Rruga e Elbasanit , Pallati , Gener 2 , AP1 , Tirane, Shqipëri.
Funksioni pranë NOA: Anëtar i Këshillit Administrativ (jo ekzekutiv).
Funksioni jashtë Emetuesit:

- Anëtare e Komitetit të Kontrollit të Bankës Amerikane të Investimeve (Tetor 2015 – vazhdim),
- Konsulente e vetë punësuar, Elona Gjika PF (Tetor 2017 – vazhdim)

(b) drejtuesit e lartë që janë të aftë të përcaktojnë se emetuesi ka përvojën dhe ekspertizën e duhur për menaxhimin e aktivitetit tregtar të emetuesit.

Më poshtë paraqiten jetëshkrimet, në formë të përmbledhur të drejtuesve kyç të NOAs:

1. Zj.Herjola Spahiu - Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Mbi 20 vite përvojë të dëshmuar në planifikim strategjik, retail, operacione dhe projekte, zhvillim organizativ dhe menaxhimin e ndryshimeve në sektorin bankar dhe financiar.

Pas përvojës së thellë bankare, në prill 2014 zj. Herjola Spahiu mori drejtimin e shoqërisë si Drejtor Ekzekutiv dhe Nënkryetar i Këshillit Administrativ, e fokusuar në përmbushjen e objektivave afatgjatë të NOA, duke ndërtuar një ekip të fortë drejtuesish të lartë të aftë për të udhëhequr kolektivisht biznesin dhe të arrijnë rezultate të larta, duke siguruar që shoqëria është në përputhje të plotë me kornizën ligjore dhe rregullatore, Kodin e Sjelljes dhe duke vepruar gjithnjë si mbrojtës i vlerave të shoqërisë.

Në frymën e avokimit dhe promovimit të rolit të sektorit të mikrofinancës në ekonominë shqiptare, zj. Spahiu mbajti pozicionin e Kryetares së Shoqatës Shqiptare të Mikrofinancës në periudhën 2015-2016.

2011-2014 Në pozicionin e Drejtorit të Retail, ajo udhëhoqi me sukses projektin e transformimit gradual nga Grupi Emporiki në Grupin e Credit Agricole, duke siguruar harmonizimin e rrjetit me strategjinë e re të grupit dhe objektivat e përputhshmërisë.

2009 - 2011 E promovuar si Drejtor i Operacioneve, përveç IT dhe Operacioneve, Financës, Thesarit dhe Administrimit, ajo drejtoi me sukses njëkohësisht Projektin për zbatimin e Sistemit të Ri Bankar Bazë (FlexCube) dhe zhvillimin e Strategjisë së Retail, duke krijuar një strukturë të përkushtuar në ndjekjen e kredive në vonesë, ndërtimin e produkteve të specializuara për kreditë e ristrukturuara, etj

2002 - 2009 Pas fillimit të karrierës së saj të hershme në 2002 në Tirana Bank, ajo iu bashkua Bankes Emporiki / Credit Agricole në Korrik 2003, duke u promovuar në pozicione të ndryshme, në linjë me strategjinë zgjerimit dhe fokusin e bankës gjatë kësaj periudhe. Në Prill 2006, ajo mori përsipër përgjegjësinë për të themeluar Divizionin e Retail-it dhe Marketingut, duke përmbushur rezultate të larta dhe arritur zgjerimin e rrjetit të degëve nga 3 në 20 degë në qytetet kryesore të vendit. Gjatë kësaj

periudhe, ajo drejtoi me sukses projektin e rëndësishëm të "Aplikimit të Modelit të Ri të Biznesit" në rrjetin e degëve, një filozofi e re e shërbimit ndaj klientit me cilësi të lartë dhe të nxitur nga performanca.
Zj. Herjola Spahiu u diplomua në Administrim Biznesi / Marketing në Fakultetin e Ekonomisë në Vlorë, në 2002, më vonë ndoqi studimet pas universitare në Menaxhim Bankar dhe Promovimin e Produkteve Bankare, në Universitetin e Athinës. Ajo mban një diplomë Ekzekutive në Administrim Biznesi (EMBA) nga International Hellenic University, Selanik. Së fundmi, ajo është çertifikuar në "Udhëheqja Strategjike në Përfshirjen Financiare" nga Harvard Business University.

2. Zj.Ariola Cela- Drejtor Departamenti i Financës

Mbi 17 vite përvojë të dëshmuar në financë, auditim financiar, projekte këshilluese, menaxhim risku dhe planifikim strategjik, në auditimin e jashtëm dhe sektorin financiar. Zj. Çela u promovua si Drejtor i Departamentit të Financës në Prill 2018 pas 3 viteve si Drejtor i Kontabilitetit dhe Raportimit për NOA Holding Group, e fokusuar në ofrimin e një shërbimi gjithëpërfshirës financiar dhe kontabiliteti, duke siguruar se të gjitha veprimet financiare të ndërmarra brenda shoqërisë kryhen në përputhje me rregulloret financiare.
Ajo iu bashkua NOA në Janar 2015 si Drejtor i Kontabilitetit dhe Raportimit për NOA Holding Group, pas 10 vite përvojë në auditimin e jashtëm, auditime financiare dhe projekte këshilluese. Nëpërmjet një shërbimi të përkryer kontabiliteti për grupin, konsolidimeve dhe raportimeve bëri të mundur realizimin e një analizë efektive të biznesit. Njëkohësisht ajo mbajti pozicionin e Sekretarit Korporativ të Këshillit Administrativ dhe Anëtarit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të NOA.
(2006-2014)
Ajo filloi karrierën e saj të hershme (2006) në Deloitte Albania si Asistente në departamentin e auditit duke u promovuar ndër vite në pozicione të ndryshme të larta. Ajo kreu me sukses auditime financiare dhe projekte këshilluese duke u fokusuar në kontrollet e brendshme dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar për shumë shoqëri vendase dhe ndërkombëtare që operojnë si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë duke u shndërruar në partner biznesi për këto shoqëri. Ajo gjithashtu ka arritur të vlerësojë me sukses kontrollet e brendshme, procedurat dhe funksionin e auditimit të brendshëm në industrinë bankare, si dhe në institucione të tjera financiare. Ajo u promovua si Mbikëqyrëse, Departamenti i Auditimit në vitin 2011. Gjatë kësaj periudhe, ajo ka facilituar trajnime në lidhje me praktikat më të mira në ndjekjen e kornizës dhe metodologjisë së auditimit, dokumentacionit, standardeve etike, qeverisjes, identifikimit të mashtrimit etj.
Zj. Çela u diplomua në "Financë dhe Kontabilitet" në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, në 2005. Aktualisht eshte ne proces Anëtarësimi në Shoqatën e Kontabilistëve të Certifikuar, Mbretëri e Bashkuar – ACCA si dhe është Ekspert i Certifikuar në Menaxhimin e Riskut nga Frankfurt School.

3. Albana Pelinku - Drejtor Departamentit të Riskut

Mbi 14 vite përvojë të dëshmuar në mbledhjen dhe rekuperimin e kredive në vonesë, çështjet ligjore dhe përputhshmërinë dhe menaxhimin e riskut në sektorin bankar dhe institucione financiare.
Pas rikthimit në NOA në Janar 2018 si Drejtor i Ligjor dhe Rekuperimit, zj. Pelinku u promovua më tej në Gusht 2018 si Drejtor i Menaxhimit të Riskut duke u fokusuar të sigurojë minimizimin e të gjitha risqeve të shoqërisë nëpërmjet ofrimit të politikave të forta të riskut, procedurave dhe analizave të vazhdueshme, dhe duke ofruar një shërbim gjithëpërfshirës të vlerësimit të riskut në përputhje me planin e biznesit dhe rregulloret financiare.
(2015 – 2017)
Zj. Pelinku iu bashkua NOA-s për herë të parë në maj 2015 si Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Rekuperimit, pas 11 vjet përvojë në sektorin bankar në Credit Agricole dhe Raiffeisen Bank. Për 2 vite ajo menaxhoi me sukses risqet ligjore dhe kontraktuale dhe siguroi që proceset dhe procedurat të jenë

plotësisht në përputhje me rregullatorin shqiptar përmes ofrimit të shërbimeve këshilluese juridike. Ajo gjithashtu përcaktoi strategji të suksesshme për të rikuperuar në mënyrë efektive kreditë e fshira.
(2010 – 2015)
Ajo ju bashkua Bankës Credit Agricole, fillimisht në pozicionin e Drejtor të Menaxhimit të Aseteve në Ekzekutim për tu promovuar më tej si Manaxher i Kontrollit të Biznesit dhe Suportit të Rrjetit, duke ndikuar në zbatimin e niveleve të duhura të kontrollit në rrjetin e degëve të bankës, për sa i përket kërkesave ligjore për pajtueshmërinë dhe kërkesave të riskut operacional.
(2004 – 2010)
Ajo filloi karrierën e saj të hershme në Raiffeisen Bank ku përgjatë viteve ndërmori pozicione të ndryshme duke filluar si Shërbim Klienti për Bizneset për t'u promovuar më tej si Specialist i Lartë i Investigimeve, Manaxher i Njësisë së Investigimeve dhe Manaxher i Njësisë së Mbledhjes së Kredive. Ajo dha një kontribut të konsiderueshëm në kontrollin dhe investigimin e risqeve operacionale, zbatimin e strategjive të mbledhjes së kredive, hartimin dhe menaxhimin e proceseve të ristrukturimit të kredive etj.
Zj. Pelinku u diplomua në Drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë në Shkodër, në 2003. Ajo gjithashtu zotëron një diplomë Master në Administrim Biznesi nga Universiteti i Tiranës dhe është Ekspert i Certifikuar në Menaxhimin e Riskut nga Frankfurt School.

4. Elda Toro - Drejtor Departamenti i Auditimit të Brendshëm
Mbi 21 vite përvojë në Auditim Financiar, Menaxhim dhe Kontroll në sektorin financiar, ofrimin e shërbimeve për klientë ndërkombëtarë dhe vendas përfshirë auditimin e pasqyrave financiare të IFRS/ IAS, due diligence dhe këshillim kryesisht në shërbimet publike, ndërtim, retail si dhe banka dhe telekomunikacion.
Pas 20 vite përvojë të thellë financiare dhe auditim, zj. Toro iu bashkua NOA si Drejtor i Auditimit të Brendshëm, në janar 2019, me fokus kryesor në ofrimin e një shërbimi të pavarur dhe të koordinuar të inspektimit operacional për të gjitha fushat e biznesit, me qëllim evidentimin dhe raportimin e të gjitha fushat të mos përputhshmërisë dhe ekspozimit, dhe kryerjen e rekomandimeve për ndryshime. Menaxhimi i partnerëve të jashtëm dhe koordinimi i auditimit të jashtëm.
(2012 – 2018)
Zj. Toro ju bashkua "Final", një institucion mikrofinanciar në rolin e Drejtoreshës së Financës, ku ajo zhvilloi departamentin e financës për më shumë se 6 vite, duke siguruar përputhshmëri me kërkesat e rregullatorëve dhe auditorëve duke u fokusuar në krijimin e të gjitha politikave dhe procedurave të nevojshme për të menaxhuar risqet dhe kontrollet financiare.
(1999 – 2011)
Ajo filloi karrierën e saj të hershme në Deloitte Albania si asistente e auditimit dhe vazhdoi më vonë në PriceëaterhouseCoopers Albania. Gjatë viteve, ajo është promovuar në disa pozicione të larta si Menaxher i Auditit dhe Konsulencës në shërbime këshilluese dhe audituese, në të dy shoqëritë.
Zj. Toro u diplomua në "Financë dhe Bankë" nga Universiteti i Tiranës, në 1999. Aktualisht mban Certifikatën e Anëtarësisë në Shoqatën e Kontabilistëve të Certifikuar, Mbretëri e Bashkuar - ACCA.

(c) Informacion mbi pastërtinë e figurave:
Anëtarët e Këshillit Administrativ si dhe të gjithë drejtuesit kyç të shoqërisë :
- nuk kanë qënë të dënuar për vepra mashtrimi;
- nuk kanë qënë të përfshirë në falimente, administrime ligjor, likuidime të shoqërive të paktën në 5 vitet e fundit;
- nuk kanë qënë subjekt i ndonjë kallëzimi për kryerjen e veprës penale dhe/ose sanksioni të vendosur kundër këtyre personave nga autoritetet ligjore ose rregullatore;
- nuk gjenden në situatë konflikti mes interesave personale dhe atyre të shoqërisë emetuese ku ushtrojnë funksionet e tyre.

RUBRIKA 13 -SHPËRBLIMI DHE PËRFITIMET

Pika 13.1	**Pika 13.1 Në lidhje me vitin e mbyllur financiar, për personat që përmenden në pikën 12.1 : vlerat e shpërblimit të paguar (përfshi çdo kompensim të kushtëzuar ose të shtyrë) dhe përfitimet në natyrë, që u jepen personave të tillë nga emetuesi për shërbimet që secili prej këtyre personave i ofron në të gjitha funksionet emetuesit.**
	Kompensimi, shpërblimi për drejtuesit dhe anëtarët e Këshillit Administrimit paraqitet si më poshtë:

(në mijë Lekë)	2022	2021	2020
Shpërblimi i Drejtuesve të lartë dhe Anëtarët e Këshillit	68,034	62,082	58,385

Pika 13.2	**Pika 13.2 Vlerat e përgjithshme të vëna rezervë ose të akumuluara nga emetuesi për pensione ose për përfitime të ngjashme.** Në vitin 2021 është krijuar një fond pensioni për të gjithë punonjësit e NOA-s. Vlera e kontributit të shoqërisë për ekipin e lartë të menaxhimit ishte me vlerë 673 mije Lekë në 31.12.2022. Krahas fondit të pensionit, NOA u ka siguruar punonjësve të saj edhe një paketë sigurimi jete dhe shëndeti. Vlera e paguar nga NOA për siguracionet e ekipit të menaxherëve të lartë ishte 217 mije lekë , si më 31.12.2022.

RUBRIKA 14 -PRAKTIKAT E KËSHILLAVE

Pika 14.1	**Pika 14.1 Në lidhje me vitin e mbyllur financiar të emetuesit, nëse nuk është specifikuar ndryshe, për personat që përmenden në pikën 12.1:** **Data e përfundimit të mandatit aktual, nëse ka, dhe periudhën gjatë së cilës personi ka shërbyer në këtë funksion.** Mandati I Anëtarëve të Këshillit të Administrimit: - *z. Andrew Walsh,* Fillimi i Mandatit (për herë të parë): 06/02/2018. Mbarimi i Mandatit: 03/08/2024. - *znj. Herjola Spahiu,* Fillimi i Mandatit (për herë të parë): 16/09/2014. Mbarimi i Mandatit: 03/08/2024. - *z. Petr Sastinsky,* Fillimi i Mandatit (për herë të parë): 01.01.2019

	Mbarimi i Mandatit: 03/08/2024. - *z. Tomas Hlavac,* Fillimi i Mandatit (për herë të parë): 16/09/2014. Mbarimi i Mandatit: 03/08/2024. - *znj. Elona Gjika,* Fillimi i Mandatit (për herë të parë): 21/10/2014. Mbarimi i Mandatit: 03/08/2024. Mandati I Administratorëve: - *znj. Herjola Spahiu,* Fillimi i Mandatit (për herë të parë): 01/04/2014. Mbarimi i Mandatit: 31/12/2025. - *z. Ariola Cela,* Fillimi i Mandatit (për herë të parë): 19/12/2017. Mbarimi i Mandatit: 17/02/2024.
Pika 14.2	**Pika 14.2 Informacion rreth kontratave të shërbimit të lidhura midis anëtarëve të këshillit administrativ dhe emetuesit, ku parashikohen përfitime nga zgjidhja e marrëdhënieve të punës ose deklaratën përkatëse për këtë qëllim që nuk ka të tilla përfitime.** NOA deklaron se nuk ka kontrata shërbimi mes saj dhe anëtarëve të Këshillit Administrativ dhe Administratorit në të cilat të parashikohet ndonjë përfitim nga zgjidhja e marrëdhënieve të punës.
Pika 14.3	**Pika 14.3 Informacion rreth komitetit të auditimit dhe komitetit të pagave të emetuesit, përfshi emrat e anëtarëve të komitetit dhe një përmbledhje e rregullave në bazë të të cilave vepron komiteti.** *Komiteti i Auditimit* Është komiteti i cili mbështet Këshillin e Administrimit në përmbushjen e përgjegjësive të tij drejtuese në lidhje me : - Performancën e auditimit dhe kontrollit të brendshëm të shoqërisë; - Eficiencën në sistemin e menaxhimit të riskut; - Përputhshmërinë e shoqërisë me kërkesat rregullatore dhe ligjore si dhe zbatimin e standardeve më të mira; Roli i komitetit është që të këshillojë dhe lëshojë rekomandime për Këshillin e Administrimit brenda fushës së veprimtarisë. Ky komitet faciliton komunikimin mes Keshillit te Administrimit dhe Auditorëve të brendshëm/ jashtëm. Komiteti përbëhet nga : - Elona Gjika, Kryetare e Komitetit; - Elda Toro, Drejtor i Departamentit të Auditit , Anetare; - Kesjana Halili, Anetare e Komitetit. *Komiteti i burimeve Njerëzore* Është organ vendimarrës për cështje që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore, ai përforcon dhe siguron kulturën korporative të NOA dhe vendimarrjen transparente me fokusin primar drejt zhvillimit personal dhe profesional të stafit të NOA. Ky komitet shqyrton ndër të tjera edhe pagat e punonjësve duke marrë vendimet në lidhje me këtë cështje sipas standardeve të pagave që aplikohen në shoqëri. Komiteti përbëhet nga:

	- Herjola Spahiu, CEO, Kryetar i Komitetit; - Blerina Krantja , Drejtori I Departamentit te Burimeve Njerezore, Anëtare; - Drejtori i Departamentit përkatës, Anëtar.
Pika 14.4	**Pika 14.4 Një deklaratë nëse emetuesi është ose jo në përputhshmëri me regjimin/regjimet e drejtimit të brendshëm të shoqërisë/shoqërive tregtare. Në rast se emetuesi nuk është në përputhje me një regjim të tillë, duhet bërë një deklaratë për këtë qëllim, shoqëruar me një shpjegim të arsyeve pse emetuesi nuk vepron në përputhje me këtë regjim.** NOA sha është në përputhje me kërkesat ligjore për funksionimin e qeverisjes korporative si dhe Rregulloreve të Bankës së Shqipërisë në lidhje me funksionimin e Komiteteve mbështetëse të Këshillit. Administrativ.
Pika 14.5	**Pika 14.5 Efektet e mundshme thelbësore në drejtimin e shoqërisë tregtare, përfshi ndryshimet e ardhshme në përbërjen e këshillit dhe të komitetit (nëse për këtë është marrë tashmë vendim nga këshilli dhe/ose nga asambleja e aksionarëve).** NOA sha nuk parashikon asnjë ndryshim të afërt të përbërjes së Këshillit Administrativ apo të Komiteteve në funskion të Këshillit.

RUBRIKA 15 –PUNËMARRËSIT

Pika 15.1	**Pika 15.1 Informacion për numrin e punëmarrësve në fund të periudhës ose mesatarja për secilin vit financiar për periudhën e mbuluar nga të dhënat financiare historike deri në datën e prospektit (dhe ndryshimet e këtij numri, nëse është domethënës) dhe, nëse e mundur dhe me rëndësi, një informacion të detajuar për numrin e personave të punësuar sipas kategorive kryesore të veprimtarisë dhe vendndodhjes gjeografike. Nëse emetuesi punëson një numër të konsiderueshëm punonjësish të përkohshëm, përfshi informacion mbi numrin e punonjësve të përkohshëm gjatë vitit të fundit financiar.** NOA sh.a është një punëdhënës i dedikuar tek rritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i punonjësve të tij, në mënyrë që të lehtësojë komunikimin dhe edukimin financiar të klientëve. Për të përmbushur misionin e vet, NOA përpiqet të jetë një punëdhënës i shanseve të barabarta duke ofruar pozicione të ndryshme pune pa diferencuar apo paragjykuar moshën apo gjininë. Për NOA është e rëndësishme të integrojë në skuadrën e saj staf të kualifikuar dhe profesional të cilët karaterizohen nga energjia, dinamizmi, aftësia për t'u integruar me vlerat korporative dhe pasioni per t'u rritur. Mosha mesatare e punonjësve të shoqërisë është 35 vjec dhe 58% e stafit përbëhet nga femra.

	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022
Numri stafit total në fund të periudhës	262	257	279	306
Staf në Zyrat Qendrore	**87**	**88**	**91**	**106**
Staf në Degë, nga të cilët	**175**	**169**	**188**	**200**
Drejtore Degësh/Agjensie	21	21	21	21
Oficerë Kredie	88	82	98	111
Oficerë të mbledhjes së kredive	28	22	18	18
Shërbim klientele/ Arkëtar	29	35	41	42
Staf mbështetës/administrativ	9	9	10	8

Institucioni, për vetë natyrën e aktivitetit, nuk punëson punonjës të përkohshëm, por përkundrazi, NOA, me politika dhe procedura të ndryshme si dhe me aktivitete e nisma motivuese, mundohet e zgjasë sa më shumë të jetë e mundur rrugëtimin e stafit brenda shoqërisë.

Pika 15.2	**Pika 15.2 Pjesëmarrjet në kapital dhe mundësitë për aksione.** **Për çdo person të përmendur në pikën 12.1, të jepet informacionin për aksionet që zotërojnë apo mundësi për të tilla aksione të emetuesit në datën më të fundit të mundshme.** Anëtarët e Këshillit Administrativ dhe Drejtuesit e lartë të shoqërisë nuk zotërojnë aksione në kapitalin e NOAs. Gjithashtu, NOA nuk ka parashikuar në politikat e saj të shpërblimit ndonjë përfitim në formën e aksioneve të shoqërisë për anëtarët e organeve të saj drejtuese apo edhe kategorive të tjera të stafit. Struktura aksionare e shoqërisë paraqitet në Kreun I, Rubrika 2 pika 1.3 të këtij Prospekti.
Pika 15.3	**Pika 15.3 Përshkrim i marrëveshjeve për përfshirjen e punonjësve në kapitalin e emetuesit.** Si në datën e këtij Prospekti, nuk ekzistojnë marrëveshje për përfshirjen e punonjësve në kapitalin e shoqërisë.

RUBRIKA 16 -AKSIONARËT ME PJESËMARRJE TË LARTË

Pika 16.1	**Pika 16.1 Për sa ka dijeni emetuesi, duhet të jepet emri i çdo personi, që nuk është anëtar i organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse, i cili, drejtpërdrejt ose tërthorazi, zotëron interes në kapitalin ose të drejtat e votës së emetuesit, që duhet njoftuar në bazë të ligjit, së bashku me informacionin për vlerën e interesit të secilit prej këtyre personave në datën e prospektit ose, nëse nuk ka persona të tillë, të lëshohet një deklaratë për këtë qëllim që nuk ka asnjë person të tillë.** Aksionarët e NOA sha janë identifikuar plotësisht, deri tek pronarët përfitues fundorë, në Kreun I, Rubrika II, pika 1.3 e këtij Prospekti. NOA gjithashtu, përmbush në mënyrë të rregullt detyrimin e saj ligjor për raportimin e pronarëve përfitues pranë QKB, në bazë dhe në përputhje të parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
Pika 16.2	**Pika 16.2 Nëse aksionarët me pjesëmarrje të lartë në kapitalin e emetuesit kanë ose jo të drejta të ndryshme vote ose një deklaratë për këtë qëllim që nuk ka të tilla të drejta vote.** Aksionarët gëzojnë të drejta vote në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre në kapital, në bazë e në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë. Statuti i NOA sha është pjesë e listës së dokumentacionit që investitori i këtyre obligacioneve mund të tërheqë së bashku me Prospektin e obligacioneve.
Pika 16.3	**Pika 16.3 Për sa ka dijeni emetuesi, të deklarohet nëse emetuesi është drejtpërdrejt ose tërthorazi nën pronësinë ose kontrollin e të tjerëve dhe të kujt, si dhe të përshkruhet natyra e kontrollit dhe masat që janë marrë për të siguruar që nuk do të ketë abuzime me këtë kontroll.** NOA sh.a. është një shoqëri e kontrolluar nga subjekte të specializuara në fushën e shërbimeve financiare dhe të cilat kanë eksperiencë të gjatë në sektorin financiar në tregje të ndryshme në zhvillim, në disa kontinente. NOA Holdings NV, aksionare e 99.9986% e kapitalit aksionar të NOA sha , është një shoqëri aksionare me një staf të vogël udhëheqës dhe të kualifikuar të cilët punojnë ngushtë dhe në mënyrë aktive me skuadrën lokale të menaxhimit të NOA sha me qëlim ofrimin e mbështetjes së nevojshme për një rritje të vazhdueshme të biznesit dhe përmbushjen e objektivave të shoqërisë. BFSE Holding BV dhe Creation Investment Social Ventures Fund, shoqëritë që zotërojnë NOA Cooperatief U.A (aksionare e Noa Holdings B.V) janë shoqëri të specializuara në menaxhimin e investimeve private dhe administrimin e kapitaleve private në industrinë e shërbimeve financiare, në vende të ndryshme. Në saj të njohurive të thella dhe eksperiencës së gjerë në fushën e sektorit bankar e financiar, këto shoqëri marrin vendime për investime në subjekte (që operojnë në industrinë e sherbimeve financiare) me potencial të lartë zhvillimi, ekzekutimin e strategjive të blerjeve-bashkimeve, financimin nëpërmjet huave të instucioneve mikrofinanciare dhe bizneseve të vogla me qëllim krijimin e një impakti pozitiv në ekonomitë lokale.

	Aksionarët e NOAs, duke qënë subjekte zhvilluese dhe mbështetëse të shoqërive që veprojnë në industrinë financiare, synojnë rritjen e kapaciteteve të NOAs, përmirësimin e përfitueshmërisë së saj si dhe gjenerimin e një impakti pozitiv socialo-ekonomik në zonat ku institucioni është prezent. Përgjegjësitë, funksionet, të drejtat e detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve përcaktohen shumë qartë në Statutin e shoqërisë si dhe janë në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Përputhshmëria e rregullave të funksionimit të Asamblesë së Aksionarëve, të drejtave e detyrimeve të tyre me parashikimet ligjore në fuqi, garantojnë mungesën e abuzimeve gjatë kontrollit të shoqërisë.
Pika 16.4	**Pika 16.4 Përshkrim i marrëveshjeve, për sa ka dijeni emetuesi, zbatimi i të cilave mund të sjellë më pas ndryshim të kontrollit të emetuesit.** Në dijeninë më të mirë të Drejtuesve të NOAs, nuk ka marrëveshje të tilla në fuqi, zbatimi i të cilave mund të sjellë ndryshim të kontrollit të Emetuesit.

RUBRIKA 17 TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Pika 17.1 Duhen paraqitur, në përputhje me standardin përkatës, të dhëna për transaksione të kryera nga emetuesi me palë të lidhura gjatë periudhës së mbuluar nga të dhënat e pasqyrave financiare historike deri në datën e prospektit.

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë së saj Shoqëria ka hyrë në transaksione të ndryshme biznesi me palët e lidhura. Palët e lidhura, duke përfshirë kompensimin për drejtuesit, me të cilat Shoqëria ka kryer transaksione biznesi janë si më poshtë:

Pika 17.1

(vlerat janë në mijë Lekë)	2022	2021	2020
Detyrimet në fund të vitit			
Llogari të pagueshme për NOA Holding N.V	-	-	22,266
Transaksionet në fund të vitit			
Komisione për drejtimin për NOA Holdings N.V	4,272	25,505	25,875
Të drejta shfrytëzimi për NOA Holdings N.V.	2,800	2,889	2,931
Shpërblimi i drejtimit të lartë dhe Anëtarët e Këshillit	68,034	62,082	58,385

Komisionet per drejtimin nga NOA Holdings N.V perfaqeson sherbimin e konsulences per produketet dhe manaxhimin e aktivitetit te kredidhenies.
Te drejtat e shfrytezimit per NOA Holding N.V perfshijne "Honoraret" ("Royal Fee") te lidhura me perdorimin e sistemit SASPO.

Shpërblimi për drejtorët ekzekutivë dhe anëtarët e bordit përfaqëson shpërblimin e ekipit të lartë të menaxhimit dhe tarifat e menaxhimit të aplikueshme për anëtarët e bordit.
Vlerat e mësipërme janë 0.0047% e të ardhurave te shoqërisë.

RUBRIKA 18- TË DHËNAT FINANCIARE MBI AKTIVET, PASIVET, GJENDJEN FINANCIARE DHE FITIMET E HUMBJET E EMETUESIT

Pika 18.1

Pika 18.1 Të dhënat historike financiare

Pasqyrat Financiare të Audituara për vitet 2020-2022, së bashku me Opinionet e Audituesve të Pavarur dhe Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare, bashkëlidhur këtij Prospekti, paraqesin të gjithë informacionin financiar të nevojshëm për investitorin

Pika 18.2

Pika 18.2 Të dhënat e përkohshme financiare dhe të tjera.

Më poshtë, paraqitet Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar si dhe Pasqyra Individuale e Fitim-Humbjes për periudhën e ndërmjetme 31.03.2023. Pasqyrat e mëposhtme janë të pa-audituara!

BILANCI *(shifrat në "mijë Lekë")*	31 Dhjetor 2022	31 Mars2023
AKTIVET	(I audituar)*	(Paraprak, I pa audituar)
Mjete monetare	608,744	517,112
Kredi për institucionet financiare	105,563	147,898
Kredi dhe paradhënie për klientët	6,913,435	7,421,767
Inventar dhe asete te tjera	90,488	94,315
Aktive afatgjata materiale	202,346	206,660
Aktive afatgjata jomateriale		
Investime ne filial	35,031	35,031
Aktive tatimore të shtyra	24,644	24,644
Totali i Aktiveve	**7,980,252**	**8,447,427**
DETYRIMET DHE KAPITALI		
Detyrimet		
Grante		
Detyrime tatimore	16,915	
Detyrime të tjera	239,009	308,806
Obligacione të Emetuara		
Huamarrje	5,605,951	6,139,913
Totali i Detyrimeve	**5,861,875**	**6,448,719**
Kapitali		
Kapitali i nënshkruar	731,838	731,838
Rezerva ligjore	73,184	73,184
Fitimi i pashpërndarë	1,313,355	1,193,686
Totali i Kapitalit	**2,118,377**	**1,998,708**
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit	**7,980,252**	**8,447,427**

* pasqyra financiare individuale

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET *(në mijë Lekë)*	31 Dhjetor 2022 (te audituara)*	31 Mars 2023 (Paraprake, te pa audituara)
Të ardhura nga interesi	1,479,629	409,829

Shpenzime interesi	-336,396	-108,422
Të ardhura neto nga interesi	**1,143,233**	**301,408**
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	103,047	21,867
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet	-2,276	-569
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	**100,770**	**21,298**
Rikuperimet nga kreditë e fshira	94,185	28,730
Të ardhura të tjera	13,288	7,678
Te ardhura operacionale neto	**1,351,477**	**36,408**
Shpenzime personeli	-423,588	-100,216
Shpenzime të tjera	-187,652	-66,165
Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhëniet për klientët	-196,047	-73,339
Amortizimi i pajisjeve	-70,910	-20,958
Zhvlerësimi i aktiveve jomateriale	-9,348	-2,337
Fitim/ (humbje) nga kursi i këmbimit	8,160	-615
Totali i shpenzimeve	**-879,384**	**-263,629**
Fitimi para tatimit	**472,092**	**95,485**
Shpenzime tatimore	-72,821	-15,584
Fitimi i Vitit/Periudhës	**399,271**	**79,901**

* pasqyra financiare individuale

Pika 18.3

Pika 18.3 Auditimi i të dhënave historike financiare vjetore.

I gjithë informacioni financiar, në formën e pasqyrave financiare, i paraqitur në këtë Prospekt, përvec atij të paraqitur në pikën 18.2 më sipër "Të dhënat e përkohshme financiare", është informacion i audituar nga Audituesit e jashtëm të pavarur.

Pika 18.4.1

Pika 18.4.1 Politika e dividendëve.

Përshkrim i politikës së emetuesit për shpërndarjen e dividendëve dhe kufizimet e saj. Nëse emetuesi nuk e ka një politikë të tillë, të përfshihet pasqyra përkatëse me vlerë negative.

NOA ka një politikë të brendshme lidhur me shpërndarjen e dividendit në rradhën e aksionarëve të saj.Në bazë të kësaj politike, pas përfundimit të procesit të auditimit të pasqyrave financiare, Drejtimi i shoqërisë mund të propozojë shpërndarje të dividendit por jo më shumë se 50% të fitimit të audituar të shoqërisë pasi është zbritur vlera monetare për rezerva ligjore.

Gjatë situatës së pandemisë Covid-19, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, më 08.04.2020 mori një vendim për pezullimin e shpërndarjes së fitimit të realizuar gjatë vitit 2019 nga institucionet të mbikëqyrura deri në Qershor të vitit 2020. NOA ka zbatuar vendimin e Bankës së Shqipërisë dhe ka ndjekur të njëjtën politikë edhe për vitet 2020 dhe 2021, pra nuk ka shpërndarë dividend në vitet 2020 dhe 2021.
Asambleja e përgjithshme vendosi më 30 Qershor 2022 dhe 15 Nëntor 2022 të paguajë dividentët si më poshtë:

(*vlerat janë në mijë Lekë*)	2022	2021	2020
NOA Holdings NV	156,536	-	-
NOA Cooperatief U.A	2	-	-
Dividend i shpërndarë	156,538	-	-

Pika 18.4.2

Pika 18.4.2 Vlera e dividendit për aksion për secilin vit financiarpër periudhën që mbulojnë të dhënat financiare historike.

Më poshtë paraqitet fitimi për aksion dhe dividendi i paguar aksionarëve:

(*vlerat janë në mijë Lekë*)	2022	2021	2020
Numri i Aksioneve	73,183	73,183	73,183
Fitimi për Aksion (mijë Lekë)	5.5	4.4	3.8
Vlera e dividendit të paguar (mijë Lekë)	156,538	-	-
Vlera e dividendit për aksion (mijë Lekë)	2.14	-	-

Pika 18.5

Pika 18.5 Proceset ligjore dhe të arbitrazhit. Informacion për çdo procedurë shtetërore, ligjore ose arbitrazhi (përfshi procese që janë ende të papërfunduara apo që pritet të fillojnë, për të cilat emetuesi ka dijeni) gjatë një periudhe që shtrihet të paktën gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit, që mund të ketë ose ka pasur në të shkuarën e afërt pasoja të konsiderueshme mbi gjendjen financiare ose fitimet e emetuesit dhe/ose grupit ose të paraqitet pasqyra përkatëse me vlerë negative.

Shoqëria, si në datën e këtij Prospekti, është përfshirë në disa procese gjyqësore të papërfunduara të cilat rrjedhin nga aktiviteti i zakonshëm i biznesit. Asnjë prej këtyre proceseve gjyqësore nuk ka rëndësi thelbësore për mbarëvajtjen e aktivitetit të NOAs apo për reputacionin e shoqërisë. Në bazë të analizave dhe këshillave të ekipit ligjor të brendshëm, Drejtimi i shoqërisë ka pritshmëri pozitive për përmbylljen e procesve në favor të NOAs. Edhe në skenarin më pesimist, përmbyllja e tyre në favor të palëve të tjera do ti shkaktonte NOAs lindjen e një detyrimi maksimal prej rreth 4 milionë Lekë.

PROCESE GJYQESORE	VITI 2020		VITI 2021		VITI 2022	
	Nr	Provigjone ligjore (shuma)	Nr	Provigjone ligjore (shuma)	Nr	Provigjone ligjore (shuma)
Marredhenie Punesimi	15	6,351,341	11	4,710,724	10	2,070,640
Marredhenie Detyrimi me Kliente	29	187,014	20	94,491	20	80,667
Marredhenie Detyrimi me Pale te 3-ta	10	1,053,181	10	1,053,181	8	1,901,264
Total	54	7,591,536	41	5,858,395	38	4,052,571

Në të kaluarën, nuk ka patur procese gjyqësore me pasoja të rëndësishme mbi gjendjen financiare apo fitimin e shoqërisë. Referuar të ardhmes së afërt, NOA nuk pret çeljen e ndonjë procesi gjyqësor i cili mund të jetë me pasoja të konsiderueshme financiare.

RUBRIKA 19- INFORMACION SHTESË

Pika 19.1

Pika 19.1Kapitali aksionar.Informacioni i parashikuar në pikat 18.1.2 deri në 18.1.2 për të dhënat financiare historike deri në datën e bilancit më të fundit.

Kapitali aksionar i nënshkruar i shoqërisë, si ë fundin e vitit 2022, është 731.838.781,96 Lekë. Më poshtë tabela përmbledhëse me të dhënat e kapitalit total të shoqërisë për tre vitet e fundit.

Kapitali *(mijë Lekë)*	2022	2021	2020
Kapitali i nënshkruar	731,838	731,838	731,838
Rezerva ligjore	73,184	64,027	50,067
Fitimi i pashpërndarë	1,313,355	1,079,778	771,434
Totali i Kapitalit	**2,118,377**	**1,875,643**	**1,553,339**

Në datë 30 Qershor 2022 Asambleja e Aksionareve vendosi të krijojë një rezerve ligjore 9 milionë Lekë duke arritur nivelin maksimal të rezervës ligjore në 10% të kapitalit të neshkruar. Asambleja gjithashtu vendosi, me vendimet e saj datë 30.06.2022 dhe 15.11.2022 të shpërndajë dividend për aksionarët në vlerën totale prej 156,5 milionë Lekë.
Në datë 30 Mars 2023 Asambleja e Aksionareve vendosi të shpërndajë dividend për aksionarët në vlerën 199,5 milionë Lekë.

Pika 19.1.1

Pika 19.1.1 Shuma e kapitalit të emetuar dhe për çdo klasë të aksioneve përfshin: (a) numrin total të aksioneve të emetuesit; (b) numrin e aksioneve të emetuara dhe të paguara plotësisht dhe të emetuara, por jo të paguara plotësisht; (c) vlerën nominale për aksion ose aksionet që nuk kanë vlerë nominale dhe 31 (d) një rakordim të numrit të aksioneve të papaguara në fillim dhe në fund të vitit financiar.

- Shuma totale e kapitalit aksionar të emetuar është 731.838.781,960 Lekë;
- Numri total i aksioneve është 73.183;
- Vlera nominale e një aksioni është 10.000,120 Lekë;
- Aksionet e NOA sha janë të gjitha të llojit “aksione të zakonshme” (NOA nuk ka aksione preferenciale);
- Aksionet e NOA sha janë të gjitha të llojit “me të drejtë vote”;
- Të gjitha aksionet e NOAs janë të shlyera plotësisht (nuk ka aksione të papaguara në fillim dhe fund të vitit).

Pika 19.1.2

Pika 19.1.2 Një historik të kapitalit aksionar, që nxjerr në pah informacionet mbi ndryshimet e ndodhura për periudhën që mbulon të dhënat financiare historike.

Gjatë tre viteve të fundit, nuk ka ndryshime në vlerën e kapitalit aksionar të NOAs pasi nuk është ndërmarrë ndonjë operacion shtimi apo zvogëlimi kapitali.

Pika 19.2 19.2.1	**Pika 19.2.1 Akti i Themelimit dhe Statuti. Regjistrimi në regjistrin tregtar, numri i regjistrimit, nëse ka dhe një përshkrim i shkurtër i objektivave dhe qëllimeve të emetuesit dhe se ku mund të gjenden këto të dhëna në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.** NOA , është e regjistruar pranë Regjistrit Tregtar në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me vendimin Nr. 25341, datë 2 Mars 2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT K11604002V. Data e themelimit : 26.02.2001 Data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar (QKB): 04.04.2001. Personaliteti juridik: shoqëria është e formës shoqëri anonime (sh.a.) me afat të caktuar 50 vjeçar dhe vepron si Institucion Financiar Jo-Bankë, në përputhje me Licencën e Aktivitetit nr. 09, datë 06.06.2007 lëshuar nga Banka e Shqipërisë si dhe Licencën nr.701, datë 27.06.2016, për veprimtarinë e Agjentit në sigurime lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Licencat nuk janë të kufizuara në kohë dhe nuk janë të transferueshme ose tjetërsueshme. Objektivi i shoqërisë është ushtrimi i veprimtarive financiare të mëposhtë listuara: • Të gjitha format e kredidhënies, • Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave, • Ofrimi i garancive, • Këmbim valutor, • Agjent në sigurime (në përputhje edhe me licencën Nr.701, datë 27.06.2016 lëshuar nga AMF), • Etj Ky objekt i veprimtarisë së shoqërisë reflektohet në nenin 6 të Aktit të Themelimit dhe në nenin 6 të Statutit të shoqërisë. Akti i Themelimit dhe Statuti i NOAs janë dokumenta që i vihen në dispozicion investitorit potencial.
Pika 19.2.2	**Pika 19.2.2 Kur ka më shumë se një klasë aksionesh, një përshkrim i të drejtave, preferencave dhe kufizimeve që lidhen me secilën prej tyre**. Aksionet e NOAs janë të gjitha të klasës "aksione të zakonshme" pra aksione të cilat i japin të drejtën aksionarit të marrë pjesë në fitimet e shoqërisë (në raport me numrin e aksioneve që ai zotëron) dhe në rast likuidimi të drejtën e pjesëmarrjes në asetet e mbetura te shoqërisë (neni 13 i Statutit). Çdo aksion i jep aksionarit të drejtën e një vote (neni 11 i Statutit) në mbledhjen e asamblesë së aksionarëve.
Pika 19.2.3	**Pika 19.2.3 Një përshkrim i shkurtër i çdo dispozite të aktit themelues, statutit apo akteve të brendshme të emetuesit, që do të kishin për pasojë vonimin, shtyrjen ose pengimin e një ndryshimi në kontrollin e emetuesit.** Në nenin 12 të Statutit të shoqërisë parashikohen kushtet si vijon për transferimin e aksioneve: 12.1. Në rastin kur një aksioner dëshiron të transferojë te gjitha ose një pjesë të aksioneve të tij, është i detyruar të njoftojë me shkrim Këshillin e Administrimit, duke i bërë të ditur vlerën nominale të aksioneve me qëllim që aksionerët e tjerë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes. Këshilli i Administrimit njofton me shkrim aksionerët e tjerë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit për një transferim të tillë. 12.2. Aksionerët e tjerë duhet të njoftojnë Këshillin e Administrimit 3 (tre) muajve nëse ata do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes apo jo. 12.3. Në rast se numri i aksionarëve që dëshirojnë të blejnë aksione është me i madh se një, ata do te marrin aksione ne përpjesëtim me numrin e aksioneve që zotërojnë. 12.4. Transferimi i aksioneve në ndryshim me sa është parashikuar në këtë nen do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të prodhojë efekte ligjore për shoqërinë.

RUBRIKA 20- KONTRATAT THEMELORE

20.1	**Përmbledhje të secilës kontratë themelore, që nuk është kontratë e lidhur gjatë veprimtarisë së zakonshme tregtare, ku emetuesi ose anëtarët e grupit janë palë gjatë dy viteve të fundit që i paraprijnë publikimit të prospektit. Një përmbledhje e çdo kontrate tjetër (që nuk është kontratë e lidhur gjatë aktivitetit të zakonshëm tregtar), e lidhur nga çdo anëtar i grupit, e cila përmban dispozita sipas të cilave çdo anëtar i grupit ka detyrime ose të drejta, që, në datën e prospektit, ka rëndësi thelbësore për grupin.** NOA nuk ka kontrata themelore të lidhura jashtë kuadrit të veprimtarisë së zakonshme tregtare.

RUBRIKA 21 -DOKUMENTET NË DISPOZICION

Pika 21	Pika 21 Dokumentacioni shoqërues Ky Prospekt shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm, paraqitur secili në formën e anekseve të Prospektit: - Pasqyrat Financiare të Audituara për tre vitet e fundit, Opinioni i Audituesve të Pavarur për to dhe Shënimet Shpjeguese - ANEKS Nr.1 - Akt Themelimi dhe Statuti i NOA sha- ANEKS Nr.2 - Kërkesa tip për blerjen e obligacionit –ANEKS Nr.3 - Deklarata tip e investitorit- ANEKS Nr.4
Pika 21.1	Pika 21.1 Një deklaratë se përgjatë afatit të vlefshmërisë së prospektit, lista e dokumentave të mëposhtëm mund të kontrollohet nga investitorët. Përgjatë vlefshmërisë së Prospektit, investitorët/obligacionmbajtësit kanë të drejtë të aksesojnë ose të pajisen me variantin më të fundit në fuqi të dokumentave të mëposhtëm: - Akt themelimi dhe Statut i NOA sha, në variantin e tyre të fundit ; - Pasqyrat Financiare të Audituara për cdo vit financiar përgjatë jetëgjatësisë së obligacionit (2022-2026); - Pasqyrat Financiare ende të paaudituara, për cdo vit financiar përgjatë jetëgjatësisë së obligacionit (2022-2026); - të gjitha raportet, letrat dhe dokumentet, vlerësimet dhe deklaratat e tjera të përgatitura nga ekspertët me kërkesë të emetuesit, pjesë e të cilave janë përfshirë ose përmendur në dokumentin e regjistrimit;të dhënat financiare historike të emetuesit ose, në rastin e grupit, të dhënat historike financiare për emetuesin dhe shoqëritë e kontrolluara të tij, për secilin prej dy viteve financiareqë i paraprijnë datës së publikimit të dokumentit të regjistrimit. Investitori mund të sigurojë informacionin dhe dokumentacionin e mësipërm nëpërmjet një kërkese në adresën info@noafin.al si dhe në faqen zyrtare të internetit www.noafin.al.

KREU III – SHËNIMI MBI TITULLIN

RUBRIKA 1 – PERSONAT PËRGJEGJËS, INFORMACIONI NGA PALËT E TRETA, RAPORTET E EKSPERTËVE DHE MIRATIMI NGA AUTORITETI KOMPETENT

Pika 1.1	**Pika 1.1 Personat përgjegjës për informacionin ose pjesë të tij, që paraqitet në këtë Prospekt.** Personat përgjegjës për informacionin e paraqitur në këtë Prospekt listohen si më poshtë: - **Zj.Herjola Spahiu** –Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Nën Kryetar i Këshillit të Administrimit pranë NOA sh.a.. Zj.Spahiu është përgjegjëse për informacionin mbi emetuesin, përshkrimin e shoqërisë dhe aktivitetit që ajo ushtron, si dhe prirjet dhe strategjitë e institucionit. Zj.Spahiu është gjithashtu përgjegjëse për rishikimin e të gjithë informacionit të paraqitur në këtë Prospekt nga personat e tjerë të punësuar pranë NOA, të përmendur më poshte. - **Zj.Ariola Çela**- Drejtor i Departamentit të Financës pranë NOA sh.a.. Zj.Çela është personi përgjegjës për informacionin financiar mbi institucionin NOA duke përfshirë përshkrimin dhe analizën e situatës financiarë aktuale të institucionit, projeksionet financiare të së ardhmes etj si dhe për përshkrimin e tipareve të titujve. Pjesë të Prospektit të paraqitur nga Zj.Çela : KREI I- Rubrika 2, pika 2, Rubrika 3, Rubrika 4; Kreu II-Rubrika 7, Rubrika 11, Rubrika 13 dhe Rubrika 18. - **Zj.Albana Pelinku**- Drejtor i Departamentit të Riskut dhe Përputhshmërisë pranë NOA sh.a. Zj.Pelinku është përgjegjëse për informacionin mbi rreziqet e emetuesit dhe informacionin mbi cilësinë e portofolit të kredisë së NOA-s. Pjesë të Prospektit të paraqitura nga Zj.Pelinku janë: KREU I, Rubrika 2, pika 2 (informacioni mbi cilësinë e portofolit) dhe pika 3; Kreu II, Rubrika 3, Rubrika 9 dhe Rubrika 17. - **Grant Thornton SH.P.K.**, me NIPT K91923007M, dhe adresë në rrugën "Sami Frasheri", Kompleksi T.I.D, Hyrja B. Kati I, Tiranë, Shqipëri, në cilësinë e audituesit të pavarur të Pasqyrave Financiare të viteve 2021 dhe 2020, është përgjegjës për Opinionin e dhënë mbi Pasqyrat Financiare të audituara prej tij, bashkëlidhur këtij Prospketi .

Pika 1.2

Pika 1.2 Një deklaratë nga personat përgjegjës për prospektin që, në dijeninë e tyre, informacioni që përfshihet në prospekt është në përputhje me faktet.

1. Deklarata e Zj.Herjola Spahiu - Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv i NOA sh.a.

DEKLARATË

Unë e nënshkruara, Herjola Spahiu, e bija e Veliut, lindur më 27.07.1978, identifikuar me dokumentin Letërnjoftim me Nr. 033989848 dhe Nr. Personal H85727135S, deklaroj me përgjegjësinë time të plotë se, në dijeninë time më të mirë, i gjithë informacioni dhe të dhënat që gjenden në këtë prospekt përbëjnë paraqitjen e plotë të aktiveve dhe pasiveve, fitimeve dhe humbjeve, situatës financiare dhe veprimtarive reale të emetuesit (”NOA”), të të drejtave që lidhen me titullin që do t’i ofrohet publikut dhe do të pranohet për t’u tregtuar në një treg të rregulluar dhe se i gjithë informacioni dhe data e paraqitur këtu janë të sakta e korrekte dhe se nuk është hequr asnjë informacion apo të dhëna që ndikojnë në saktësinë dhe tërësinë e

Znj. Herjola Spahiu

Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv i NOA sh.

2. Deklarata e Zj.Ariola Çela- Drejtor i Departamentit të Financës, NOA sh.a.

DEKLARATË

Unë e nënshkruara, Ariola Çela, e bija e Astrit Çela, lindur më 05.06.1983, identifikuar me dokumentin Letërnjoftim me Nr. 035022406 dhe Nr. Personal I35605134I, deklaroj me përgjegjësinë time të plotë se, në dijeninë time më të mirë, informacioni që përfshihet në pjesët e Prospektit për të cilat unë jam përgjëgjëse, është i saktë, i plotë dhe në përputhje me faktet. Deklaroj gjithashtu se nuk është lënë pa përfshirë asnjë informacion, fakt apo e dhënë që do të cënonte plotësinë dhe vërtetësinë e këtij Prospekti.

Zj. Ariola Çela

Drejtor i Departamentit të Financës pranë NOA sh.a.

3. Deklarata e Zj.Albana Pelinku- Drejtor i Departamentit të Riskut dhe Përputhshmërisë, NOA sh.a

DEKLARATË

Unë e nënshkruara, Albana Pelinku, e bija e Gezim Pelinku, lindur më 30.12.1980, identifikuar me dokumentin Letërnjoftim me Nr.034882410dhe Nr. Personal I06230077F deklaroj me përgjegjësinë time të plotë se, se në dijeninë time më të mirë, informacioni që përfshihet në pjesët e Prospektit për të cilat unë jam përgjëgjëse, është i saktë, i plotë dhe në përputhje me faktet. Deklaroj gjithashtu se nuk është lënë pa përfshirë asnjë informacion, fakt apo e dhënë që do të cënonte plotësinë dhe vërtetësinë e këtij Prospekti.

Zj. Albana Pelinku

Drejtor i Departamentit të Riskut dhe Përputhshmërisë pranë NOA sh.a

Pika 1.3

Pika 1.3 Deklarata nga ekspertë të jashtëm

Deloitte Legal, pjesë e Deloitte Albania sh.p.k. është përfshirë si ekspert i jashtëm për rishikimin e përmbajtjes së prospektit në përputhje me legjislacionin ne fuqi.

Deloitte Albania shpk, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi te subjektit (NUIS) J62329003N, me seli në adresën "Rruga e Kavajës", Ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3, Tiranë, Shqipëri.
Deloitte Legal shpk, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi te subjektit (NUIS) L71723007F, me seli në adresën "Rruga e Kavajës", Ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3, Tiranë, Shqipëri.
Deloitte Albania dhe Deloitte Legal kane eksperiencë të konsiderueshme në këshillim ligjor dhe financiar e cila daton prej vitit 1996. Nëpërmjet inputit rishikues të tyre pritet të reflektohet një qasje bazuar në praktika të ngjashme evropiane.
Angazhimi i Deloitte Legal dhe Deloitte Albania është bërë me kërkesë të NOA-s për rishikimn e permbajtjes së prospektit sipas legjislacionit në fuqi.

1.Deklarata nga Zj.Sabina Lalaj-Administrator i Deloitte Legal

DEKLARATË

Unë e nënshkruara, Sabina Lalaj, identifikuar me dokumentin e identifikimit me nr. personal H85605095K, në cilësinë e administratorit deklaroj se Deloitte Legal është angazhuar si ekspert i jashtëm për rishikimin e përmbajtjes së prospektit në përputhje me legjislacionin ne fuqi. Angazhimi i Deloitte Legal është bëre me kërkesë të NOA. Në çdo rast, përgjegjësia për përmbajtjen dhe formën e këtij prospekti, mbetet e NOA.

Sabina Lalaj

Administrator i Deloitte Legal

2. Deklarata nga Zj.Albana Shahu-Administrator i Deloitte Albania

DEKLARATË

Unë e nënshkruara, Albana Shahu, identifikuar me dokumentin e identifikimit me nr. personal I36022089P, në cilësinë e administratorit deklaroj se Deloitte Albania është angazhuar si ekspert i jashtëm për rishikimin e përmbajtjes së prospektit në përputhje me legjislacionin ne fuqi. Angazhimi i Deloitte Albania është bëre me kërkesë të NOA. Në çdo rast, përgjegjësia për përmbajtjen dhe formën e këtij prospekti, mbetet e NOA.

Albana Shahu

Administrator i Deloitte Albania

Pika 1.4	**Pika 1.4 Informacioni i marrë nga palë të treta.** Informacioni mbi tregun/sektorin bankar e financiar është marrë nga faqet zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë. Kështu, të dhënat mbi NPL ("non performing loans"- kredi me probleme +90 ditë), Portofol Kredie, Asete, Kthimit nga Asetet (ROA), Kthimi nga Kapitali (ROE) të tregut të institucioneve financiare Jo-Banka

	janë riprodhuar saktësisht sipas përmbajtjes së tij në brendësi të Raporteve Vjetore të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë. (https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Raportet_Vjetore_te_Mbikeqyrjes_Bankare/) Të dhënat mbi peshën realtive të NOA ndaj tregut dhe renditja e saj në këtë treg janë kalkuluar duke u mbështetur në të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë në Raportin Vjetor të Mbikëqyrjes 2021 si dhe informacionin mbi Portofolin e Kredisë së Institucioneve Financiare Jo-Banka sic paraqitur në Pasqyrat e tyre Financiare të audituara për vitin 2021 dhe të publikuara në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

RUBRIKA 2 - FAKTORËT E RREZIKUT

Pika 2.1	Pika 2.1 Rreziqet kryesore që janë specifike për titujt 1. Rreziku i kredisë (kundërpartisë)/mosshlyerjes Investitorët, nëpërmjet blerjes së obligacioneve të emetuara nga NOA bëhen financues /kreditorë të këtij subjekti, duke u ekspozuar ndaj rrezikut të mos kthimit të financimit të tyre nga emetuesi. Pa-aftësia paguese dhe/ose falimenti i emetuesit janë risqe që shoqërojnë cdo lloj investimi në tituj borxhi apo edhe kapitali. NOA përmes të gjitha vendimmarrjeve të saj synon vetëm rritjen e qëndrueshme dhe fuqizimin e mëtejshëm të institucionit ndaj paratë që do të mblidhen nga oferta e obligacioneve do të përdoren me qëllim rritjen e volumit të kreditimit të klientëve të saj. Injektimi i "parasë së re" në aktivitetin kredidhënës të NOA-s, do të rrisë asetin më të rëndësishëm të shoqërisë (pasi është ai që gjeneron të ardhurat), portofolin e kredisë. Ekipi menaxherial i NOA ka drejtuar dhe do të vazhdojë të drejtojë shoqërinë duke zbatuar parimet më të mira të qeverisjes dhe duke ndjekur kurdoherë strategjinë e rritjes së kujdesshme dhe të mirë-studiuar, për të zvogëluar në maksimum gjasat e problemeve financiare që mund të conin në ngjarje falimenti apo pa-aftësie paguese. Sikurse vërtetohet nga të dhënat financiare të paraqitura në këtë Prospekt si dhe Pasqyrat Financiare të audituara (bashkëlidhur Prospektit) , NOA ka një biznes të konsoliduar dhe gëzon një nivel të lartë shëndeti financiar. Informacioni i mëposhtëm përshkruan në mënyrë domethënëse situatën financiare të shoqërisë: - NOA ka rezultuar me fitim, cdo vit financiar përgjatë gjithë 11 viteve të fundit; - Fitimi i NOAs ka ardhur në rritje të vazhdueshme e të ndjeshme prej vitit 2014 e në vijim; - Fitimi mesatar i 10 viteve të fundit rezulton rreth 200 milionë Lekë (ose rreth 1,7 milionë Euro), fitimi mesatar i 5 viteve të fundit rezulton rreth 290 milionë Lekë (ose rreth 2,5 milionë Euro) dhe ai mesatar i 3 viteve të fundit është rreth 336 milionë Lekë (ose rreth 2,9 milionë Euro). Përmirësimi i vazhdueshëm i përformancës financiare të institucionit, edhe në kushtet e konkurrencës së fortë mes institucioneve kredidhënëse Jo-Banka, dëshmon menaxhimin e suksesshëm të aktivitetit nga ekipi drejtues profesionist dhe vizionar i NOA-s. *1.1 Risku i mungesës së garancisë*

Duke qene se obligacionet e emetuara nga NOA janë të pagarantuara, investitori përballet me një rrezik më të lartë të humbjes së pjesshme ose të plotë të vlerës së investuar prej tij në Obligacionet e NOA-s. Nëse obligacionet do të ishin të garantuara, investitorët do të mund të përfitonin vlerën monetare nga ekzekutimi i garancisë se obligacioneve në rast dështimi pagese nga emetuesi, por këto obligacione që NOA emeton sipas këtij Prospekti janë të pagarantuara ndaj nëse emetuesi nuk do të mund të paguajë kuponët dhe /ose principalin, pra dështon në pagesa, atëhere investitori do të përballet me një rrezik më të lartë të humbjes së investimit të tij.

1.2 Risku i statusit të obligacionit si " i nënrenditur"

Në rastin e shpalljes së paaftesisë paguese nga NOA, obligacionmbajtësit renditen pas gjithë detyrimeve te tjera, të tashme e të ardhme, te garantuara dhe të pagarantuara të Emetuesit. Obligacionmbajtësit duhet të tregohen vigjilentë ndaj treguesve të borxhit të shoqërisë NOA sh.a. në mënyrë që të vlerësojnë sic duhet dhe në mënyrë të vazhdueshmë këtë rrezik përgjatë gjithë jetëgjatësisë së obligacionit. Kështu, rritja e shpejtë dhe e konsiderueshme e detyrimeve (të reja) të Emetuesit në të ardhmen do të rriste riskun e këtij titulli pasi do të përkeqësohej rradha e shlyerjes së obligacionmbajtësve. E kundërta do të ndodhë në rast se Emetuesi ul balancat e detyrimeve ndaj të tretëve; në këtë rast do të ulej risku që shoqëron investimin në këtë titull pasi do të përmirësohej rradha e shlyerjes së obligacionmbajtësve. Statusi i obligacionit si i " nënrenditur" rrit riksun e shlyerjes së pjeshme ose moshlyerjes së shumës së investuar ne rast pa-aftësie paguese të Emetuesit, pasi prioritet në shlyerje do të kenë të gjithë "financuesit" e tjerë të NOAs.

1.3 Risqet kryesore për Emetuesin

Për vlerësimin e duhur të riskut të mosshlyerjes së titullit, është e domosdoshme të njihet aktiviteti i Emetuesit dhe rreziqet kryesore që i kanosen Emetuesit.

Emetuesi, institucioni financiar jo-bankë NOA sh.a., përballet me një sërë rreziqesh gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij; rreziqe që lidhen dhe/ose derivojnë nga ambjenti i jashtëm ekonomik ashtu edhe rreziqe të tjera që lidhen me faktorë të brendshëm të shoqerisë. Në Kreun II të këtij Prospketi, listohen dhe trajtohen rreziqet kryesore për emetuesin të cilat mund të ndikojnë në aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet ndaj obligacionmbajtësve. Emetuesi deklaron se lista e rreziqeve nuk është shteruese dhe se aftësia e tij për të përmbushur detyrimet që burojnë nga obligacioni mund të ndikohet edhe nga faktorë të tjerë të pa-identifikuar në datën e këtij Prospekti . Rreziqet kryesore për Emetuesin përfshijnë rrezikun e kredisë (aktivitetit të institucionit), rrezikun e ndikimit të forcave madhore, rreziku i varësisë nga financuesit e huaj, rreziku i likuiditetit, rreziku i ndryshimit të normave të interesit, rreziku i luhatjes së padëshirueshme të kursit të këmbimit, rreziku Operacional, rreziku i incidenteve kibernetike, rreziku Ligjor dhe Rregullator etj

Niveli i rrezikut: I Mesëm

8. Rreziku i mungesës së tregut/ likuiditetit

Është risku që përfaqëson vështirësinë ose në raste të caktuara edhe pamundësinë nga ana e investitorit që ti shesë obligacionet përpara skadencës së tyre kontraktuale. Tregu jo-aktiv i letrave me vlerë korporative si pasojë e një kërkesë – oferte minimale për to, dëshmuar nga numri shumë i ulët i transaksioneve në treg sekondar me titujt privatë, evidenton vështirësinë e kthimit në likuiditete të titujve të tillë. Theksuar sa më sipër, investitori duhet ta ketë të qartë se periudha kohore e investimit në obligacione, duhet të jetë në një linjë me nevojat e tij për likuiditete në të ardhmen.

Ky rrezik zbutet nga fakti që obligacioni i NOA-s është i listuar në Bursë dhe cdo investitor i interesuar për të shitur këtë titull i drejtohet tregut të rregulluar nëpërmjet anëtarëve / brokerave të Bursës. Mundësia që Bursa si një vend i qendërzuar i tregtimit të titujve krijon për ballafaqimin e kërkesës dhe ofertës, për shpërndarjen e të gjithë informacionit të nevojshmëm mbi Emetuesit e titujve të listuar, si dhe për reflektimin e cmimeve të drejta të titujve (çmimet e ekzekutimit të transaksioneve-informacion publik i ofruar nga Bursa), rrit mundësitë e kthimit të sukseshëm në likuiditet të titujve.

Shtimi i numrit të korporatave që vendosin të emetojnë obligacione korporative përgjatë dy viteve të fundit, përfaqëson një premisë pozitive për zhvillimin e këtij tregu në përgjithësi, rritjen e interesit të investitorëve për të investuar në tituj korporativë (pasi të kenë "testuar" këto lloj investimesh), rritjen e numrit të transaksioneve me këto tituj e si pasojë edhe rritjen e shkallës së likuiditetit të tyre.

Pavarësisht këtij interpretimi dhe pritshmërive tona, risku i mungesës së tregut mbetet ndër risqet kryesore të investimit në obligacione në Shqiperi.

Niveli i rrezikut: I Mesëm

9. Rreziku i normës së interesit

Investimi në obligacionet e NOA shoqërohet nga risku i normës së interesit. Kështu, në rast se normat e interesit në treg rriten, vlera e tregut (çmimi) të obligacioneve të NOA-s do të bjerë pasi do të ulet atraktiviteti i tyre për investitorët (pasi këta të fundit do të jenë të interesuar të blejnë tituj të tjerë me norma më të larta interesi). Ky është një risk që bëhet prezent në rastin kur investitorët dëshirojnë të shesin obligacionet para maturitetit të tyre dhe nga shitja e tyre rrezikojnë të marrin një cmim edhe më të ulët nga cmimi i blerjes (në rast të zhvlerësimit shumë të madhe të titullit si pasojë e një rritje shumë të ndjeshmë të normave të interesit).

Investitori që vendos të mbajë në portofolin e tij titullin e zhvlerësuar (si pasojë e rritjes së interesave të tregut) përshkak të pamundësisë për ta shitur me çmim të pranueshëm sipas vlerësimit të tij, duhet të vlerësojë me kujdes të ardhurat që do të realizonte nëse do të investonte vlerën eventuale të shitjes së obligacionit të zhvlerësuar në një titull tjetër me normë interesi që reflekton nivelin e rinj të interesave të tregut.

Referuar situatës makroekonomike, Banka e Shqipërisë mund të vijojë drejt normalizimit të qëndrimit të politikës monetare edhe gjatë vitit 2023, duke rritur më tej normën e interesit bazë me qëllim frenimin e rritjes së mëtejshme të inflacionit.

Niveli i rrezikut: I Mesëm

10. Rreziku i kursit të këmbimit

Zhvlerësimi i monedhës në të cilën denominohet obligacioni do të thotë zhvlerësim i vlerës së obligacionit kundrejt monedhave të tjera. Zhvlerësimi i monedhës së obligacionit do të thotë gjithashtu që interesi i arkëtuar në formën e kuponeve gjashtëmujore do të ketë një vlerë me ulët në raport me monedhat e tjera, ndaj investitorët duhet të tregohen të kujdesshëm në zgjedhjen e investimit dhe mundësisht të sigurojnë një harmonizim mes monedhës në të cilën përfitojnë të ardhurat dhe monedhës në të cilën realizojnë shpenzimet.

Në rast se monedha "Lekë" në të cilën denominohet obligacioni zhvlerësohet kundrejt monedhës në të cilën investimi mbahet në kontabilitet (për investitorët subjekte), vlera e investimit konvertuar në monedhën e raportimit do të bjerë dhe interesi i arkëtuar në monedhën e obligacionit do të ketë një vlerë më të vogël konvertuar në valutën e aktivitetit/raportimit të librave kontabël. Për këtë arsye është e rëndësishme që investitori të mbajë kurdoherë në konsideratë monedhën e investimit dhe risqet e lidhura me luhatshmërinë e saj.

	Niveli i rrezikut: Në varësi të strukturës së të ardhurave dhe ekspozimit ndaj valutave të secilit investitor. Rreziku i luhatjeve të kursit të këmbimit do të jetë i ulët për investitorët që i kanë të ardhurat në monedhën e obligacionit (Lekë) dhe mund të jetë i "mesëm" në "i lartë" për investitorët që i kanë të ardhurat pjesërisht ose plotësisht në monedhë të ndryshme nga Leku (monedha e obligacionit). **11. Rreziku reputacional** Reputacioni i shoqërisë, ecuria e aktivitetit të saj, lajmet dhe informacionet e shpërndara në media për aktivitetin e emetuesit etj, janë që të gjithë faktorë që luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësinë apo vështirësinë e shitjes së instrumentit në tregun sekondar dhe si pasojë edhe në përcaktimin e cmimit korrent të titullit. **Niveli i rrezikut: I Ulët** **12. Rreziku i luhatjes së normës së inflacionit** Inflacioni e ul vlerën reale të obligacioneve me kalimin e kohës, çka mund të prekë atë që mund të blini me investimin tuaj në të ardhmen dhe mund ta bëjë normën fikse të pagueshme mbi obligacionet relativisht më pak tërheqëse në të ardhmen, çka cenon çmimin që mund të arrinit nga shitja e obligacioneve. **Niveli i rrezikut: I Mesëm** **13. Rreziku që lidhet me ndryshimin e kuadrit fiskal** Të ardhurat neto nga investimi në obligacion do të varen nga regjimi tatimor në fuqi. Emetuesi nuk është në gjendje të parashikojë nëse në të ardhmen do të ketë apo jo ndryshime në trajtimin fiskal të investimit/të të ardhurave nga investimi. Në këtë mënyrë, vlera neto e obligacionit mund të jetë subjekt ndryshimi në të ardhmen në rast se Qeveria merr vendime për të ndryshuar trajtimin fiskal të këtyre lloj investimeve (të ardhurave të derivuara prej tyre). **Niveli i rrezikut: I Ulët**

RUBRIKA 3 --INFORMACION THEMELOR

Pika 3.3	**Pika 3.3 Interesi i personave fizikë dhe juridikë të përfshirë në emetim/ofertë.** ➢ Emetuesi, në dijeninë e tij më të mirë dhe nën përgjegjësinë e tij të plotë, deklaron se përveç ndërmjetësit financiar Banka Credins sha të angazhuar në bazë të një marrëveshje për nënshkrimin e pjesshëm të ofertës, nuk ka palë të tjera me interes të veçantë në këtë emetim/ofertë. **Informacion mbi Nënshkruesin:** Banka Credins sh.a. është licencuar me vendimin Nr.33, datë 28.02.2022 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ofrimin e shërbimeve të investimit të listuara më poshtë dhe shërbimeve ndihmëse që lidhen me to: ✓ Nënshkrimi i instrumenteve financiare dhe/ose hedhja në treg e instrumenteve financiare në bazë të angazhimit në transaksion; ✓ Hedhja në treg e instrumenteve financiare pa angazhim shitjeje.

NOA sh.a dhe Banka Credins sh.a kanë lidhur marrëveshjen me Nr.10157 Prot (Banka Credins) dhe Nr.46917 Prot (NOA), datë 24.04.2023 për nënshkrimin e Obligacionit të nënrenditur, me afat 5-vjecar, interes fiks 8% , denominuar në Lekë dhe i pa-garantuar. Marrëveshja e nënshkrimit ka objekt hedhjen në treg të ketij obligacioni me angazhim maksimal në transaksion deri në një limit të përcaktuar mes palëve dhe hedhjen e tij në treg pa angazhim në transaksion për shumën deri në 400 milionë Lekë.

- Emetuesi, në dijeninë e tij më të mirë dhe nën përgjegjësinë e tij të plotë, deklaron se nuk ka konflikte interesi që lidhen më ofertën, nënshkrimin e saj apo pranimin për t'u tregtuar në një treg të rregulluar.

Pika 3.4

Pika 3.4 Arsyet e ofertës dhe përdorimi i të ardhurave

- ✓ Shuma e grumbulluar nga emetimi i këtyre obligacioneve do të injektohet në masën 100% në aktivitetin primar të institucionit, pra në kredidhënie.

Pavarësisht kushteve makroekonomike në momentin e publikimit të këtij Prospekti (normë inflacioni mbi vlerën e targetuar nga Banka e Shqipërisë), NOA ka konstatuar një rritje të kërkesës për produktet e financimit që ajo ofron.

Kështu, vetëm gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, portofoli i kredisë u rrit me 11.24 % (ose me rreth 681 milionë Lekë) duke arritur pothuajse plotësisht objektivin e institucionit për rritjen vjetore të portofolit neto të kredisë, prej 12%. Portofoli neto dhe bruto i kredisë u rritën me 20% gjatë vitit 2022 dhe vlera totale e disbursimeve përgjatë vitit 2022 arriti rekordin prej rreth 5.5 miliardë Lekë.

Drejtimi i shoqërisë, mbështetur në sinjalet pozitive të ardhura nga tregu, parashikon se ecuria e kredidhënies gjatë vitit 2023, do të jetë po aq pozitive sa përgjatë vitit të mbyllur 2022.

Më poshtë, paraqesim parashikimin për zërat më të rëndësishëm të flukseve hyrëse e dalëse të parave që lidhen më aktivitetin operacional dhe atë financues, përgjatë periudhës Qershor-Gusht 2023, gjatë së cilës drejtimi i shoqërisë parashikon të angazhojë në aktivitet fondet e grumbulluara nga emetimi i këtij obligacioni.

Disa nga zërat e flukseve të parasë gjatë Qershor-Gusht 2023 në milionë Lekë

Disbursime të pritshme gjatë periudhës Qershor-Gusht 2023	**(1,467) milionë Lekë**
Flukse hyrëse të pritshme nga shlyerja e kredive gjatë periudhës Qershor-Gusht 2023	**1,340 milionë Lekë**
Flukse hyrëse nga financime të reja (ose disbursime të transheve të mbetura nga marreveshje ekzistuese financimi) gjatë periudhës Qershor-Gusht 2023	**316 milionë Lekë**
Fukse hyrëse nga emetimi i këtij Obligacioni	**500 milionë Lekë**
Flukse dalëse për shlyerje të kësteve të huave/financimeve të NOA gjatë periudhës Qershor-Gusht 2023	**(710) milionë Lekë**
Flukse dalëse per shpenzime operacionale gjatë periudhës	**(195) milionë Lekë**
Interes i arkëtueshëm gjatë periudhës nga portofoli i kredive	**406 milionë Lekë**
Interes i pagueshëm gjatë periudhës për huatë e NOAs	**(101) milionë Lekë**

Rritja e parashikuar e portofolit do të financohet në pjesën më të madhe prej flukseve monetare nga shlyerjet e kredive nga klientët dhe pjesërisht prej fondeve të grumbulluara nga emetimi i obligacioneve.

Disbursimet në 3 mujorin Qershor-Gusht 2023, pritet të alokohen në rradhën e segmenteve të klientelës në të njëtën mënyrë dhe duke ndjekur të njëjtin trend të shënuar gjatë vitit 2022. Kështu, segmenti "Biznese të vogla e të mesme"pritet të përthithë pjesën më të madhe të financimeve të reja në vlerën e pritshme prej rreth 874 milionë Lekë ose rreth 60% të disbursimeve të reja të periudhës. Segmentet "Agrobiznes" dhe "Individë" pritet të tërheqin respektivisht rreth 16% dhe 24% të disbursimeve të reja të periudhës në fjalë.

Shpërndarja e Disbursimeve përgjatë Qershor-Gusht 2023 sipas Segmenteve



Në bazë të parashikimeve të drejtimit, fondet pritet të alokohen në rradhën e klientëve , sipas projeksioneve të mëposhtme:

	Total për Qershor-Gusht 2023	Prej të cilave financuar nga fondet e grumbulluara nga obligacionmbajtësit
Kredi në numër për "Biznese të vogla e të mesme"	1,057	432
Kredi në numër për "Agrobiznese"	605	187
Kredi në numër për "Individë"	1,922	511
TOTAL	**3,584**	**1,130**

	(në milionë LEKË)	(në milionë LEKË)
Kredi (disbursime) në vlerë për "Biznese të vogla e të mesme"	874	315
Kredi (disbursime) në vlerë për "Agrobiznese"	231	107
Kredi (disbursime) në vlerë për "Individë"	362	78
TOTAL	**1,467**	**500**

	(në milionë LEKË)	(në milionë LEKË)
Portofol neto në vlerë për "Biznese të vogla e të mesme"	5,031	315
Portofol neto në vlerë për "Agrobiznese"	1,634	107
Portofol neto në vlerë për "Individë"	1,159	78
TOTAL	**7,824**	**500**

Nga pikëpamja financiare, financimi i aktivitetit të NOAs nëpërmjet obligacioneve pritet të ketë ndikim pozitiv në:

	➢ rritjen e afatit mesatar të borxhit duke e shtrirë në kohë; ➢ nëpermjet rritjes së peshës së borxhit me interes fiks ul rrezikun e humbjeve të ardhshme si pasojë e ndonjë rritje të mundshme të interesave të tregut; do t'i krijojë institucionit hapësirën për shfrytëzimin maksimal të fondeve/likuiditeteve të saj pasi shlyerja e këtij borxhi do të realizohet me një pagesë të vetme në datën e tij të maturimit. Duke patur parasysh maturitetin mesatar relativisht te shkurtër (rreth 24-26 muaj) të kredive të NOA-s (kredi për klientët), fondet e huazuara nga obligacionmbajtësit do të mund të "hidhen" disa herë në biznes e të "shfrytëzohen maksimalisht"me qëllim përfitimin financiar të institucionit. Me një normë mesatare interesi financimi të klientëve prej 19.43% në vit dhe normë mesatare efektive interesi prej 23.75 % në vit, operacioni i financimit të aktivitetit përmes emetimit të obligacioneve me kosto fikse prej 8.0% në vit do të jetë me përfitim për institucionin.

RUBRIKA 4 -- INFORMACION RRETH TITUJVE QË OFROHEN/PRANOHEN PËR TREGTIM

Pika 4.1	**Pika 4.1 Përshkrim i llojit dhe klasës së titujve që do të ofrohen dhe do të pranohen për tregtim, përfshi kodin ndërkombëtar të identifikimit të titujve ('ISIN').** Obligacionet e NOA sh.a. janë instrumente borxhi lirisht të transferueshme dhe emetohen nga emetuesi në formë të dematerializuar përmes një oferte publike. Në përputhje me llojet e obligacioneve të njohura në literaturë, obligacionet e NOA sha janë: o pa garanci, o me kupon/interes të pagueshëm cdo 6 (gjashtë) muaj; o me normë interesi fikse përgjatë gjithë jetëgjatësisë (8,00% p.a); o me shlyerje nëpërmjet një pagese të vetme në datën e maturimit; o afatgjatë (maturitet 5 vjecar/60 mujor); o pa të drejta të vecanta pra nuk janë obligacione të konvertueshme në aksione, nuk janë obligacione me pjesëmarrje, nuk janë obligacione të këmbyeshme; o me rradhë shlyerje pas të gjitha detyrimeve të tjera të garantuara e të pagarantuara, të tashme dhe të ardhshme të NOA-s; o pa kufizime për kalimin e pronësisë; Numri i Identifikimit të Emetuesit: K11604002V Numri i Identifikimit të Titullit (ISIN) : AL0022100146 Numri Nderkombëtar i Identifikimit të Titujve / Numri Shqiptar i Identifikimi të Titujve për obligacionet përcaktohet ditën e regjistrimit të tyre pranë Regjistrarit Shqiptar të Titujve (ALREG Sh.a.).
Pika 4.2	**Pika 4.2 Legjislacioni në bazë të të cilit janë krijuar titujt.** Emetuesi realizon ofertën e titujve në Republikën e Shqipërisë, ndaj emetimi i nënshtrohet legjislacionit të shtetit Shqiptar. **Këto tituj krijohen, ofrohen, tregtohen dhe shlyhen në bazë të Ligjit Nr. 62/2020, 'Për Tregjet e Kapitalit' dhe të gjitha akteve nënligjore në zbatim të tij.** Në cdo operacion të lidhur me këto tituj, Emetuesi respekton gjithashtu parashikimet akteve ligjore në bazë të të cilave ushtrohet aktiviteti tregtar i NOAs : • Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar; • Ligji nr. 9901, datë 14. 04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;

	• Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe çdo akt nënligjor i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në zbatim të këtij ligji dhe që rregullon veprimtarinë e institucioneve financiare jobanka, prej të cilëve veçojmë për nga rëndësia : o Rregullore nr. 1, datë 17.01.2013 e Bankës së Shqipërisë “Per licencimin dhe ushtrimin e veprimtarise nga subjektet financiare jobankare”, e ndryshuar; • Ligji nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", i ndryshuar si dhe çdo akt nënligjor të miratuar nga Bordi i AMF-së në zbatim të këtij ligji; • Ligji nr.9917, date 19.05. 2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, dhe të gjitha aktet nënligjore në zbatim të tij; • Ligi nr. 9902, datë 17.042008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, • Ligji nr. 9887, date 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. • Të tjera.
Pika 4.3	4.3 Të dhënat mbi formën e regjistruar të tiujve Obligacionet e NOA sh.a. emetohen në formë të dematerializuar përmes një oferte publike. Titujt do regjistrohen pranë Regjistrarit Shqiptar të Titujve (ALREG Sh.a.). Numri Nderkombëtar i Identifikimit të Titujve / Numri Shqiptar i Identifikimi të Titujve për obligacionet përcaktohet ditën e regjistrimit të tyre pranë Regjistrarit Shqiptar të Titujve (ALREG Sh.a.).
Pika 4.3.1	4.3.1 Vlera e emetuar dhe e tregtuar dhe afatet kur do hapet oferta Shuma nominale maksimale e obligacioneve që pritet të emetohen është 500.000.000,00 (Pesëqind milionë) Lekë dhe në numër janë 1,000 obligacione. Oferta pritet të hapet në datën 24 Maj2023 dhe të mbyllet në orën 14.00 më 21 Qershor 2023 ose në një orë dhe datë të mëparshme që do të shpallet në vijim nga emetuesi. Emetuesi NOA sh.a. , pas përfundimit të periudhës së ofertës do të realizojë shpalljen e emetimit duke komunikuar për publikun sasinë e obligacioneve të nënshkruara, pra perqindjen e realizimit të ofertës. NOA sh.a. angazhohet të listojë obligacionet në segmentin “Tregu Zyrtar Standard” i Bursa Shqiptare e Titujve ALSE menjëherë pas plotësimit të kushtit të vendosur prej Emetuesit mbi perqindjen minimale të nënshkrimit të obligacioneve prej të paktën 10% të ofertës.
Pika 4.4	4.4 Monedha e titujve të emetuar. Obligacionet janë të denominuara në monedhën Lekë (ALL).
Pika 4.4.1	4.4.1 Prioriteti relativ i titujve në strukturën e kapitalit në rast falimentimi Këto obligacione janë tituj të nënrenditur (borxh i varur).

	Në rradhën e shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë, këto obligacione renditen pas të gjitha detyrimeve të tjera të garantuara e të pagantuara që shoqëria ka/mund të ketë në të ardhmen. Pra, në çdo rast, pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë kanë përparësi shlyerje më të lartë krahasuar me pretendimin mbi kontratën e obligacionit. Këto obligacionet renditen pari passu (pra, në mënyrë të barabartë) dhe pa përparësi mes tyre. Në rast të zbatimit të procedurës të falimentimit të parashikuar në Ligjin nr. 110/2016 "Për falimentimin", obligacionmbajtësit do të konsiderohen si "kreditorë të pasiguruar" dhe do të shlyhen dhe renditen pas një sërë kategorive të kreditorëve të tjerë të shoqërisë, por përpara kreditorëve fundorë (si p.sh.: palët e lidhura apo kreditorë për pretendime të lidhura me sanksione/gjoba) dhe aksionarëve të shoqërisë. Pra, obligacionmbajtësit do të shlyhen vetëm pasi të jenë shlyer të gjithë kreditorët e kategorive pararendëse por përpara shlyerjes së aksionarëve të shoqërisë.
Pika 4.5	Pika 4.5 Përshkrim i të drejtave që lidhen me titujt, përfshi kufizimet e këtyre të drejtave dhe procedurën për ushtrimin e këtyre të drejtave ➢ Të drejta themelore të mbajtësve të obligacioneve Mbajtësit e obligacioneve gëzojnë: o të drejtën e arkëtimit të 100% të vlerës nominale të obligacioneve të zotëruara prej tyre në datën e maturimit të tyre, sipas kalendarit të paraqitur në këtë Prospekt Data e maturimit 23 Qershor 2028 o të drejtën e arkëtimit të interesit kupon (8% p.a) cdo gjashtë muaj deri në fund të jetëgjatësisë së obligacioneve, sipas kalendarit të pagesës së kuponave paraqitur në këtë Prospekt. Interesi bëhet i pagueshëm dhe detyrimisht duhet të shlyhet në cdo datë pagesë kuponash sipas kalendarit. Kujdestari [dhe nëse do të aplikohet Agjenti Pagues (shlyerës)] kanë përgjegjësi ligjore për shpërndarjen e pagesave të interesit (kupon) në rradhën e obligacionmbajtësve, cdo datë kuponi pasi janë furnizuar me fondet përkatëse nga Emetuesi. Interesi (kuponi) i përftuar nga investimi në obligacione, i cili paguhet çdo gjashtë muaj, llogaritet si më poshtë: C = Vn * i * 180/360 C - Kuponi Vn - vlera nominale i - norma e interesit e shprehur në bazë vjetore (8%); o të drejtën e organizimit në grup së bashku me të gjithë zotëruesit e tjerë të këtyre obligacioneve dhe të drejtën e caktimit të një përfaqësuesi, i cili është përgjegjës për përfaqësimin e interesave të tyre përkundrejt Emetuesit dhe palëve të treta. Në rast se nuk është e mundur që obligacionmbajtësit të zgjedhin përfaqësues, ky përfaqësues zgjidhet nga Emetuesi. Përfaqësues të obligacionmbajtësit mund të jenë shoqëritë komisionere dhe shoqëri të tjera të caktuara nga obligacionmbajtësit. Nuk mund të zgjidhen si përfaqësues të obligacionmbajtësve administratorët apo personat që kanë lidhje të ngushta apo konflikt interesi me emetuesin. Pagesa e përfaqësuesit të obligacionmbajtësve paguhet nga emetuesi; o të drejtën e informimit të menjëhershëm nga Kujdestari në rast se Emetuesi nuk përmbush detyrimet kundrejt obligacionmbajtësve dhe kujdestarit, në mënyrën dhe kohën e duhur, sipas parashikimeve të këtij Prospekti.

	o të drejtën të ngrejnë pretendime ndaj Emetuesit në rast se ky i fundit dështon në përmbushjen e detyrimeve ndaj obligacionmbajtësve. Në raste të tilla të mospërmbushjes së detyrimeve nga Emetuesi, Përfaqësuesi i zotëruesve të obligacioneve (pas autorizimit nga obligacionmbajtësit) ka fuqinë për të paraqitur në gjykatë kërkesë për fillim procedure penale apo procedure ekzekutimi. o të drejtën të ngrejnë pretendime ndaj Kujdestarit dhe/ose Agjentit Pagues (shlyerës) në rast se ky/këta të fundit dështon/jnë në përmbushjen e detyrimeve ndaj obligacionmbajtësve pasi është verifikuar që mos përmbushja e detyrimeve të tyre nuk ka ardhur si pasojë e dështimit të pagesave nga Emetuesi. Në rast se arsyeja e mospërmbushjes së detyrimeve të Kujdestarit/Agjentit Pagues është dështimi i shlyerjes së detyrimeve nga ana e Emetuesit përkundrejt obligacionmbajtësve dhe kujdestarit, atëhere përgjegjës i vetëm ligjor për mospërmbushje e detyrimeve do të jetë Emetuesi. ➢ Garancia dhe Rradha e Shlyerjes së Borxhit Obligacionet përbëjnë detyrime pa garanci të Emetuesit, pra shlyerja e vlerës nominale të obligacionit në maturim ashtu edhe shlyerja periodike e detyrimeve të emetuesit për kuponat gjashtëmujorë, nuk garantohet me ndonjë aset apo me mjetet e ndonjë personi/subjekti tjetër që mund të luante rolin e garantit. Shlyerja e detyrimeve ndaj obligacionmbajtësit mbështetet vetëm në mjetet e Emetuesit, disponueshmëria e të cilave varet në mënyre direkte nga performanca e biznesit të Emetuesit. Në rradhën e shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë, këto obligacione renditen pas të gjitha detyrimeve të tjera të garantuara e të pagantuara që shoqëria ka/mund të ketë në të ardhmen. Pra, në çdo rast, pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë kanë përparësi shlyerje më të lartë krahasuar me pretendimin mbi kontratën e obligacionit. Këto obligacionet renditen pari passu (pra, në mënyrë të barabartë) dhe pa përparësi mes tyre. ➢ Të drejta të tjera Obligacionet nuk mbartin të drejta të vecanta; - ato nuk janë obligacione të konvertueshme në aksione; - nuk janë obligacione me pjesemarrje në fitimin e shoqërisë emetuese; - nuk janë obligacione të këmbyeshme.
Pika 4.5.1	Pika 4.5.1 Paraqitje e mbajtësve të titujve pa pjesëmarrje në kapital, përfshi identifikimin e organizatave që përfaqësojnë investuesit dhe dispozitat që zbatohen për këtë përfaqësim., Informacion rreth faqes së internetit ku publiku mund të ketë qasje pa pagesë në kontratat që lidhen me këto forma përfaqësimi. Obligacionmbajtësit do të caktojnë një përfaqësues, i cili është përgjegjës për përfaqësimin e interesave të tyre përkundrejt Emetuesit dhe palëve të treta, sipas parashikimeve të nenit 243, pika 4 të Ligjit 62/20“ Për Tregjet e Kapitalit”. Në rast se nuk është e mundur që obligacionmbajtësit të zgjedhin përfaqësues, ky përfaqësues zgjidhet nga Emetuesi. Përfaqësues të obligacionmbajtësit mund të jenë shoqëritë komisionere dhe shoqëri të tjera të caktuara nga obligacionmbajtësit. Nuk mund të zgjidhen si përfaqësues të obligacionmbajtësve administratorët apo personat që kanë lidhje të ngushta apo konflikt interesi me emetuesin. Pasi të caktohet Përfaqësuesi, obligacionmbajtësit do të informohen nga Përfaqësuesi mbi faqen e internetit të tij ku mund të konsultohen me aktet/draft aktet relevante.

Pika 4.6	**Pika 4.6 Në rast emetimesh të reja, një deklaratë për zgjidhjet, autorizimet dhe miratimet përmes të cilave është krijuar ose do të krijohet dhe/ose do të emetohet titulli.** Ky është emetim i vetëm I këtij tituli. Nuk do të ketë emetime të reja.
Pika 4.7	**4.7 Në rastin e emetimeve të reja, data e pritshme e emetimit të titujve** Nuk do të ketë emetime të tjera të tillut.
Pika 4.8	**4.8 Një përshkrim i kufizimeve të transferueshmërisë së titujve.** Nuk ka asnjë kufizim për transferimin lirisht të obligacioneve të NOA-s. Këto obligacione do të mund të tregtohen normalisht në Bursë nga zotëruesit e tyre dhe blerësit e tjerë potencialë, pa asnjë kufizim në transferueshmërinë e pronësisë.
Pika 4.11	**4.11 Një paralajmërim që legjislacioni tatimor i shtetit të investuesit dhe vendit të themelimit të emetuesit mund të ndikojnë në të ardhurat e përftuara nga titujt** - Interesi i perfituar nga investimi në këto obligacione i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat në përputhje me parashikimet e legjislacionit tatimor të Republikës së Shqipërisë. Taksat dhe tarifat që mund të ndryshojnë në të ardhmen do t'i ngarkohen mbajtësit të titullit dhe pasardhësve të tjerë të mbajtësve të tij. Në momentin e publikimit për herë të parë të këtij Prospekti taksa mbi të ardhurat nga interesi i fituar është **15%.** - Në rastet e investitorëve me rezidencë tatimore të ndryshme nga Shteti Shqiptar, duhet të mbahen kurdoherë në konsideratë parashikimet e legjislacionit tatimor ne fuqi të dy shteteve. Emetuesi paralajmëron investitorët të informohen me saktësi mbi ndikimin e legjislacionit tatimor Shqiptar dhe atë të shtetit të investuesit (në rastet kur nuk është R.SH) në të ardhurat e përfituara nga ky obligacion, para se të marrin vendimin për investim.

RUBRIKA 5 -- KUSHTET DHE KRITERET PËR OFRIMIN E TITUJVE PUBLIKUT

Pika 5.1.1	**5.1 Kushtet, statistikat e ofertës, kalendari i pritshëm dhe veprimet e nevojshme për të aplikuar për ofertën.** **Pika 5.1.1 Kushtet të cilave u nënshtrohet oferta.** **Kriteret/kushte të përgjithshme** - Obligacionet e NOA sh.a. janë instrumente borxhi lirisht të transferueshme dhe emetohen nga emetuesi në formë të dematerializuar përmes një oferte publike. - Obligacionet e NOA sh.a janë obligacione afatgjata, të pa-garantuara, me normë fikse interesi prej 8% , afat 5 (pesë) vjeçar dhe të denominuara në monedhën Lekë. Shlyerja e obligacionit do të realizohet nëpërmjet një pagese të vetme në datën e maturimit ndërsa interesi (kuponi) është i pagueshëm çdo gjashtë muaj sipas kalendarit të paraqitur më poshtë. - Obligacionet do të emetohen me 100% të vlerës nominale të tyre. - Vlera nominale e çdo obligacioni është 500.000,00 (Pesëqind mijë) Lekë. - Shuma minimale e nënshkrimit /kërkesës për blerje obligacionesh për çdo investitor është 500.000,00 (Pesëqind mijë) Lekë. - Shuma nominale maksimale e obligacioneve që pritet të emetohen është 500.000.000,00 (Pesëqind milionë) Lekë dhe në numër janë 1.000 obligacione.

	- Emetuesi ka zgjedhur dhe autorizuar Bankën Credins sh.a. si ndërmjetës financiar për shërbimin e hedhjes në treg të këtyre titujve sipas kushteve dhe parashikimeve të kontratës së lidhur mes palëve. Kalendari i Pritshëm i Ofertës Oferta pritet të hapet në datën 24 Maj2023 dhe të mbyllet në orën 14.00 më 21 Qershor 2023 ose në një orë dhe datë të mëparshme që do të shpallet në vijim nga emetuesi. Datat kryesore të lidhura me emetimin si dhe pagesën e kuponëve paraqiten si më poshtë: Fillimi i periudhës së ofertës 24 Maj2023 Fundi i periudhës së ofertës 21 Qershor 2023 Shpallja 21 Qershor 2023 (konfirmimi i shumës nominale gjithsej të obligacioneve që do të emetohen) Data e emetimit 23 Qershor 2023 Data e parë e pagimit të interesit 23 Dhjetor 2023 Data e maturimit 23 Qershor 2028 Interesi (kupon) planifikohet të paguhet më 23 Qershor dhe 23 Dhjetor; deri më datën e maturimit. Pagesa e pare e interesit do të bëhet më 23 Dhjetor 2023. Nëse ndonjë prej këtyre datave nuk është ditë pune, atëherë pagesa e interesit do të bëhet ditën e parë të ardhshme të punës pa akumuluar interes shtesë.

Pika 5.1.3	Pika 5.1.3 Periudha kohore, përfshi çdo ndryshim të mundshëm, gjatë së cilës do të hapet oferta përshkrim i procesit të aplikimit.
	
	Oferta pritet të hapet në datën 24 Maj2023 dhe të mbyllet në orën 14.00 më 21 Qershor 2023 ose në një orë dhe datë të mëparshme që do të shpallet në vijim nga emetuesi.
	
	Kërkesat për blerje obligacioni gjatë periudhës së ofertës mund të bëhen vetëm përmes formularit të kërkesës që gjendet bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij Prospekti. Kërkesat e bëra në mënyra të tjera nuk do të pranohen.
	
	Kërkesat për të blerë obligacione mund t'i paraqiten:
	- drejtëpërdrejt shoqërisë emetuese NOA sh.a. pranë degës qendrore me adresë Rr. "Tish Daia", Komuna e Parisit, Kompleksi Haxhiu (Kika 2), Shkalla 11, Zyra nr. 1, Tiranë, Shqipëri si dhe pranë cdo filiali/dege të NOA sh.a në Republikën e Shqipërisë;
	- Bankës Credins sh.a si ndërmjetës financiar i autorizuar nga emetuesi NOA sh.a për shitjen /shpërndarjen e obligacionit. Të dhënat e kontaktit dhe adresat e ndërmjetësit Banka Credins sh.a. janë si më poshtë:
	  o Dega Qendër Banka Credins, me adresë "Rruga Vaso Pasha, Nr.8, Tiranë";
	  o Dega Tirana 1 Banka Credins, me adresë "Rruga Ismail Qemali, Nr.4, Tiranë";
	  o Dega Tirana 3 "Rruga Muhamet Gjollesha" Njesia Administrative nr 7, Kodi Postar 1023,nr ndertese 98
	  o Dega Shkoder, "Rruga Sheshi Demokracia" nr 21,Brenda territorit te njesise administrative nr 1, ne ZK me nr 8591 dhe nr pasurie 2/1132
	  o Dega Vlora 1 Lagjia Pavaresia, Zona kadastrale 8602, nr pasurie 27/6 – N.1, vol 33 , faqe 119 dhe zona kadastrale 8602, nr pasurie 27/6-N32, Vol 33, faqe 150 Vlore.

	○ Dega Triana 2 Bulevardi Zogu i Pare Njesia administrative nr 9 kodi postar 1016, nr ndertese 2. ○ Dega Fier 1 , Rruga "Sheshi Nene Tereza " Ndertesa 3 Hyrja 1, ZK 8533 dhe nr pasurie5/188-N2 dhe 5/188-N3 ○ Dega Tirana 11 Zona A-4, Njësia 5/10, ne Rrugen "Emin Duraku" dhe "Komuna e Parisit" ○ Dega Tirana 5, Blv " Zhan D'ark" Njesia Administrative Nr 2,Kodi postar 1017, Nr Ndertese 55 ○ Dega Korce, Bulevardi "Republika",Lagja 12, P 11 H11 ,Kodi Postar 7001, ZK8561nr pasurie 2/392-N4 Duke qënë se ky obligacion i emetuar nga NOA sha ka statusin " i nënrenditur", NOA do të realizojë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së investitorit potencial me këtë instrument financiar nëpërmjet testit të përshtatshmërisë (pjesë e procesit të aplikimit). Vlerësimi do të kryhet për të gjithë investitorët potencialë të cilëve NOA u prezanton Prospektin dhe cdo informacion tjetër të domosdoshëm për marrjen e vendimit për investim. Vlerësimi i përshtatshmërisë së investitorëve potencialë të cilët do të shërbehen nga ndërmjetësi financiar do të realizohet pikërisht nga ndërmjetësi Banka Credins sipas detyrimeve të tij ligjore dhe kontraktuale
Pika 5.1.5	Pika 5.1.5 Një përshkrim të mundësive për uljen e nënshkrimeve dhe mënyrën për të rimbursuar shumat e paguara tepër nga kërkuesit Nuk parashikohet mundësia e uljes së nënshkrimeve. Titulli do të shitet nga NOA dhe nënshkruesi deri në momentin e plotësimit të vlerës maksimale të ofertës, prej 500 milionë Lekë. Cdo investitor që interesohet për investim pasi është plotësuar shuma maksimale e ofertës, nuk do të mund të blejë tituj.
Pika 5.1.6	Pika 5.1.6 Hollësi mbi vlerën minimale dhe/ose maksimale të kërkesës (qoftë në numër titujsh apo vlerë të përgjithshme që do të investohet). Shuma minimale e nënshkrimit /kërkesës për blerje obligacionesh për çdo investitor është 500.000,00 (Pesëqind mijë) Lekë, apo në numër 1 obligacion. Obligacionet do të emetohen me 100% të vlerës nominale të tyre. Vlera nominale e çdo obligacioni është 500.000,00 (Pesëqind mijë) Lekë Shuma nominale maksimale e obligacioneve që pritet të emetohen është 500.000.000,00 (Pesëqind milionë) Lekë dhe në numër janë 1.000 obligacione.
Pika 5.1.7	Pika 5.1.7 Informacion rreth periudhës në të cilët kërkesa mund të tërhiqet, me kusht që investuesit të lejohen të tërheqin nënshkrimin e tyre. Investitori që investon gjatë periudhës së ofertës,ka të drejtë të tërhiqet nga nënshkrimi deri 24 orë para datës së mbylljes së ofertës, më 21 Qershor 2023 .
Pika 5.1.8	Pika 5.1.8 Metodën dhe afatin e pagesës së titujve dhe dorëzimit të titujve. Metoda mbi bazën e së cilës dorëzohet titulli tek pala blerëse do të jetë DVP (Delivery versus Payment). Titulli i dorëzohet blerësit vetëm pasi është realizuar/shlyer pagesa/cmimi i titullit. Për investimet e realizuara gjatë periudhës së ofertës, titujt do të dorëzohen/regjistrohen nga kujdestari në emër të investitorit vetëm pasi është mbyllur periudha e ofertës.

Pika 5.1.9	**Pika 5.1.9 Përshkrim i plotë i mënyrës dhe datës kur do të bëhen publike rezultatet e ofertës.** Emetuesi NOA sh.a., brenda 2 ditëve pas përfundimit të periudhës së ofertës do të realizojë shpalljen e emetimit duke komunikuar për publikun sasinë e obligacioneve të nënshkruara, pra perqindjen e realizimit të ofertës. Shpallja do të realizohet në faqen zyrtare të internetit si dhe në kanale të komunikimit masiv.
Pika 5.1.10	**Pika 5.1.10 Procedura për ushtrimin e të drejtave të parablerjes, negociueshmërisë së nënshkrimit dhe trajtimit të drejtave të paushtruara të nënshkrimit**. Cmimi, i panegociueshëm, i titullit gjatë periudhës së ofertës do të jetë sa Vlerë Nominale e titullit (par value). Asnjë investitor nuk gëzon të drejta parablerje apo negociueshmërisë së nënshkrimit.
Pika 5.2	**Pika 5.2 Plani i shpërndarjes dhe caktimit**. Kërkesat për blerje obligacioni gjatë periudhës së ofertës mund të bëhen vetëm përmes formularit të kërkesës që gjendet bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij Prospekti. Kërkesat e bëra në mënyra të tjera nuk do të pranohen. Kërkesat për të blerë obligacione mund t'i paraqiten: - drejtëpërdrejt shoqërisë emetuese NOA sh.a. pranë degës qendrore me adresë Rr. "Tish Daia", Komuna e Parisit, Kompleksi Haxhiu (Kika 2), Shkalla 11, Zyra nr. 1, Tiranë, Shqipëri si dhe pranë cdo filiali/dege të NOA sh.a në Republikën e Shqipërisë; - Bankës Credins sh.a si ndërmjetës financiar i autorizuar nga emetuesi NOA sh.a për shitjen /shpërndarjen e obligacionit. Të dhënat e kontaktit dhe adresat e ndërmjetësit Banka Credins sh.a. janë si më poshtë: o Dega Qendër Banka Credins, me adresë "Rruga Vaso Pasha, Nr.8, Tiranë"; o Dega Tirana 1 Banka Credins, me adresë "Rruga Ismail Qemali, Nr.4, Tiranë"; o Dega Tirana 3 "Rruga Muhamet Gjollesha" Njesia Administrative nr 7, Kodi Postar 1023,nr ndertese 98 o Dega Shkoder, "Rruga Sheshi Demokracia" nr 21,Brenda territorit te njesise administrative nr 1, ne ZK me nr 8591 dhe nr pasurie 2/1132 o Dega Vlora 1 Lagjia Pavaresia, Zona kadastrale 8602, nr pasurie 27/6 – N.1, vol 33 , faqe 119 dhe zona kadastrale 8602, nr pasurie 27/6-N32, Vol 33, faqe 150 Vlore. o Dega Triana 2 Bulevardi Zogu i Pare Njesia administrative nr 9 kodi postar 1016, nr ndertese 2. o Dega Fier 1 , Rruga "Sheshi Nene Tereza " Ndertesa 3 Hyrja 1, ZK 8533 dhe nr pasurie5/188-N2 dhe 5/188-N3 o Dega Tirana 11 Zona A-4, Njësia 5/10, ne Rrugen "Emin Duraku" dhe "Komuna e Parisit" o Dega Tirana 5, Blv " Zhan D'ark" Njesia Administrative Nr 2,Kodi postar 1017, Nr Ndertese 55 o Dega Korce, Bulevardi "Republika",Lagja 12, P 11 H11 ,Kodi Postar 7001, ZK8561nr pasurie 2/392-N4
Pika 5.3 Pika 5.3.1	**Pika 5.3 Çmimi i vendosur** **Pika 5.3.1 Deklarim i çmimit të pritshëm me të cilin do të ofrohen titujt** - Obligacionet do të emetohen me 100% të vlerës nominale të tyre. - Vlera nominale e çdo obligacioni është 500.000,00 (Pesëqind mijë) Lekë
Pika 5.4	**Pika 5.4 Hedhja në treg dhe nënshkrimi**

Pika 5.4.1	**Pika 5.4.1 Emri dhe adresa e koordinatorit/koordinatorëve të ofertës globale dhe pjesëve të veçanta të ofertës dhe, për aq sa ka dijeni në emetim, personave që e hedhin në treg në vende të ndryshme ku bëhet oferta**. Emetuesi ka zgjedhur dhe autorizuar Bankën Credins sh.a. si ndërmjetës financiar për shërbimin e hedhjes në treg të këtyre titujve sipas kushteve dhe parashikimeve të marrëveshjes së lidhur mes palëve. **Informacion mbi Nënshkruesin:** Banka Credins sh.a. është licencuar (Licence Nr.7, 28.02.2022) me vendimin Nr.33, datë 28.02.2022 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ofrimin e shërbimeve të investimit, përfshirë nënshkrimin dhe hedhjen në treg të instrumentave financiare. Struktura përgjegjëse e Nënshkruesit për koordinimin e ofertës së obligacionit të NOA është: **Drejtoria e Bankingut Investues**, Adresë Rr.Vaso Pasha, Nr.8, Tirane Email: info@bankacredins.com Tel: +355 46 700 777 / +355 4 53 53 000 Degët/vendndodhjet ku Nënshkruesi do të realizoje hedhje në treg të obligacioneve të NOA sha janë : o Dega Qendër Banka Credins, me adresë "Rruga Vaso Pasha, Nr.8, Tiranë"; o Dega Tirana 1 Banka Credins, me adresë "Rruga Ismail Qemali, Nr.4, Tiranë"; o Dega Tirana 3 "Rruga Muhamet Gjollesha" Njesia Administrative nr 7, Kodi Postar 1023,nr ndertese 98 o Dega Shkoder, "Rruga Sheshi Demokracia" nr 21,Brenda territorit te njesise administrative nr 1, ne ZK me nr 8591 dhe nr pasurie 2/1132 o Dega Vlora 1 Lagjia Pavaresia, Zona kadastrale 8602, nr pasurie 27/6 – N.1, vol 33 , faqe 119 dhe zona kadastrale 8602, nr pasurie 27/6-N32, Vol 33, faqe 150 Vlore. o Dega Triana 2 Bulevardi Zogu i Pare Njesia administrative nr 9 kodi postar 1016, nr ndertese 2. o Dega Fier 1 , Rruga "Sheshi Nene Tereza " Ndertesa 3 Hyrja 1, ZK 8533 dhe nr pasurie5/188-N2 dhe 5/188-N3 o Dega Tirana 11 Zona A-4, Njësia 5/10, ne Rrugen "Emin Duraku" dhe "Komuna e Parisit" o Dega Tirana 5, Blv " Zhan D'ark" Njesia Administrative Nr 2,Kodi postar 1017, Nr Ndertese 55; o Dega Korce, Bulevardi "Republika",Lagja 12, P 11 H11 ,Kodi Postar 7001, ZK8561nr pasurie 2/392-N4
Pika 5.4.2	**Pika 5.4.2 Emri dhe adresa e agjentëve pagues agjentëve depozitarë**. Kujdestar: Banka Credins sh.a me adresë "Rruga Vaso Pasha, Nr.8, Tiranë. Agjent Pagues: Banka Credins sh.a. me adresë "Rruga Vaso Pasha, Nr.8, Tiranë";
Pika 5.4.3	**5.4.3 Emri dhe adresa e subjekteve që bien dakord të nënshkruajnë emetimin mbi baza angazhimi** Banka Credins sha, me adresë "Rruga Vaso Pasha, Nr.8, Tiranë".

	NOA sh.a dhe Banka Credins sh.a kanë lidhur marrëveshjen me Nr.10157 Prot (Banka Credins) dhe Nr.46917 Prot (NOA), datë 24.04.2023 për nënshkrimin e Obligacionit të nënrenditur, me afat 5-vjecar, interes fiks 8% , denominuar në Lekë dhe i pa-garantuar. Marrëveshja e nënshkrimit ka objekt hedhjen në treg të ketij obligacioni me angazhim maksimal në transaksion deri në një limit të përcaktuar mes palëve dhe hedhjen e tij në treg pa angazhim në transaksion për shumën deri në 400 milionë Lekë.
Pika 5.4.4	5.4.4 Kur është lidhur ose do të lidhet marrëveshja e nënshkrimit NOA sh.a dhe Banka Credins sh.a kanë lidhur marrëveshjen me Nr.10157 Prot (Banka Credins) dhe Nr.46917 Prot (NOA), datë 24.04.2023 për nënshkrimin e Obligacionit të nënrenditur, me afat 5-vjecar, interes fiks 8% , denominuar në Lekë dhe i pa-garantuar.

RUBRIKA 6 -- PRANIMI PËR TREGTIM DHE RREGULLAT E TREGTIMIT

Pika 6.1	Pika 6.1 Kërkesa për pranim për t'u tregtuar, me qëllim shpërndarjen në një treg të rregulluar NOA sh.a. angazhohet të listojë obligacionet në segmentin "**Tregu Zyrtar Standard" i Bursa Shqiptare e Titujve ALSE** menjëherë pas plotësimit të kushtit të vendosur prej Emetuesit mbi perqindjen minimale të nënshkrimit të obligacioneve prej të paktën 10% të ofertës.
Pika 6.2	6.2 Tregjet e rregulluara në të cilat, me sa ka dijeni emetuesi, titujt e së njëjtës klasë titujsh që do të ofrohen apo pranohen për tregtim, janë pranuar tashmë për t'u tregtuar. Deri në datën e këtij Prospekti , nuk ka tituj të listuar në segmentin "Tregu Zyrtar Standard" i Bursa Shqiptare e Titujve ALSE.
Pika 6.3	6.3 Emri dhe adresa e subjekteve që kanë angazhim të përcaktuar për të vepruar si ndërmjetës në tregun dytësor Si më datën e këtij Prospekti, nuk ka ndërmjetës që kanë angazhim të përcaktuar për të vepruar si ndërmjetës në tregun dytësor, duke ofruar likuiditet përmes normave të blerjeve dhe ofertës. Gjithsesi, më poshtë listohen Bankat anëtare në Bursë të cilat mund të tregtojnë titullin në varësi të interesave të tyre si dhe mund të transmetojnë urdhërat e obligacionmbajtësve për transaksione me këto tituj në Bursë . 3. **Banka Credins sh.a**., mbajtëse e Licencës Nr.07, datë 28.02.2022, "Për ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj"lëshuar nga AMF, me të dhëna kontakti si më poshtë: Tel: +355 45353000 e-mail: info@bankacredins.com 4. **Banka Amerikane e Investimeve sh.a.** mbajtëse e Licencës Nr.06, datë 28.02.2022, "Për ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj" lëshuar nga AMF, me të dhëna kontakti si më poshtë: Tel: +355 42 258 755 e-mail: info@abi.al

	Anëtarët në Bursë mund të shtohen apo ndryshojnë ndaj obligacionmbajtësit mund të kontrollojnë kurdoherë listën e përditësuar të anëtarëve në ëebsite të Bursës Shqiptare të Titujve ALSE sha (https://alse.al/kreu/sherbimet/anetaresimi/lista-e-anetareve-te-alse/).
Pika 6.4	6.4 Çmimi i emetimit të titujve - Obligacionet do të emetohen me 100% të vlerës nominale të tyre. - Vlera nominale e çdo obligacioni është 500.000,00 (Pesëqind mijë) Lekë

RUBRIKA 8 -- SHPENZIMET E EMETIMIT/OFERTËS

Pika 8.1	8.1 Të ardhurat e përgjithshme neto dhe një vlerësim i shpenzimeve të përgjithshme të emetimit/ofertës Emetuesi ka realizuar një vlerësim të kujdesshëm të kostove të lidhura me procesin e emetimit të këtyre obligacioneve. Elementë të rëndësishëm të kostove të lidhura më ofertën janë: - shpenzimet e marketimit të ofertës; - shpenzime për këshilluesin e jashtëm për rishikimin e përmbajtjes së prospektit; - shpenzime për nënshkrimin e ofertës; - shpenzime për regjistrimin e titujve pranë Regjistrarit; - shpenzime për tarifën e shërbimit të Përfaqësuesit të Obligacionmbajtësit; - shpenzime për listimin e titullit në Bursën Shqiptare të Titujve; - shpenzime për tarifën e miratimit të Prospektit nga AMF. Vlera e përgjithsme e shpenzimeve të emetimit mund të variojnë nga 10 deri 16 milionë Lekë ose 2-3% e vlerës së ofertës e shprehur si kosto e menjëhershme, e vitit korrent. E shprehur si një kosto e anualizuar/shpërndarë për afatin 5 vjecar të obligacioneve , ajo pritet të variojë nga 0.3-0.6%. Të ardhurat e përgjithshme neto të Emetuesit, pritet të jenë rreth 483-489 milionë Lekë.

Pika 9.1	**Pika 9.1 Nëse këshilltarët që kanë lidhje me një emetim përmenden në Shënimin e Titullit, deklaratë e cilësisë në të cilën kanë vepruar këshilltarët** Emetuesi nuk ka angazhuar ndonjë këshilltar të licencuar për veprimtarinë e këshillimit për investime, por ka angazhuar Deloitte Albania shpk për rishikimin e përmbajtjes së këtij Prospekti. 1. Deklaratë nga Zj.Sabina Lalaj- Administrator i Deloitte Legal  DEKLARATË Unë e nënshkruara, Sabina Lalaj, identifikuar me dokumentin e identifikimit me nr. personal H85605095K, në cilësinë e administratorit deklaroj se Deloitte Legal është angazhuar si ekspert i jashtëm për rishikimin e përmbajtjes së prospektit në përputhje me legjislacionin ne fuqi. Angazhimi i Deloitte Legal është bëre me kërkesë të NOA. Në çdo rast, përgjegjësia për përmbajtjen dhe formën e këtij prospekti, mbetet e NOA. Sabina Lalaj Administrator i Deloitte Legal 2. Deklarate nga Zj.Albana Shahu-Administrator i Deloitte Albania  DEKLARATË Unë e nënshkruara, Albana Shahu, identifikuar me dokumentin e identifikimit me nr. personal I36022089P, në cilësinë e administratorit deklaroj se Deloitte Albania është angazhuar si ekspert i jashtëm për rishikimin e përmbajtjes së prospektit në përputhje me legjislacionin ne fuqi. Angazhimi i Deloitte Albania është bëre me kërkesë të NOA. Në çdo rast, përgjegjësia për përmbajtjen dhe formën e këtij prospekti, mbetet e NOA. Albana Shahu Administrator i Deloitte Albania
Pika 9.2	**Pika 9.2 Përfshirje e informacioneve të tjera në shënimin e titullit që është audituar ose kontrolluar nga audituesit ligjorë dhe kur audituesit kanë hartuar një raport, riprodhim të raportit ose, me lejen e autoritetit kompetent, përmbledhje të raportit.** E paaplikueshme

Pika 9.3	**9.3 Klasifikimi i rrezikut të kreditit që lidhet me titujt, me kërkesë ose në bashkëpunim me emetuesin gjatë procesit të vlerësimit. Një shpjegim i shkurtër se çfarë nënkuptojnë klasifikimet, nëse kjo është publikuar më parë nga ofruesi i klasifikimi** Si më datën e këtij Prospekti, Emetuesi nuk ka një "Vlerësim Kreditor" të Institucionit të performuar nga ndonjë agjenci e pavarur vlerësimi kreditor. Emetuesi, me kërkesë të tij, ka përfituar certifikatën e "Vlerësimit Institucional" nga agjencia globale e vlerësimit MFR. Certifikatë e "Vlerësimit Institucional" të NOA sh.a. nga MFR SRL Informacion mbi agjencinë e vlerësimit MFR MFR është një agjenci ndërkombëtare vlerësimi ("rating agency") e specializuar kryesisht në sektorin financiar me mbi 20 vite eksperiencë dhe prezencë në 4 kontinente. E themeluar në vitin 2000 brenda shoqërisë mëmë Microfinanza SRL, MFR u lancua si shoqëri më vete në vitin 2006. MFR ka seli qëndrore në Milano, Itali dhe ofron shërbimet e saj në botë nëpërmjet një rreti zyrash rajonale (Ekuador,Kenia,Republika e Kirgistanit) dhe zyrash shtetesh (Bolivi, Meksikë, Peru, Filipine) duke siguruar një shtirje gjeografike dhe gamë klientele të gjerë. Klientët e MFR janë kryesisht insitucione financiare, investitorë, rregullatorë, kompani që operojnë në fushën e energjisë së rinovueshme dhe rrjete/organizata që punojnë për të siguruar përfshirje financiare (financial inclusion) dhe zhvillim të qëndrueshëm. MFR, krahas vlerësimeve të pavarura të llojit "ratings" , ofron gjithashtu shërbimin e vlerësimeve (due-diligence, consumer protection assessment etj), certifikimeve (çertifikime mbi "Client Protection", "European Code of Good Conduct Evaluation") asistencës teknike, menaxhim dhe krahasimin /" benchmark" të dhënash nëpërmjet platformës së saj ATLAS etj. MFR ofron këto lloj vlerësimesh të llojit "ratings": - "Social Rating"; - "Institutional Rating"; - "Credit Rating"; - "MIV Rating"; - "Islamic Finance Rating". Informacion mbi Vlerësimin Institucional ("Institutional Rating") Vlerësimi Institucional siguron një opinion mbi qëndrueshmërinë afatgjatë të isntitucionit financiar nëpërmjet vlerësimit të kujdesshëm të proceseve të brendshme, kornizës rregullative të administrimit të rreziqeve dhe performancës. Për realizimin e vlerësimit institucional është e nevojshme të përformohet një analizë cilësore dhe sasiore e fushave të listuara më poshtë. Përbri cdo fushe analize është shënuar edhe pesha respektive në gradën finale - Profili financiar i shoqërisë (31%); - Cilësia e portofolit (19%); - Sistemet dhe kontrollet e brendshme (18%); - Qeverisja korporative & strategjitë (28%) ; - Ambjenti/faktorët e jashtëm (4%). Fazat në të cilat kalon procesi i Vlerësimit Institucional listohen si më poshtë. : - Grumbullimi i të dhënave dhe informacionit; - Vizita në vend (Intervistimet dhe validimi i të dhënave); - Draft raporti dhe kontrolli i cilësisë; - Feedback (nga institucioni që po vlerësohet); - Mbledhja e komitetit të vlerësimit dhe marrja e vendimit për gradën e vlerësimit.

Grada e Vlerësimit Insitucional të Emetuesit NOA sh.a.

Me përfundimin e procesit të vlerësimit, MFR i ka akorduar Emetuesit NOA sh.a. Certifikatën e Vlerësimit Institucional me gradën "α- high" në Janar të vitit 2023. Kjo Certifikatë ka vlefshmëri 1 vjecare nga momenti i lëshimit të saj.

Gjatë periudhës 2011 – 2023, janë kryer 3 vlerësime institucionale për NOA sha nga e njëjta agjenci, MFR.

Insitucioni	Lloji i Vleresimit	Grada e Vlerësimit	Data
NOA sha	" Institutional Rating"	α- High	Janar 2023
NOA sha	"Microfiance Institutional Rating"	BBB Stable	Janar 2017
NOA sha	"Microfiance Institutional Rating"	BB- Positive	Dhjetor 2011

Vlerësimet janë të publikuara në faqen zyrtare të MFR si vijon:
https://www.mf-rating.com/reports/?sreport=noa


MFR

INSTITUTIONAL RATING

The MFR Rating Committee assigns to

NOA, Albania

Grade: α- High

Good outlook for financial sustainability, which may be affected by a deterioration of the operations or economic conditions. Good fundamentals.

Milan, January 2023

Aldo Moauro
Managing Director

Ivan Sannino
Head of Rating Committee

UNLESS EARLIER REVOKED BY MFR OR BY MATERIAL CHANGES THAT AFFECT RATING STATUS, THIS CERTIFICATE IS VALID FOR 12 MONTHS FROM THE DATE OF EMISSION OF THE RATING